

Sistem kinemaje në shtëpi me DVD/Blu-ray Disc™

Udhëzimet e përdorimit

PARALAJMËRIM

Mos e instaloni pajisjen në një hapësirë të kufizuar, si në një raft librash ose në një mobilie inkaso.

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj. Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të zbuluar (për shembull qirinj të ndezur).

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëngje, si p.sh. vazo. Mos i ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluar ndaj nxehtësisë së tepruar siç janë drita e diellit dhe zjarri.

Për të parandaluar lëndimet, kjo aparaturë duhet të montohet mirë në dysheme/mur në përputhje me udhëzimet e instalimit. Vetëm për përdorim në ambiente të brendshme.

KUJDES

Përdorimi i instrumenteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun ndaj syve. Duke qenë se rrezja e lazerit të përdorur në këtë Sistem kinemaje në shtëpi Blu-ray Disc/DVD është e dëmshme për sytë, mos u përpiqni të çmontoni kasën e pajisjes. Për shërbimet drejtojuni vetëm personelit të kualifikuar.

CAUTION CLASS 3R VISIBLE AND INVISIBLE LASER RADIATION WHEN OPEN. AVOID DIRECT EYE EXPOSURE.
VORSICHT KLASSE 3R SICHTBARE UND UNSICHTBARE LASERSTRAHLUNG WENN GEÖFFNET. UNMITTELBAREN AUGENKONTAKT VERMEIDEN.
ADVARSEL SYNLIG OG USYNLIG LASERSTRÅLING AF KLASSE 3R VED ÅBNING. UNDGÅ AT SE DIREKTE PÅ STRÅLEN.
ADVARSEL SYNLIG OG USYNLIG LASERSTRÅLING I KLASSE 3R NÅR DENSEL ÅPNES. UNNGÅ DIREKTE EKSPOSERING AV ØYENNE.
VARNING KLASSE 3R SYNLIG OCH USYNLIG LASERSTRÅLNING NÄR DENNA DEL ÄR ÖPPNAD. UNDVIK KATT DIREKT EXPONERA ÖGONEN FÖR STRÅLNINGEN.
VARO! AVATTUNA LUOKAN 3R NÄKYVÄÄ JA NÄKYMÄTÖNTÄ LASERSÄTELYÄ. VÄLTÄ KATSEEN SUORAA ALITISTAMESTA.
警告 打开时有3类可见和不可见激光辐射。避免眼睛受到直射的照射。
注意 打开时有第3类可见及不可见激光辐射。避免眼睛直接暴露。

Kjo pajisje klasifikohet si produkt CLASS 3R LASER. Kur hapet kapaku mbrojtës i lazerit emetohen rreze të dukshme dhe të padukshme lazer, prandaj sigurohuni që të shmangni ekspozimin e drejtpërdrejtë e syve. Kjo shenjë ndodhet në pjesën e jashtme poshtë.

CLASS 1 LASER PRODUCT
LASER KLASSE 1
LUOKAN 1 LASERLAITE
KLASS 1 LASERAPPARAT

Kjo pajisje klasifikohet si produkt CLASS 1 LASER. Kjo shenjë ndodhet në pjesën e jashtme poshtë.

Për njësinë kryesore

Kjo pllakëz metalike ndodhet në pjesën e poshtme të pasme.

Kabllo e rekomanduara

Kabllo dhe bashkuesit e mbrojtur dhe të tokëzuar si duhet, duhet të përdoren për lidhjen e kompjuterëve pritës dhe/ose pajisjeve periferike.

Për klientët në Evropë



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.



Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria e dhënë me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.

Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhirvën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhirvë ose 0,004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktohehin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi.

Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoheni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoheni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.

Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Njoftim për klientët: informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen direktivat e BE-së.

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjisllacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtojuini adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit ose të garancisë.

Përmes kësaj, Sony Corp. deklaron se BDV-N9100W/BDV-N9100WL/BDV-N8100W/BDV-N7100W/BDV-N7100WL/EZV-RT50 janë në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/EC.

Për detaje, vizitoni URL-në e mëposhtme: <http://www.compliance.sony.de/>



Për klientët në Australi

Kjo pajisje duhet të instalohet dhe përdoret me një distancë minimale prej të paktën 20 cm ose më shumë mes radiatorit dhe trupit të personit (duke përjashtuar ekstremitet trupore: duart dhe kyçet e tyre, këmbët dhe kyçet e tyre).



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)

Masat paraprake

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve të përcaktuara në Direktivën EMC për përdorimin e një kabloje lidhëse më të shkurtër se 3 metra. (Vetëm modelet evropiane)

Mbi burimet e rrymës

- Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është e lidhur me prizën e rrymës së drejtpërdrejtë, edhe nëse njësia vetë është e fikur.
- Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, lidhjeni njësinë me një prizë lehtësisht të arritshme rryme të drejtpërdrejtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë prizën kryesore nga prizat e rrymës së drejtpërdrejtë.

Për shikimin e pamjeve video 3D

Disa persona mund të vuajnë nga shqetësime (si p.sh. lodhje sysh, dobësi ose marrje mendsh) gjatë shikimit të pamjeve 3D. Sony rekomandon që të gjithë shikuesit të bëjnë pushime të rregullta kur shikojnë pamje 3D. Kohëzgjatja dhe frekuenca e pushimeve të nevojshme do të variojë nga personi në person. Duhet të vendosni vetë si është më mirë. Nëse ju shkaktohen shqetësime, duhet të ndërprisni shikimin e pamjeve 3D derisa të mos keni më shqetësime; nëse mendoni se është e nevojshme konsultohuni me mjekun. Duhet të shihni edhe (i) manualin e përdorimit dhe/ose mesazhin e kujdesit të ndonjë pajisjeje tjetër që përdoret me këtë produkt, ose përmbajtjen e Blu-ray Disc që luhet me këtë produkt, si dhe (ii) faqen tonë të internetit (<http://esupport.sony.com/>) për informacionin më të fundit. Shikimi i fëmijëve të vegjël (sidomos i atyre nën gjashtë vjeç) është ende në zhvillim e sipër. Konsultohuni me mjekun (pediatrin ose okulistin) përpara se të lejoni fëmijët e vegjël të shohin pamje video 3D. Të rriturit duhet të mbikëqyrin fëmijët e vegjël për të siguruar që ndjekin rekomandimet e renditura më lart.

Mbrojtja kundër kopjimit

- Ju lutemi kini parasysh sistemet e përparuara të mbrojtjes së përmbajtjes që përdoren në mjetet e përdorimit të Blu-ray Disc dhe DVD. Këto sisteme të quajtura AACSS (Advanced Access Content System), në shqip sistem i përmbajtjes së përparuar të aksesit dhe CSS (Content Scramble System) në shqip sistem i kodimit të përmbajtjes, mund të përmbajnë disa kufizime për riprodhimin, daljen analoge dhe veçori të tjera të ngjashme. Përdorimi i këtij produkti dhe kufizimet e vendosura mund të variojnë në varësi të datës së blerjes, duke qenë se bordi drejtues i AACSS mund të miratojë ose ndryshojë rregulloret e veta të kufizimeve pas datës së blerjes.
- Njoftim nga Cinavia
Ky produkt përdor teknologjinë Cinavia për të kufizuar përdorimin e kopjeve të paautorizuara të disa filmave e videove komerciale dhe kolonave të tyre zanore. Kur diktohet përdorimi i ndaluar i një kopjeje të paautorizuar, do të shfaqet një mesazh dhe riprodhimi ose kopjimi do të ndërpritet. Më shumë informacion mbi teknologjinë Cinavia jepet në Qendrën Online të Cinavia për Konsumatorët në faqen <http://www.cinavia.com>. Për të kërkuar informacion shtesë mbi Cinavia përmes postës së thjeshtë, dërgoni një kartolinë me adresën tuaj të postës në adresën: Cinavia Consumer Information Center, P.O. Box 86851, San Diego, CA, 92138, USA.

E drejta e autorit dhe markat tregtare

- Ky sistem përmban dekodere rrethues matricë të përshtatur Dolby* Digital dhe Dolby Pro Logic si dhe DTS** Digital Surround System.
 - * Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Pro Logic dhe simboli me dy „D“ janë marka tregtare të Dolby Laboratories.

** Prodhuar me licencë nën patentat e SH.B.A.-së numër: 5,956,674; 5,974,380; 6,226,616; 6,487,535; 7,212,872; 7,333,929; 7,392,195; 7,272,567 dhe patenta të tjera të SH.B.A.-së dhe botërore të marra dhe në pritje. DTS-HD, simboli i saj dhe DTS-HD dhe simboli i saj së bashku janë marka tregtare të regjistruara të DTS, Inc. Produkti përfshin softuerin. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

- Ky sistem përmban teknologji High-Definition Multimedia Interface (HDMI™), në shqip: ndërfaqe multimediale me definicion të lartë.
Termtat HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, si dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.
- Java është markë tregtare e Oracle dhe/ose filialeve të saj.
- „DVD logo“ është markë tregtare e DVD Format/Logo Licensing Corporation.
- „Blu-ray Disc“, „Blu-ray“, „Blu-ray 3D“, „BD-LIVE“, „BONUSVIEW“, dhe logot janë marka tregtare të Blu-ray Disc Association.
- Logot „Blu-ray Disc“, „DVD+RW“, „DVD-RW“, „DVD+R“, „DVD-R“, „DVD VIDEO“ dhe „CD“ janë marka tregtare.
- „Super Audio CD“ është markë tregtare.
- „BRAVIA“ është markë tregtare e Sony Corporation.
- „AVCHD 3D/Progressive“ dhe logoja „AVCHD 3D/Progressive“ janë marka tregtare të Panasonic Corporation dhe Sony Corporation.
- „XMB“ dhe „xross media bar“ janë marka tregtare të Sony Corporation dhe Sony Computer Entertainment Inc.
- „PlayStation“ është markë e regjistruar tregtare e Sony Computer Entertainment Inc.
- „Sony Entertainment Network logo“ dhe „Sony Entertainment Network“ janë marka tregtare të Sony Corporation.

- Teknologjia e dallimit të muzikës dhe videos dhe të dhënat përkatëse jepen nga Gracenote®. Gracenote është standard i industrisë në teknologjinë e njohjes së muzikës dhe përçimit të përmbajtjes së lidhur me to. Për më shumë informacion, vizitoni www.gracenote.com.
CD, DVD, Blu-ray Disc dhe të dhënat e lidhura muzikore dhe video nga Gracenote, Inc., të drejtat e autorit © 2000 deri më sot Gracenote. Softueri Gracenote, të drejtat e autorit © 2000 deri më sot Gracenote. Një ose më shumë patenta të zotëruara nga Gracenote i aplikohen këtij produkti dhe shërbimi. Shihni faqen e internetit të Gracenote për një listë të pjesshme të patentave të aplikueshme të Gracenote. Gracenote, CDDb, MusicID, MediaVOCS, logoja Gracenote dhe lloji i logos, si dhe logoja „Powered by Gracenote“ janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të Gracenote në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.



- Wi-Fi®[®], Wi-Fi Protected Access® dhe Wi-Fi Alliance® janë marka të regjistruara të Wi-Fi Alliance.
- Wi-Fi CERTIFIED™, WPA™, WPA2™ dhe Wi-Fi Protected Setup™ janë marka të regjistruara të Wi-Fi Alliance.
- Marka N është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e NFC Forum, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera.
- Android është markë tregtare e Google Inc.
- Marka e fjalës *Bluetooth*® dhe logot janë marka tregtare të regjistruara të zotëruara nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga Sony Corporation është me licencë. Të gjitha markat e tjera tregtare dhe emrat tregtarë janë të zotëruesve të tyre përkatës.
- Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.

- Ky produkt përmban teknologji me pronësi të regjistruar me licencë nga Verance Corporation dhe mbrohet nga patenta e SH.B.A.-së 7,369,677 dhe patenta të tjera të SH.B.A.-së dhe botërore të marra dhe në pritje, si dhe të drejta autori dhe mbrojtje e sekretit tregtar për disa aspekte të kësaj teknologjie. Cinavia është markë tregtare e Verance Corporation. Të drejtat e autorit 2004-2010 Verance Corporation. Të gjitha të drejtat të rezervuara nga Verance. Zbërthimi ose çmontimi për qëllime dublikimi është i ndaluar.
- Windows Media është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.

Ky produkt mbrohet nga teknologji të caktuara që janë subjekt i disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft Corporation. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencë nga Microsoft apo një filial i autorizuar i Microsoft.

Zotëruesit e përmbajtjes përdorin teknologji Microsoft® PlayReady™ për aksesimin e përmbajtjes për të mbrojtur pronën e tyre intelektuale, duke përfshirë përmbajtjen e mbrojtur me të drejta autori. Kjo pajisje përdor teknologji PlayReady për të aksesuar përmbajtjen e mbrojtur me PlayReady dhe/ose përmbajtjen e mbrojtur me WMDRM. Nëse pajisja nuk arrin të imponojë siç duhet kufizimet mbi përdorimin e përmbajtjes, zotëruesit e përmbajtjes mund të kërkojnë nga Microsoft që të anulohet mundësinë e pajisjes për të përdorur përmbajtje të mbrojtur me PlayReady. Anulimi nuk duhet të ndikojë në përmbajtjet e pambrojtura ose përmbajtje të mbrojtura nga teknologji të tjera për aksesimin e përmbajtjes. Zotëruesit e përmbajtjes mund t'ju kërkojnë të përditësoni PlayReady për të pasur akses në përmbajtjen e tyre. Nëse nuk pranoni të përditësoni, nuk do të jeni në gjendje të keni akses në përmbajtjen që kërkon përditësimin.

- DLNA™, logoja DLNA dhe DLNA CERTIFIED™ janë marka tregtare, marka shërbimi ose marka certifikimi të Digital Living Network Alliance.

- SDK për pajisje Opera® nga Opera Software ASA. Të drejtat e autorit 1995-2013 Opera Software ASA. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

O POWERED
BY OPERA®

- Të gjitha markat e tjera tregtare janë marka të zotëruesve të tyre përkatës.
- Emrat e sistemeve dhe produkteve të tjera janë në përgjithësi marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të prodhuesve. Markat ™ dhe ® nuk tregohen në këtë dokument.

Informacion mbi Licencën e Përdoruesit

Gracenote® Marrëveshja e Licencës së Përdoruesit

Ky aplikacion ose pajisje përmban softuer nga Gracenote, Inc. nga Emeryville, California („Gracenote“). Softueri nga Gracenote („Softueri i Gracenote“) mundëson që ky aplikacion të kryejë identifikimin e diskut dhe/ose skedarit dhe të marrë informacion që lidhet me muzikën, duke përfshirë informacionin mbi emrin, artistin, pjesën dhe titullin („Të dhënat e Gracenote“) nga serverët online ose databazat e inkorporuara (në mënyrë kolektive të referuar si „Serverët e Gracenote“) dhe të kryejë funksione të tjera. Ju mund të përdorni Të dhënat e Gracenote vetëm përmes funksioneve për përdorim nga Përdoruesi të këtij aplikacioni ose pajisjeje. Ju bini dakord se do të përdorni Të dhënat e Gracenote, Softuerin e Gracenote dhe Serverët e Gracenote vetëm për përdorimin tuaj personal jotregtar. Ju bini dakord të mos caktoni, kopjoni, transferoni ose transmetoni Softuerin e Gracenote ose çdo Të dhënë të Gracenote te një palë e tretë. JU BINI DAKORD TË MOS PËRDORNI OSE SHFRYTËZONI TË DHËNAT E GRACENOTE, SOFTUERIN E GRACENOTE OSE SERVERËT E GRACENOTE PËRVEÇSE SIÇ LEJOHET SHPREHIMISHT KËTU.

Ju bini dakord se licenca juaj joekskluzive për të përdorur Të dhënat e Gracenote, Softuerin e Gracenote dhe Serverët e Gracenote do të ndërpritet në rast se shkelni këto kufizime. Nëse licenca juaj ndërpritet, ju bini dakord të ndërprisni çdo përdorim të Të dhënave të Gracenote, Softuerit të Gracenote dhe Serverëve të Gracenote. Gracenote rezervon të gjitha të drejtat për Të dhënave e Gracenote, Softuerin e Gracenote dhe Serverët e Gracenote, duke përfshirë të gjitha të drejtat e pronësisë. Në asnjë rrethanë nuk do të bëhet përgjegjëse Gracenote për ndonjë pagesë ndaj jush për informacione që ju jepni. Ju bini dakord që Gracenote, Inc. mund të imponojë të drejtat e veta sipas kësaj Marrëveshjeje kundër jush direkt në emër të vet. Shërbimi i Gracenote kërkon një identifikues unik për të gjurmuar pyetje për qëllime statistikore. Qëllimi i identifikuesit numerik të caktuar në mënyrë të rastësishme bëhet për t'i lejuar shërbimit të Gracenote të numërojë pyetjet pa ditur asgjë mbi identitetin tuaj. Për më shumë informacion, shihni faqen e internetit për Politikën e Privatësisë së Gracenote për shërbimin e Gracenote. Softueri i Gracenote dhe çdo artikull i Të dhënave të Gracenote licencohen „PA GARANCI“. Gracenote nuk jep deklarim apo garanci, të shprehur ose të nënkuptuar, në lidhje me saktësinë e Të dhënave të Gracenote nga Serverët e Gracenote. Gracenote rezervon të drejtën të fshijë të dhëna nga Serverët Gracenote ose të ndryshojë kategoritë e të dhënave për çfarëdo shkak që Gracenote e gjykon të mjaftueshëm. Nuk jepet asnjë garanci se Softueri i Gracenote ose Serverët e Gracenote janë pa gabime ose se funksionimi i Softuerit të Gracenote ose Serverëve të Gracenote do të jetë i pandërprerë. Gracenote nuk është e detyruar t'ju japë lloje të dhënash shtesë ose të përmirësuara ose kategori që Gracenote mund t'i japë në të ardhmen dhe është e lirë të ndërpresë shërbimet e saj në çdo kohë.

GRACENOTE HEQ DORË NGA ÇDO GARANCI TË SHPREHUR OSE TË NËNKUPTUAR, DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR MË, GARANCITË E NËNKUPTUARA TË TREGTUESHMËRISË, PËRSHTATSHMËRINË PËR NJË QËLLIM TË KAKTUAR, TITULL DHE MOS-SHKELJE. GRACENOTE NUK GARANTON REZULTATET QË DO TË PËRFTOHEN NGA PËRDORIMI NGA ANA JUAJ I SOFTUERIT TË GRACENOTE OSE ÇDO SERVERI TË GRACENOTE. GRACENOTE NUK DO TË JETË PËRGJEGJËSE NË ASNJË RAST PËR ASNJË DËMTIM PASUES OSE AKSIDENTAL OSE PËR ASNJË FITIM TË HUMBUR APO TË ARDHURA TË HUMBURA.

© Gracenote, Inc. 2009

Mbi këto udhëzime përdorimi

- Udhëzimet në këto Udhëzime Përdorimi përshkruajnë kontrollat në telekomandë. Ju mund të përdorni edhe kontrollat në njësinë kryesore nëse kanë emra të njëjtë ose të ngjashëm me ato në telekomandë.
- Në këtë manual, „disk“ përdoret si referencë e përgjithshme për BD, DVD, Super Audio CD ose CD përveçse kur specifikohet ndryshe nga teksti ose ilustrimi.
- Udhëzimet në manual janë për modelet BDV-N9100W, BDV-N9100WL, BDV-N8100W, BDV-N7100W dhe BDV-N7100WL. BDV-N9100WL është modeli i përdorur për qëllime ilustrimi. Çdo ndryshim në funksionim tregohet qartë në tekst, për shembull, „vetëm BDV-N9100WL“.
- Disa ilustrime paraqiten si skica konceptuale dhe mund të jenë ndryshe nga produktet aktuale.
- Artikujt e shfaqur në ekranin e televizorit mund të ndryshojnë në varësi të zonës.
- Cilësimi i paraqizdhur nënvizohet.

Pasqyra e lëndës

Mbi këto udhëzime përdorimi	7
Shpaketimi	10
Udhëzuesi i pjesëve dhe i komandave	13

Fillimi

Hapi 1: Instalimi	
i altoparlantëve	19
Hapi 2: Lidhja e sistemit	20
Lidhja e altoparlantëve	20
Lidhja e televizorit	22
Lidhja me pajisjet e tjera	
(dekoder, etj.)	23
Lidhja e antenës (ajrore)	25
Hapi 3: Përgatitja për lidhjen	
me rrjetin	25
Hapi 4: Konfigurimi i sistemit	
me valë	27
Hapi 5: Kryerja e konfigurimit	
të thjeshtë	29
Hapi 6: Zgjedhja e burimit të	
riprodhimit	30
Hapi 7: Shijoni tingujt rrethues	30

Riprodhimi

Luajtja e një disku	32
Luajtja nga një pajisje USB	34
Shijimi i muzikës nga një pajisje	
<i>Bluetooth</i>	35
Lidhja me një smartphone	
nga funksioni i dëgjimit	
me një prekje (NFC)	37
Luajtja përmes një rrjeti	38
Opsionet e disponueshme	42

Përshtatja e zërit

Zgjedhja e formatit audio, pjesëve	
në disa gjuhë ose kanalit	44
Shijimi i tingullit me transmetim	
multipleks	45

Sintonizuesi

Dëgjimi i radios	45
Marrja e Radio Data System (RDS)	47

Funksionet e tjera

Përdorimi i funksionit Control for	
HDMI (Kontroll për HDMI)	
për „BRAVIA“ Sync	47
Kalibrimi automatik i cilësimeve	
të duhura për altoparlantët	48
Cilësimi i altoparlantëve	50
Përdorimi i kohëmatësit të fjetjes	51
Çaktivizimi i butonave në njësinë	
kryesore	52
Përdorimi i ndriçimit	
të altoparlantëve	52
Kontrollimi i televizorit ose pajisjeve të	
tjera me telekomandën e dhënë	52
Kursimi i energjisë në modalitetin	
e pritjes	54
Shfletimi i faqeve të internetit	54
Cilësimet e tjera për	
sistemin me valë	57

Cilësimet dhe përshtatjet

Përdorimi i ekranit të konfigurimit	58
[Remote Control Setting Guide]	
(Udhëzuesi i cilësimeve të telekomandës)	59
[Network Update]	
(Cilësimet e rrjetit)	59
[Screen Settings]	
(Cilësimet e ekranit)	60
[Audio Settings]	
(Cilësimet audio)	62
[BD/DVD Viewing Settings]	
(Cilësimet e shikimit BD/DVD)	63
[Parental Control Settings]	
(Cilësimet e kontrollit prindëror)	64
[Music Settings]	
(Cilësimet e muzikës)	64
[System Settings]	
(Cilësimet e sistemit)	64
[External Input Settings]	
(Cilësimet e hyrjes së jashtme)	66
[Network Settings]	
(Cilësimet e rrjetit)	66
[Easy Network Settings]	
(Cilësimet e lehta të rrjetit)	68
[Resetting] (Rivendosja)	68

Informacioni shtesë

Masat paraprake	68
Shënime mbi disqet	71
Zgjidhja e problemeve	71
Disqet që mund të luhen	78
Llojet e skedarëve që mund të luhen ...	79
Formatet e mbështetura audio	80
Specifikimet	81
Lista e kodeve të gjuhëve	84
Indeksi	86

Shpaketimi


- Udhëzimet e përdorimit (vetëm për modelet e Oqeanisë)
- Udhëzuesi i shpejtë i konfigurimit
- Udhëzuesi i instalimit të altoparlantëve
- Udhëzuesi i referencës (vetëm modelet evropiane)
- Telekomanda (1)
- Bateritë R03 (madhësia AAA) (2)
- Antena FM me tel (ajrore) (1)




ose



- Mikrofoni i kalibrimit (1)



- Amplifikuesi shumëkanalësh (1)



- Marrësit me valë (2)



Vetëm BDV-N9100W/BDV-N9100WL


- Altoparlantët e përparmë (2)




- Altoparlantët rrethues (2)




- Altoparlanti qendror (1)



- Nën-vuferi (1)



- Telat e altoparlantëve (5, kuq/bardhë/gri/blu/jeshil)



- Kapakët e fundit të altoparlantit (4)



- Bazamentet (4)



- Pjesët më të ulëta të altoparlantëve të përparmë dhe atyre rrethues (4)



- Vidhat (16)



Vetëm BDV-N8100W


- Altoparlantët e përparmë (2)




- Altoparlantët rrethues (2)



- Altoparlanti qendror (1)



- Nën-vuferi (1)



- Telat e altoparlantëve (5, kuq/bardhë/gri/blu/jeshil)



- Kapakët e fundit të altoparantit (2)



- Bazamentet (2)



- Pjesët më të ulëta të altoparantëve të përparmë (2)



- Mbjtëset (për altoparantët rrethues) (2)



- Kapakët e vrimave të vidave (2)



- Vidhat (10)



Vetëm BDV-N7100W/BDV-N7100WL


- Altoparantët e përparmë (2)




- Altoparantët rrethues (2)




- Altoparanti qendror (1)



- Nën-vuferi (1)



- Telat e altoparantëve (5, kuq/bardhë/gri/blu/jeshil)



- Mbjtëset (për altoparantët e përparmë dhe ata rrethues) (4)



- Kapakët e vrimave të vidave (4)



- Vidhat (4)





Udhëzuesi i pjesëve dhe i komandave

Për më shumë informacion, referojuni faqeve të treguara në kllapa.

Njësia kryesore

Paneli i sipërm dhe i përparmë



- 1 I/⏻ (ndezur/në pritje)**
Ndez njësinë kryesore ose e vendos atë në modalitet pritjeje.
- 2 Kapaku i diskut (faqe 32)**
- 3 Treguesi LED**
I bardhë: Ndizet kur njësia kryesore ndizet.
Blu (për statusin e *Bluetooth*):
 - Sistemi është gati për çiftim:
Pulson shpejt
 - Gjatë çiftimit: Pulson shpejt
 - Gjatë lidhjes: Pulson
 - Vendoset lidhja: Ndizet
- 4 Ekran i panelit të sipërm**
- 5  (Marka N) (faqe 37)**
Poziciononi pajisjen e përputhshme me NFC pranë këtij treguesi për të aktivizuar funksionin NFC.
- 6 Treguesit/butonat me prekje FUNCTION (faqe 30)**
Zgjedh burimin e riprodhimit.
 - ▶* (luaj)
 - * (ndalo)**VOL +/-**
**Mbani të shtypur ▶ në njësinë kryesore për më shumë se 2 sekonda dhe në sistem do të luhet demonstrimi i zërit të integruar. Prekni ■ për të ndaluar demonstrimin.

Shënim

Gjatë demonstrimit, niveli i volumit mund të jetë më i lartë se niveli i volumit që keni vendosur.

7 (USB) (faqe 34)

Vendosni thoin tuaj në fole për të hapur kapakun.

8 (e mëparshme/tjetër)

9 (sensori i telekomandës)

10 (hap/mbyll)

Mbi treguesit/butonat me prekje

Këto butona funksionojnë kur janë të ndezur treguesit e butonave me prekje.

Ju mund të ndizni/fikni treguesit duke vendosur [Main Unit illumination]

(Ndriçimi i njësisë kryesore) (faqe 65).



Kur vendosni [Main Unit illumination]

(Ndriçimi i njësisë kryesore) në [Auto]

(Automatik), treguesit fiken. Në këtë rast, prekni një nga butonat me prekje.

Kur treguesit ndizen, prekni butonin që dëshironi.


Nëse prekni një buton kur treguesit janë të fikur, treguesit ndizen për disa sekonda.

Nëse prekni përsëri , treguesi  pulson për disa sekonda dhe ndizet gjatë riprodhimit.

Shënim

- Këto butona funksionojnë kur i prekni lehtë. Mos i shtypni me forcë të tepruar.
- Nëse butoni nuk funksionon, lëshoni butonin dhe prisni për disa sekonda. Më pas prekni përsëri butonin me gisht duke mbuluar treguesin e butonit.

Treguesit në ekranin e panelit të sipërm



- 1** Ndizet kur merret tingull stereo. (Vetëm radio)
- 2** Ndizet kur aktivizohet luajtja e përsëritur.
- 3** Ndizet kur sistemi luan përmes funksionit PARTY STREAMING.
- 4** Ndizet kur aktivizohet heshtja.
- 5** Ndizet kur foleja HDMI (OUT) është lidhur saktë me një pajisje të përputhshme me HDCP (High-bandwidth Digital Content Protection) me hyrje HDMI ose DVI (Digital Visual Interface).

- 6** Shfaq statusin e sistemit, si p.sh. frekuencën radio, etj.


Kur shtypni DISPLAY, shfaqet informacioni i transmetimit/statusi i dekodimit kur funksioni vendoset në „TV“.

Informacioni i transmetimit/statusi i dekodimit mund të mos shfaqet në varësi të transmetimit ose artikullit që dekodohet.

Shënim

Kur [Main Unit illumination] (Ndriçimi i njësisë kryesore) është vendosur te [Auto] në [System Settings] (Cilësimet e sistemit), ekrani i panelit të sipërm fiket nëse nuk e përdorni njësinë kryesore për rreth 10 sekonda.


Paneli i pasmë



- | | |
|--|---|
| <p>1 Termialet SPEAKER ILLUMINATION (vetëm BDV-N9100WL/BDV-N7100WL) (faqe 21)</p> <p>2 Foleja A.CAL MIC (faqe 29, 49)</p> <p>3 Foletë AUDIO (AUDIO IN L/R) (faqe 23)</p> <p>4 Foleja ANTENNA (FM COAXIAL 75 Ω) (faqe 25)</p> | <p>5 Foleja TV (DIGITAL IN OPTICAL) (faqe 22)</p> <p>6 Foleja HDMI (OUT) (faqe 22)</p> <p>7 Foletë HDMI (IN 1/IN 2) (faqe 23)</p> <p>8 Terminali LAN (100) (faqe 25)</p> <p>9 Foleja e marrësit me valë (faqe 27)</p> <p>10 Foletë SPEAKERS (faqe 20)</p> |
|--|---|


Amplifikuesi shumëkanalësh

Paneli i përparmë



- 1** I/ON (ndezur/në pritje)
- 2** Treguesi LINK/STANDBY (faqe 28)
Mund të kontrolloni gjendjen e transmetimit me valë midis njësisë kryesore dhe amplifikuesit shumëkanalësh.
- 3** Marrësi me valë Foleja (EZW-RT50)


Paneli i pasmë



- 4** Butoni SECURE LINK (faqe 57)
Fillon funksionin Secure Link.
- 5** Termialet SPEAKER ILLUMINATION (vetëm BDV-N9100WL/BDV-N7100WL) (faqe 21)
- 6** Foletë SPEAKERS

Telekomanda

Përshkrimi i butonave më poshtë është vetëm për përdorimin e sistemit. Shikoni „Kontrollimi i televizorit ose pajisjeve të tjera me telekomandën e dhënë“ (faqe 52) për butonat për përdorimin e pajisjes së lidhur.



- Butonat Numri 5, AUDIO, ► dhe PROG + kanë pikë të prekshme. Përdoreni pikën e prekshme si referencë kur përdorni telekomandën.
- Butonat e printur në të verdhë aktivizohen pasi shtypni butonin e modalitetit të përdorimit të TV ose STB.

1 ▲ (hap/mbyll)

Hap ose mbyll kapakun e diskut.

SPEAKERS TV ↔ AUDIO

Zgjedh nëse zëri i televizorit del nga altoparlantët e sistemit apo altoparlanti/altoparlantët e televizorit. Ky funksion funksionon vetëm kur vendosni [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) në [On] (Ndezur) (faqe 65).

AV I/⏻ (ndezur/në pritje) (faqe 52)

Ndez televizorin ose pajisjen tjetër, ose vendos atë në modalitet pritjeje.

I/⏻ (ndezur/në pritje) (faqet 29, 46)

Ndez sistemin, ose e vendos atë në modalitet pritjeje.

2 SPEAKER ILLUMINATION (faqe 52)

Fik ose ndez ndriçimin te altoparlantët.

Butonat e modalitetit të përdorimit (faqe 52)

Ndryshon pajisjen që do të përdoret me anë të telekomandës.

STB: Ju mund të përdorni një dekoder kabllor, marrës dixhital satelitor, marrës dixhital video, etj.

TV: Mund të përdorni një televizor.

BD: Mund të përdorni këtë sistem.

3 Butonat e numrave (faqet 46, 52)

Vendos numrat e titujve/kapitujve, paravendos numrin e stacionit, etj.

ENTER

Fut artikullin e zgjedhur.

4 Butonat me ngjyra

Butonat e shkurtoreve për përzgjedhjen e artikujve në disa meny BD (mund të përdoren gjithashtu për operacionet interaktive Java në BD).

5 TOP MENU

Hap ose mbyll menynë kryesore të BD-së ose DVD-së.

POP UP/MENU

Hap ose mbyll menunë kërcyese të BD-ROM ose menunë e DVD-së.

OPTIONS (faqet 31, 42, 56)

Shfaq meny të e opsioneve në ekranin e televizorit ose në ekranin e panelit të sipërm. (Vendndodhja ndryshon në varësi të funksionit të përzgjedhur.)

RETURN

Kthehet në ekranin e mëparshëm.



Zhvendos theksimin te një artikull i shfaqur.



Fut artikullin e zgjedhur.

6 BLUETOOTH (faqet 35, 36)

Zgjedh funksionin „BT“.

Kur treguesi blu LED fiket gjatë funksionit „BT“, shtypeni për të filluar çiftimin ose për t'u lidhur me pajisje të çiftuar *Bluetooth*.

HOME (faqet 30, 50, 58)

Vendos ose del nga menyja kryesore e sistemit.

SEN

Hyn në shërbimin e internetit të „Sony Entertainment Network™“.

FUNCTION (faqet 30)

Zgjedh burimin e riprodhimit. Duke vendosur [External Input Settings] (Cilësimet e hyrjes së jashtme) (faqe 66), ju mund të kapërceni hyrjet e papërdorura kur zgjidhni një funksion.

FOOTBALL (faqet 32)

Prodhon zë të optimizuar për të shikuar transmetimet e ndeshjeve të futbollit.

SOUND MODE (faqet 31)

Zgjedh modalitetin e tingullit.

AUDIO (faqet 44)

Zgjedh formatin/pjesën audio.

SUBTITLE

Zgjedh gjuhën e titrave kur titra shumëgjuhësh janë të regjistruar në një BD-ROM/DVD VIDEO.

DISPLAY (faqet 34, 39, 46, 55)

Shfaq informacionin e riprodhimit dhe shfletimit të internetit në ekranin e televizorit.

Shfaq stacionin e paravendosur të radios, frekuencën, etj. në ekranin e panelit të sipërm.

MUSIC EQ (faqet 31)

Zgjedh balancuesin e programuar paraprisht kur dëgjoni muzikë.

7 Butonat e përdorimit të riprodhimit

Shihni „Riprodhimi“ (faqe 32).

◀◀/▶▶ (shpejt/ngadalë/ngrij kuadrin)

Përsheptim prapa / përsheptim para gjatë riprodhimit. Sa herë që shtypni këtë buton, shpejtësia e kërkimit ndryshon.

Aktivizon luajtjen me lëvizje të ngadalta kur shtypet për më shumë se një sekondë në modalitetin e pauzës.

Luan nga një kuadër njëkohësisht kur shtypet në modalitetin e pauzës.

Shënim

Gjatë riprodhimit në Blu-ray 3D Disc, nuk janë të disponueshme luajtja prapa me lëvizje të ngadalta dhe luajtja prapa me nga një kuadër.

◀◀/▶▶ (e mëparshme/tjetër)

Zgjedh kapitullin, pjesën ose skedarin e mëparshëm/tjetër.

▶ (luaj)

Nis ose rinis riprodhimin (rifillon luajtjen).

Aktivizon luajtjen me një prekje (faqe 47) kur sistemi është i ndezur dhe vendosur në funksionin „BD/DVD“.

|| (pauzë)

Vendos në pauzë rinis riprodhimin.

■ (ndalo)

Ndalon riprodhimin dhe ruan në kujtesë pikën e ndalimit (pikën e rifillimit). Pika e rifillimit për një titull/këngë është pika e fundit që keni luajtur ose fotoja e fundit për një dosje fotosh.


Ndalon demonstrimin e zërit të integruar.

Butonat e përdorimit të radios

Shihni „Sintonizuesi“ (faqe 45).

TUNING +/-

PRESET +/-

8  **(heshtja)**

Mbyll përkohësisht zërin.

 **(volumi) +/-**

Rregullon volumnin.

SLEEP (faqe 51)

Vendos kohëmatësin e fjetjes.


Fillimi

Hapi 1: Instalimi i altoparlantëve


Instalimi i altoparlantëve duke iu referuar figurës më poshtë.

- (A) Altoparlanti i përparmë i majtë (L)
- (B) Altoparlanti i përparmë i djathtë (R)
- (C) Altoparlanti qendror
- (D) Altoparlanti rrethues i majtë (L)
- (E) Altoparlanti rrethues i djathtë (R)
- (F) Nën-vuferi
- (G) TV

Instalimi i altoparlantëve rrethues në pozicionin e pasmë (Vendosja e altoparlantëve: [Standard])



Instalimi i të gjithë altoparlantëve në pozicionin e përparmë (Vendosja e altoparlantëve: [All Front] (Të gjithë përpara))



Shënim

- Sigurohuni se po zgjidhni cilësimin e vendosjes së altoparlantëve (faqe 50) sipas pozicionimit të altoparlantëve.
- Kini kujdes kur vendosni altoparlantët dhe/ose mbajtëset e altoparlantëve të bashkuara me altoparlantët në një dyshe me trajtim të veçantë (të trajtuar me dyllë, vaj, me lustër, etj.), duke qenë se mund të rezultojë në njolla ose çngjyrosje.
- Mos u mbështetni ose varni mbi altoparlant, sepse ai mund të bjerë.
- Altoparlantët e këtij kompleti nuk janë të mbrojtur magnetikisht. Kjo mund të rezultojë në çrregullim të ngjyrave kur vendosen pranë një projektori ose televizori me tub katodik.

Këshillë

- Për të nxjerrë një zë më efektiv kur zgjidhet cilësimi [All Front] (Të gjithë përpara), rekomandojmë që t'i instaloni altoparlantët e përparmë dhe altoparlantët rrethues më afër njëri-tjetrit.
- Altoparlantët mund t'i montoni në mur. Për hollësi, drejtoju „Udhëzuesit shoqëruar të instalimit të altoparlantëve“.

Hapi 2: Lidhja e sistemit

Mos e lidhni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të njësisë kryesore me një prizë muri (rrjeti), derisa të jenë kryer lidhjet e tjera.

Për montimin e altoparlantëve, referojuni „Udhëzuesi i instalimit të altoparlantëve“ që keni marrë.

Shënim


Kur lidhni një pajisje të tjetra me kontroll volumni, ulni volumnin e pajisjeve të tjera në një nivel ku zëri nuk ka distorsion.

Lidhja e altoparlantëve


Lidhni kordonët e altoparlantëve në mënyrë që të përputhen me ngjyrën e foleve SPEAKERS të njësisë kryesore dhe përforcuesit rrethues.

Kur lidhni me njësinë kryesore dhe përforcuesin rrethues, futni bashkuesin derisa të dëgjohet një kërcitje.


Te njësia kryesore



Te amplifikuesi shumëkanalësh



Te amplifikuesi shumëkanalësh




Për të lidhur terminalin SPEAKER ILLUMINATION (vetëm BDV-N9100WL/BDV-N7100WL)

Lidhni bashkuesin e ndriçimit të altoparlantit (të lidhur me kordonin e altoparlantit) te njësia kryesore dhe përforcuesi rrethues në mënyrë që të mund të shijoni efektin e dritës në altoparlantët tuaj.


Për të shijuar ndriçimin e altoparlantëve, duhet të montoni altoparlantët e llojit të gjatë. (Vetëm BDV-N9100WL)

Te njësia kryesore




Lidhja e televizorit

Sipas foleve për fisha në televizor, zgjidhni një nga mënyrat e mëposhtme të lidhjes.



Lidhja e videos




¹⁾ Kabloja HDMI e shpejtësisë së lartë

²⁾ Nëse foleja HDMI IN e televizorit tuaj është e përpjthshme me funksionin ARC (Audio Return Channel), sinjali dixhital i audios mund të dalë nga televizori përmes një lidhjeje me kablo HDMI. Për të caktuar funksionin ARC, shihni [Audio Return Channel] (Kanali i kthimit të audios) (faqe 65).


Lidhjet e audios

Nëse nuk lidhni sistemin me folenë HDMI të televizorit që është e përpjthshme me funksionin ARC, kryeni lidhjen përkatëse audio për të dëgjuar zërin e televizorit përmes altoparlantëve të sistemit.




Lidhja me pajisjet e tjera (dekoder, etj.)


Lidhni sistemin, televizorin dhe pajisjet e tjera si më poshtë.



* Kjo lidhje është e panevojshme për lidhjen **A** (lidhjen HDMI).

Sipas llojit të folesë së pajisjes, zgjidhni një nga mënyrat e mëposhtme të lidhjes.





Kur kryeni lidhjen **A**

Kjo lidhje mund të transmetojë si sinjale video, ashtu edhe audio.

Shënim

- Sinjalet video nga foletë HDMI (IN 1/2) janë dalje te foletë HDMI (OUT) vetëm kur zgjidhet funksioni „HDMI1“ ose „HDMI2“.
- Për të nxjerrë një sinjal audio nga foletë HDMI (IN 1/2) te foleja HDMI (OUT), ju nevojitet të ndryshoni cilësimin e daljes audio. Për detaje, shihni [Audio Output] (Dalja audio) te [Audio Settings] (Cilësimet audio) (faqe 62).
- Ju mund të ndryshoni hyrjen audio të një pajisjeje që lidhet me fole në HDMI (IN 1) te foleja e televizorit (DIGITAL IN OPTICAL). Për detaje, shikoni [HDMI1 Audio Input mode] (Modaliteti i hyrjes audio HDMI1) te [HDMI Settings] (Cilësimet HDMI) (faqe 65). (Vetëm modelet evropiane.)

Kur kryeni lidhjen **B**, **C**


Lidhni sistemin në mënyrë që sinjalet video nga sistemi dhe pajisjet e tjera t'i dërgohen televizorit, dhe sinjalet audio nga pajisja t'i dërgohet sistemit si më poshtë.

Shënim

- Nëse bëni ndonjë nga lidhjet më sipër, caktoni [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) në [HDMI Settings] (Cilësimet HDMI) të [System Settings] (Cilësimet e sistemit) në [Off] (Fikur) (faqe 65).
- Ju mund të shijoni zërin e pajisjes duke përzgjedhur funksionin „AUDIO“ për lidhjen **C**.

Lidhja e antenës (ajrore)

Pjesa e pasme e njësisë kryesore



Shënim

- Sigurohuni që të zgjatni plotësisht antenën FM me tel (ajrore).
- Pasi të lidhni antenën FM me tel (ajrore), mbajeni atë sa më horizontalisht që të jetë e mundur.

Këshillë

Nëse marrja e sinjalit FM është e keqe, përdorni një kablo koaksial 75-om (nuk jepet) për të lidhur njësinë kryesore me një antenë FM të jashtme (ajrore).

Hapi 3: Përgatitja për lidhjen me rrjetin


Këshillë

Për të lidhur sistemin me rrjetin tuaj, kryeni [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit). Për detaje shihni „Hapi 5: Kryerja e konfigurimit të thjeshtë“ (faqe 29).

Zgjidhni metodën në bazë të mjedisit tuaj LAN (Rrjeti i Zonës Lokale).

- Nëse përdorni LAN me valë Sistemi ka Wi-Fi të inkomporuar dhe mund ta lidhni sistemin me rrjetin duke kryer cilësimet e rrjetit.
- Nëse përdorni lidhje tjetër përveç LAN me valë

Përdorni një kablo LAN për t'u lidhur me terminalin LAN (100) në njësinë kryesore.



Këshillë

Rekomandohet një kablo e veshur (kablo LAN), e drejtpërdrejtë ose e kryqëzuar.

Përpara se të kryeni cilësimet e rrjetit

Kur ruteri juaj me valë LAN (pika e aksesit) është i përputhshëm me konfigurimin e mbrojtur Wi-Fi (WPS), mund të vendosni lehtësisht cilësimet e rrjetit me butonin WPS.

Nëse jo, kontrolloni paraprakisht informacionin e mëposhtëm, dhe regjistroni në hapësirën e dhënë më poshtë.

- Emrin e rrjetit (SSID*) që identifikon rrjetin tuaj**.
-
- Nëse rrjeti juaj me valë është i mbrojtur, çelësin e sigurisë (çelësin WEP, çelësin WPA)**.

* SSID (Identifikuesi i setit të shërbimit) është një emër që identifikon një rrjet të caktuar me valë.

** Ju nevojitet të kontrolloni cilësimet e ruterit me valë LAN për të marrë informacion mbi SSID dhe çelësin e sigurisë. Për detaje shihni:

– vizitoni faqen e mëposhtme të internetit:
Për klientët në Evropë dhe Rusi:
<http://support.sony-europe.com/>
Për klientët në vende/rajone të tjera:
<http://www.sony-asia.com/section/support>

– referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me ruterin me valë LAN
– konsultohuni me prodhuesin e ruterit me valë LAN

Mbi sigurinë e LAN me valë

Duke qenë se komunikimi përmes funksionit të LAN-it me valë kryhet përmes valëve radio, sinjali me valë mund të interceptohet nga të tjerë. Për të mbrojtur komunikimin me valë, ky sistem mbështet një numër funksionesh sigurie. Sigurohuni që të konfiguroni saktë cilësimet e sigurisë paraprakisht në përputhje me mjedisin e rrjetit tuaj.

■ Pa mbrojtje

Megjithëse cilësimet mund t'i bëni lehtë, çdokush mund t'i kapë komunikimet me valë ose të ndërhyjë në rrjetin tuaj me valë, edhe pa pajisje të sofistikuar. Kini parasysh se ekziston rreziku i aksesit të paautorizuar ose interceptimit të të dhënave.

■ WEP

WEP aplikon siguri për komunikimet për të parandaluar persona të jashtëm të interceptojnë komunikimet ose të ndërhyjnë në rrjetin tuaj me valë. WEP është një teknologji sigurie që mundëson lidhjen e pajisjeve më të vjetra që nuk mbështesin TKIP/AES.

■ WPA-PSK (TKIP), WPA2-PSK (TKIP)

TKIP është një teknologji sigurie e zhvilluar në përgjigje të mangësive të WEP. TKIP siguron një nivel më të lartë sigurie se WEP.

■ WPA-PSK (AES), WPA2-PSK (AES)


AES është një teknologji sigurie që përdor një metodë të përparuar sigurie të ndryshme nga WEP dhe TKIP. AES siguron një nivel më të lartë sigurie se WEP ose TKIP.

Hapi 4: Konfigurimi i sistemit me valë

Njësia kryesore transmeton zë në amplifikuesin shumëkanalësh që është lidhur me altoparantët shumëkanalësh. Për të aktivizuar transmetimin me valë, ndiqni hapat e mëposhtëm.


1 Futni marrësin me valë në njësinë kryesore.

Paneli i pasmë i njësisë kryesore



2 Futni marrësin me valë në amplifikuesin shumëkanalësh.

Paneli i pasmë i amplifikuesit shumëkanalësh



3 Lidhni kordonin elektrik (dalja e korrentit) të njësisë kryesore.


Përpara se të lidhni kordonin elektrik, sigurohuni të jenë në rregull të gjitha lidhjet në „Hapi 2: Lidhja e sistemit“ (faqe 20).

4 Shtypni I/⏻ për të ndezur sistemin.



5 Lidhni kordonin elektrik (dalja e korrentit) të amplifikuesit shumëkanalësh.

Treguesi LINK/STANDBY



Kur aktivizohet transmetimi me valë, treguesi LINK/STANDBY bëhet i gjelbër.

Nëse treguesi LINK/STANDBY nuk ndizet, shikoni „Zëri me valë“ (faqe 74).

Rreth treguesit LINK/STANDBY

Treguesi LINK/STANDBY vë në dukje gjendjen e transmetimit me valë, si më poshtë.

Treguesi	Gjendja
Bëhet i gjelbër.	Sistemi ndizet, aktivizohet transmetimi me valë dhe vijnë sinjalet e shumëkanalëshit.
Bëhet portokalli.	Sistemi ndizet, aktivizohet transmetimi me valë me funksionin Secure Link dhe vijnë sinjalet e shumëkanalëshit.
Pulson me ngadalë në të gjelbër ose portokalli.	Transmetimi me valë çaktivizohet.
Bëhet i kuq.	Amplifikatori shumëkanalësh është në modalitet pritjeje ndërsa sistemi është në modalitet pritjeje ose ndërsa është çaktivizuar transmetimi me valë.
Fiket.	Amplifikuesi shumëkanalësh fiket.
Pulson shpejt në të gjelbër.	Marrësi me valë nuk futet siç duhet në folenë e marrësit me valë.
Pulson në të kuqe.	Është aktive mbrojtja e amplifikuesit shumëkanalësh.

Për modalitetin e pritjes

Amplifikatori shumëkanalësh hyn automatikisht në modalitet pritjeje ndërsa sistemi qendror është në modalitet pritjeje ose ndërsa është çaktivizuar transmetimi me valë.

Amplifikatori shumëkanalësh ndizet automatikisht kur ndizet sistemi qendror dhe kur aktivizohet transmetimi me valë.

Për të përcaktuar lidhjen me valë

Nëse përdorni disa produkte me valë ose nëse përdorin produkte me valë fqinjët tuaj, mund të ketë interferenca. Për ta parandaluar këtë, mund ta përcaktoni lidhjen me valë me njësinë qendrore të amplifikuesit shumëkanalësh (funksioni Simp Link). Për detaje shihni „Cilësime të tjera për sistemin me valë“ (faqe 57).


Hapi 5: Kryerja e konfigurimit të thjeshtë

Përpara se të kryeni hapin 5

Ndiqui hapat më poshtë për të kryer rregullimet bazë dhe cilësimet e rrjetit për sistemin.

Artikujt e shfaqur ndryshojnë në varësi të zonës.


- 1 Futni dy bateri R03 (AAA) (të dhëna) duke përpunthur polet + dhe - të baterive me shenjat brenda folesë.**




- 2 Ndizni televizorin.**
- 3 Lidhni mikrofonin e kalibrimit me folenë A.CAL MIC në panelin e pasmë.**
Vendoseni mikrofonin e kalibrimit në nivelin e veshit duke përdorur trekëmbësh etj. (nuk jepet). Mikrofonin e kalibrimit duhet të drejtohet nga ekrani i televizorit. Pjesa e përparme e secilit altoparlant duhet të jetë përballë mikrofonit të kalibrimit dhe nuk duhet të ketë pengesa midis altoparlantëve dhe mikrofonit të kalibrimit.
- 4 Shtypni I/⏻ për të ndezur sistemin.**

- 5 Ndryshojeni selektorin e hyrjes në televizorin tuaj në mënyrë që sinjali nga sistemi të shfaqet në ekranin e televizorit.**

Shfaqet [Easy Initial Settings] (Cilësimet e lehta fillestare) për përzgjedhjen e gjuhëve OSD të shfaqjes së ekranit.



- 6 Kryeni [Easy Initial Settings] (Cilësimet e lehta fillestare). Ndiqui udhëzimet në ekran për të kryer cilësimet bazë duke përdorur ←/↑/↓/→ dhe +.**




Për detaje mbi [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik), shikoni „Kalibrimi automatik i cilësimeve të duhura për altoparlantët“ (faqe 48).

- 7 Pas plotësimit të [Easy Initial Settings] (Cilësimet e lehta fillestare), shtypni ↑/↓ për të zgjedhur [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit), më pas shtypni +.**
Shfaqet ekrani [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta fillestare).

8 Ndiqni udhëzimet në ekran për të kryer cilësimet e rrjetit duke përdorur $\leftarrow/\rightarrow/\uparrow/\downarrow$ dhe \square .

Nëse sistemi nuk mund të lidhet me rrjetin, shihni „Lidhja me rrjetin“ (faqe 77) ose „Lidhja LAN me valë“ (faqe 77).

Për të rishfaqur ekranin [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta fillestare)

- 1 Shtypni HOME.
Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.
- 2 Shtypni \leftarrow/\rightarrow për të zgjedhur  [Setup] (Konfigurimi).
- 3 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit), më pas shtypni \square .

Hapi 6: Zgjedhja e burimit të riprodhimit

Shtypni **FUNCTION** vazhdimisht derisa të shfaqet funksioni i dëshiruar në ekranin e panelit të sipërm.

Kur shtypni **FUNCTION** një herë, në ekranin e panelit të sipërm shfaqet funksioni aktual, më pas sa herë që shtypni **FUNCTION**, funksioni ndryshon me cikle si më poshtë.

„BD/DVD“ → „USB“ → „FM“ →
„HDMI1“ → „HDMI2“ → „TV“ →
„BT“ → „AUDIO“

Funksioni dhe burimi i riprodhimit

„BD/DVD“

Disku ose pajisja e rrjetit do të luhet nga sistemi

„USB“

Pajisja USB që lidhet me portën  (USB) (faqe 13)

„FM“

Radio FM (faqe 45)

„HDMI1“/„HDMI2“

Pajisja që është lidhur me folenë HDMI (IN 1) ose HDMI (IN 2) (faqe 23)

„TV“

Pajisja (televizori, etj.) që lidhet me folenë TV (DIGITAL IN OPTICAL), ose një televizor të përputhshëm me funksionin Audio Return Channel që është i lidhur me folenë HDMI (OUT) (faqe 22)

„BT“

Përmbajtja audio e një pajisjeje *Bluetooth*

„AUDIO“

Pajisja që është lidhur me folenë AUDIO (AUDIO IN L/R) (faqe 23)

Këshillë

- Disa funksione mund të ndryshohen përmes ekranit të televizorit duke shtypur **FUNCTION**, \uparrow/\downarrow dhe \square .
- Mund të shtypni gjithashtu **BLUETOOTH** në telekomandë për të zgjedhur funksionin „BT“.

Hapi 7: Shijoni tingujt rrethues

Pasi të kryeni hapat e mëparshëm dhe të filloni riprodhimin, ju mund të shijoni me lehtësi modalitetet e programuara paraprakisht të zërit të përshtatura për llojet e ndryshme të burimeve të zërave. Ato sjellin tingullin emocionues dhe të fuqishëm në shtëpinë tuaj.

Zgjedhja e modalitetit të zërit

Shtypni SOUND MODE vazhdimisht gjatë riprodhimit derisa të shfaqet modaliteti i dëshiruar në ekranin e panelit të sipërm ose në ekranin e televizorit.

Auto

Sistemi zgjedh automatikisht [Movie] (Modaliteti i zërit Film) or [Music] (Modaliteti i zërit Muzikë) për të prodhuar efektin zanor në varësi të diskut ose transmetimit të tingullit.

- Burim me 2 kanale: Sistemi simulon tingull rrethues nga burime me 2-kanale dhe nxjerr tingull nga altoparantët me kanale 5.1.
- Burim me shumë kanale: Sistemi nxjerr tingull nga altoparantët sipas regjistrimit.

Movie

Sistemi ofron zë të optimizuar për shikimin e filmave.

Music

Sistemi ofron zë të optimizuar për dëgjimin e muzikës.

Përmirësuesi i muzikës dixhitale

[Digital Music] (Muzikë dixhitale)

Sistemi riprodhon një tingull të përmirësuar për audio të ngjeshur.

3D Surround

[3D Surround] (Rrethues 3D) është një algoritëm unik nga Sony që ofron një përvojë 3D me tingullin me thellësi dhe prezencë duke krijuar një fushë virtuale tingulli pranë veshëve tuaj.

Berlin Philharmonic Hall

[Philharmonic Hall] (Salla Filarmonike)

Sistemi riprodhon tingullin karakteristik të një salle filarmonike të Berlinit për ta dëgjuar në një burim stereo 2-kanalësh, si në CD.

Night

E përshtatshme për të parë filma natën duke reduktuar zërat e lartë ndërkohë që dialogët i mban të qartë.

Tingulli demo

Sistemi ofron tingull të kapshëm, të përshtatshëm për demonstrime.

Këshillë

- Nëse vendosni modalitetin e tingullit në [Auto] dhe luani përmbajtje interneti të Orkestrës Filarmonike të Berlinit, do të zgjidhet automatikisht modaliteti i zërit [Philharmonic Hall] (Salla filarmonike) (vetëm për zonat ku ofrohet shërbimi).
- Kur struktura e altoparantëve është vendosur në [All Front] (Të gjithë përpara) dhe ju luani një burim shumëkanalësh, zgjidhni [Auto] ose [3D Surround] (Rrethues 3D) për të shijuar tingullin rrethues virtual.

Për të zgjedhur modalitetin e zërit nga menja e opsioneve

- 1 Shtypni OPTIONS dhe $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur [Sound Mode] (Modaliteti i zërit), pastaj shtypni \square .
- 2 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur modalitetin e zërit, më pas shtypni \square .

Për të zgjedhur balancuesin muzikor të programuar paraprakisht

Shtypni MUSIC EQ në mënyrë të përsëritur gjatë riprodhimit. Mund të zgjidhni zërin për t'iu përshtatur preferencave tuaja.

Sa herë që shtypni këtë buton, cilësimet ndryshojnë me cikle si më poshtë.
[Standard] → [Rock] → [Hiphop] → [Electronica]

Ju mund të zgjidhni balancuesin muzikor duke përdorur menynë e opsioneve në modalitetin e zërit [Music] (Modaliteti i zërit Muzikë).

Shënim

Modaliteti i zërit mund të zgjidhet vetëm kur [Sound Effect] (Efekti i zërit) vendoset në [Sound Mode On] (Modaliteti i zërit ndezur) (faqe 62). Kur [Sound Effect] (Efekti i zërit) vendoset në modalitet tjetër nga [Sound Mode On] (Modaliteti i zërit ndezur), cilësimet e modalitetit të zërit nuk aplikohen.

Këshillë

Për të shijuar burim me 2 kanale si p.sh. një CD në dalje me shumë kanale, ne ju rekomandojmë të zgjidhni [Auto] (Modaliteti i zërit Auto).

Zgjedhja e modalitetit futbollit

Shtypni FOOTBALL kur shikoni një transmetim të një ndeshjeje futbollit.

Ju mund të përjetoni ndjesinë e pranisë në stadium kur shikoni një transmetim ndeshjeje futbollit.

- [Football : Narration On] (Futboll: Narratimi aktiv): Mund të shijoni një ndjesi gjithëpërfshirëse të pranisë në një stadium futbollit me anë të brohoritjeve të zgjeruara të stadiumit.
- [Football : Narration Off] (Futboll: Narratimi joaktiv): Mund të shijoni një ndjesi edhe më gjithëpërfshirëse të pranisë në një stadium futbollit duke minimizuar nivelin e volumit të narratimit, përveç shtimit të brohoritjeve të zgjeruara.
- [Football Off] (Futboll joaktiv): Modaliteti i futbollit është i çaktivizuar.

Shënim

- Ne rekomandojmë që të zgjidhni modalitetin e futbollit kur shikoni një transmetim të një ndeshjeje futbollit.
- Nëse dëgjoni tinguj të panatyrshëm në përmbajtje kur [Football : Narration Off] (Futboll: Narratimi joaktiv) është i zgjedhur, [Football : Narration On] (Futboll: Narratimi joaktiv) rekomandohet në këtë rast.
- Modaliteti i futbollit do të çaktivizohet kur çaktivizoni sistemin.
- Kjo veçori nuk e mbështet zërin monofonik.


Këshillë


- Ju mund të zgjidhni gjithashtu modalitetin e futbollit nga menyuja e opsioneve.
- Nëse është i disponueshëm transmetimi audio 5,1-kanalësh, ne rekomandojmë që të zgjidhni atë në televizorin ose dekoderin tuaj.


Riprodhimi

Luajtja e një disku



Për disqet që mund të luhen shihni „Disqet që mund të luhen“ (faqe 78).


- 1 Ndryshojeni selektorin e hyrjes në televizorin tuaj në mënyrë që sinjali nga sistemi të shfaqet në ekranin e televizorit tuaj.**
- 2 Shtypni  dhe vendosni një disk në ndarjen e diskut deri sa të kërcasë.**





- 3 Shtypni  për të mbyllur kapakun e diskut.**

Riprodhimi fillon.

Nëse luajtja nuk fillon automatikisht, zgjidhni  në  [Video],

 [Music] (Muzikë), ose kategorinë

 [Photo] (Foto) dhe shtypni .

Shijimi i BONUSVIEW/ BD-LIVE

Disa BD-ROM me „BD-LIVE Logo*“ kanë përbajtur bonus dhe të dhëna të tjera që mund të shkarkohen për argëtim.

* BD 

1 Lidhni pajisjen USB me portën ψ (USB)(faqe 34).

Për magazinim lokal, përdorni një memorie USB 1 GB ose më të madhe.



2 Përgatituni për BD-LIVE (vetëm BD-LIVE).

- Lidhni sistemin me një rrjet (faqe 25).
- Caktoni [BD Internet Connection] (Lidhje interneti BD) në [Allow] (Lejo) (faqe 64).

3 Vendosni një BD-ROM me BONUSVIEW/BD-LIVE.

Mënyra e përdorimit ndryshon në varësi të diskut. Referojuni udhëzimeve të përdorimit në disk.

Këshillë

Për të fshirë të dhënat në memorien USB, zgjidhni [Delete BD Data] (Fshi të dhënat BD) në  [Video] dhe shtypni . Të gjitha të dhënat e ruajtura në dosjen buda do të fshihen.

Shijimi i Blu-ray 3D

Ju mund të shijoni disqe Blu-ray 3D me logon 3D*.



1 Përgatiteni për riprodhimin e diskut Blu-ray 3D.

- Lidhni sistemin me televizor të përputhshëm 3D duke përdorur një kablo HDMI të shpejtësisë së lartë (faqe 22).
- Caktoni [3D Output Setting] (Cilësimi i daljes 3D) dhe [TV Screen Size Setting for 3D] (Cilësimi i përmasës së ekranit të televizorit për 3D) në [Screen Settings] (Cilësimi i ekranit) (faqe 60).

2 Futni një disk Blu-ray 3D.

Mënyra e përdorimit ndryshon në varësi të diskut. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me diskun.


Këshillë




Referojuni gjithashtu udhëzimeve të përdorimit të televizorit tuaj të përputhshëm 3D.

Shfaqja e informacionit të riprodhimit

Ju mund të kontrolloni informacionin e riprodhimit, etj. duke shtypur DISPLAY. Informacioni i shfaqur ndryshon në varësi të llojit të diskut dhe statusit të sistemit.

Shembull: kur luani një BD-ROM




- 1 Rezolucioni i daljes/Frekuenca video
- 2 Numri ose emri i titullit
- 3 Cilësimi i zgjedhur aktualisht audio
- 4 Funkcionet e disponueshme (këndi , audio , titrat )
- 5 Informacioni i riprodhimit Shfaq modalitetin e luajtjes, shiritin e statusit të luajtjes, llojin e diskut, kodimin/dekodimin e videos, shpejtësia bit, llojin e përsëritjes, kohën e kapërcyer, kohën totale të luajtjes
- 6 Numri i kapitullit
- 7 Këndi i zgjedhur aktualisht

Luajtja nga një pajisje USB

Ju mund të luani skedarë video/muzike/foto në një pajisje të lidhur USB. Për llojet e skedarëve që mund të luhen, shihni „Llojet e skedarëve që mund të luhen“ (faqe 79).

1 Lidhni pajisjen USB me portën (USB).

Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes USB përpara se ta lidhni.



2 Shtypni HOME.

Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

3 Shtypni për të zgjedhur [Video], [Music] (Muzikë), ose [Photo] (Foto).

4 Shtypni për të zgjedhur [USB device] (Pajisja USB), më pas shtypni .

Shënim

Mos e shkëputni pajisjen USB gjatë punës. Për të shmangur dëmtimin e të dhënave ose dëmtimin e pajisjes USB fikni sistemin përpara se të lidhni ose shkëputni pajisjen USB.


Shijimi i muzikës nga një pajisje Bluetooth

Mbi teknologjinë Bluetooth me valë

Teknologjia *Bluetooth* me valë është një teknologji me rreze të shkurtër që mundëson komunikimin e të dhënave me valë mes pajisjeve dixhitale. Teknologjia *Bluetooth* me valë funksionon brenda një rrezeje rreth 10 metra.

Nuk nevojiten lidhje kablore për t'u lidhur si me një lidhje USB, dhe nuk nevojitet vendosja e pajisjeve ballë për ballë si me teknologjinë infra të kuqe me valë.

Teknologjia *Bluetooth* me valë është një standard global që mbështetet nga mijëra kompani. Këto kompani prodhojnë produkte që përputhen me standardin global.



Versioni dhe profilet e mbështetura Bluetooth

Profili i referohet një seti standard kapacitetesh për kapacitete të ndryshme të produkteve *Bluetooth*. Ky sistem mbështet versionin dhe profilet e mëposhtme *Bluetooth*.

Versioni i mbështetur *Bluetooth*: *Bluetooth* Versioni i specifikimit 3.0

Profilet e mbështetura *Bluetooth*:

A2DP 1.2 (Profili i përparuar i shpërndarjes audio)

AVRCP 1.3 (Profili i telekomandimit audio video)

Shënim



- Për të qenë në gjendje të përdorni funksionin *Bluetooth*, pajisja *Bluetooth* që do të lidhet duhet të mbështetë të njëjtin profil si ky sistem. Edhe nëse pajisja mbështet të njëjtin profil, funksionet mund të ndryshojnë në varësi të specifikimeve të pajisjes *Bluetooth*.
- Riprodhimi audio në këtë sistem mund të vonohet nga kjo në pajisjen *Bluetooth* për shkak të karakteristikave të teknologjisë *Bluetooth* me valë.

Çiftimi i këtij sistemi me një pajisje Bluetooth

Çiftimi është një veprim ku pajisjet *Bluetooth* regjistrojnë paraprakisht njëra-tjetrën. Pasi të kryhet veprimi i çiftimit, ai nuk ka nevojë të kryhet sërish.

1 Vendoseni pajisjen Bluetooth brenda 1 metri nga njësia kryesore.

2 Shtypni BLUETOOTH.

Ju mund të zgjidhni gjithashtu  [Bluetooth AUDIO] nga  [Input] (Hyrja) në menyne kryesore.

3 Vendosni pajisjen Bluetooth në modalitetin e çiftimit.

Për hollësira mbi vendosjen e pajisjes *Bluetooth* në modalitetin e çiftimit, referojuni udhëzimeve të përdorimit të marra me pajisjen.

4 Zgjidhni „BLU-RAY HOME THEATRE SYSTEM“ në ekranin e pajisjes Bluetooth.

Kryejeni këtë hap brenda 5 minutave, ndryshe çiftimi do të anulohet.

Shënim

Nëse kërkohet një kod në pajisjen *Bluetooth*, vendosni „0000“. Kodi mund të quhet „Kod“, „Kod PIN“, „Numër PIN“ ose „Fjalëkalim“.

5 Pasi të kryhet çiftimi, pajisja lidhet automatikisht me sistemin.

Emri i pajisjes shfaqet në ekranin e televizorit.

Shënim

Ju mund të çiftoni deri në 9 pajisje *Bluetooth*. Nëse lidhet një pajisje e 10-të *Bluetooth* the pajisja e lidhur më rrallë do të zëvendësohet me të rene.

6 Nisni luajtjen në pajisjen *Bluetooth*.

7 Rregulloni volumnin.

Rregulloni në fillim volumnin e pajisjes *Bluetooth*, nëse niveli i volumnit është ende shumë i ulët, rregulloni nivelin e volumnit në njësinë kryesore.

Për të anuluar veprimin e çiftimit

Shtypni HOME ose FUNCTION.

Lidhja me një pajisje *Bluetooth* nga ky sistem

Ju mund të lidheni me një pajisje *Bluetooth* nga kjo njësi kryesore.

Kontrolloni të mëposhtmet përpara se të luani muzikë:

- Funkcioni *Bluetooth* i pajisjes *Bluetooth* është i aktivizuar.
- Çiftimi është kryer (faqe 35).

1 Shtypni **BLUETOOTH**.

2 Shtypni **OPTIONS**.

Shënim

Për t'u lidhur me pajisjen *Bluetooth* të përdorur më së fundmi, shtypni ►. Më pas shkoni te hapi 5.

3 Shtypni ▲/▼ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur [Device List] (Lista e pajisjeve), më pas shtypni [+].

Shfaqet një listë e pajisjeve *Bluetooth* të çiftuara.

4 Shtypni ▲/▼ vazhdimisht për të zgjedhur pajisjen e dëshiruar, më pas shtypni [+].

5 Shtypni ► për të nisur riprodhimin.

6 Rregulloni volumnin.

Rregulloni në fillim volumnin e pajisjes *Bluetooth*, nëse niveli i volumnit është ende shumë i ulët, rregulloni nivelin e volumnit në njësinë kryesore.

Shënim

Pasi të lidhen njësi kryesore dhe pajisja *Bluetooth*, ju mund të kontrolloni riprodhimin duke shtypur ►, II, ■, ◀◀/▶▶ dhe ◀◀/▶▶.

Për të shkëputur pajisjen *Bluetooth*

Shtypni HOME, FUNCTION ose RETURN.

Për të fshirë një pajisje *Bluetooth* të çiftuar nga lista e pajisjeve

1 Ndiqni hapat 1 deri 3 më lart.

2 Shtypni ▲/▼ vazhdimisht për të zgjedhur pajisjen e dëshiruar, më pas shtypni **OPTIONS**.


3 Shtypni ▲/▼ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur [Remove] (Hiq) dhe më pas shtypni [+].

4 Ndiqni udhëzimet në ekran për të fshirë pajisjen duke përdorur ◀/▲/▼/▶ dhe [+].

Shënim

Kur është i lidhur me një pajisje *Bluetooth*, ky sistem nuk mund të dallohet dhe nuk mund të kryhet lidhje nga një pajisje tjetër *Bluetooth*.


Lidhja me një smartphone nga funksioni i dëgjimit me një prekje (NFC)

Duke mbajtur telefonin smartphone të përputhshëm me NFC pranë  në njësinë kryesore, njësia kryesore dhe telefoni smartphone vazhdojnë me kryerjen e çiftimit dhe lidhjes *Bluetooth* automatikisht.

Telefonat e përputhshëm smartphone

Telefonat smartphone me funksion të integruar NFC (OS: Android 2.3.3 – 4.0.x përveç Android 3.x)

Çfarë është „NFC“?

NFC (Near Field Communication) është një teknologji që mundëson komunikim me valë me rreze të shkurtër mes pajisjeve të ndryshme, siç janë celularët dhe etiketat IC. Falë funksionit NFC, komunikimi i të dhënave mund të arrihet lehtë thjesht duke e mbajtur pajisjen pranë  në pajisjet e përputhshme NFC.

1 Shkarkoni dhe instaloni aplikacionin „NFC Easy Connect“.

„NFC Easy Connect“ është aplikacion falas për telefonat smartphone të platformës Android dhe mund të merret në Google Play. Kërkoni aplikacionin duke përdorur fjalët „NFC Easy Connect“ në sajt, ose hyni në faqen e shkarkimit direkt duke lexuar kodin dy dimensional më poshtë.

Vini re se „NFC Easy Connect“ është falas por tarifat e komunikimit të të dhënave kur shkarkoni tarifohen veçmas.

Kodi dy dimensional* për hyrje direkte

* Përdorni një aplikacion për leximin e kodeve dy dimensionale.




Shënim

Aplikacioni mund të mos disponohet në disa shtete/rajone.

2 Nisni aplikacionin „NFC Easy Connect“ në telefonin smartphone.

Sigurohuni që të shfaqet ekran i aplikacionit.

3 Mbajeni telefonin smartphone pranë në njësinë kryesore deri sa telefoni smartphone të dridhet.



Dridhja kryhet kur telefoni smartphone njihet nga njësia kryesore. Pasi të njihet nga njësia kryesore, ndiqni udhëzimet në ekran të shfaqura në telefonin dhe kryeni procedurën për lidhjen *Bluetooth*.


Kur të kryhet lidhja *Bluetooth*, treguesi LED blu në panelin e sipërm ndalon pulsimin. Koha e riprodhimit shfaqet në ekranin e panelit të sipërm.

Shënim

- Sistemi njeh dhe lidhet vetëm me një pajisje të përputhshme NFC njëkohësisht.
- Në varësi të telefonit tuaj smartphone, mund të keni nevojë të aktivizoni paraprakisht funksionin NFC në telefonin smartphone. Për hollësi, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të telefonit smartphone.

Këshillë

Nëse dështon çiftimi dhe lidhja *Bluetooth*, veproni si më poshtë.

- Rinisni „NFC Easy Connect“ dhe lëvizini telefonin smartphone ngadalë mbi .
- Hiqni mbështjelljen mbrojtëse të telefonit smartphone nëse përdorni një mbështjellje mbrojtëse të blerë veçmas.

Për të dëgjuar muzikë


Nisni riprodhimin e një burimi audio në telefonin smartphone. Për hollësi mbi përdorimin e luajtjes, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të telefonit tuaj smartphone.

Këshillë

Nëse niveli i vullmit është i ulët, përshtatni në fillim vullmin e telefonit smartphone. Nëse niveli i vullmit është ende tepër i ulët, përshtatni nivelin e vullmit në njësinë kryesore.

Për të ndaluar luajtjen

Funksioni i luajtjes do të ndalojë kur të kryeni një prej veprimeve të mëposhtme:

- Mbjani telefonin smartphone pranë  në njësinë kryesore sërish.
- Ndaloni luajtësin e muzikës në telefonin smartphone.
- Fikni njësinë kryesore ose telefonin smartphone.
- Ndryshoni funksionin.
- Çaktivizoni funksionin *Bluetooth* në telefonin smartphone.

Luajtja përmes një rrjeti

Shijimi i Sony Entertainment Network (SEN)

Sony Entertainment Network shërben se portëkalim që ju ofron përmbajtje të zgjedhur nga interneti dhe një shumëllojshmëri argëtimi sipas kërkesës direkt në njësinë tuaj kryesore.

Këshillë

- Disa përmbajtje interneti kërkojnë regjistrim përmes një kompjuteri përpara se të luhen. Për detaje të mëtejshme, vizitoni faqen e mëposhtme të internetit:

Për klientët në Evropë dhe Rusi:
<http://support.sony-europe.com/>





Për klientët në vende/rajone të tjera:
<http://www.sony-asia.com/section/support>

- Disa përmbajtje interneti mund të mos jenë të disponueshme në disa shtete/rajone.

1 Përgatiteni për Sony Entertainment Network.

Lidhni sistemin me një rrjet (faqe 25).


2 Shtypni SEN.

- 3 Shtypni    për të zgjedhur përmbajtje nga interneti dhe një shumëllojshmëri argëtimi sipas kërkesës, atëherë shtypni .

Paneli i kontrollit për transmetimin video

Paneli i kontrollit shfaqet kur skedari video fillon të luhet. Artikujt e shfaqur mund të ndryshojnë në varësi të ofruesit të përmbajtjes nga interneti.

Për t'i shfaqur sërish, shtypni DISPLAY.




- 1 Ekran i kontrollit
Shtypni ◀/▶/⏮/⏭ ose + për veprimet e riprodhimit.
- 2 Shiriti i statusit të luajtjes
Shiriti i statusit, kursoi që tregon pozicionin aktual, koha e luajtjes, kohëzgjatja e skedarit video
- 3 Treguesi i gjendjes së rrjetit
Tregon fuqinë e sinjalit për një lidhje me valë.
Tregon një lidhje me tel.
- 4 Shpejtësia e transmetimit të rrjetit
- 5 Emri i skedarit të videos së radhës
- 6 Emri i skedarit të videos të zgjedhur aktualisht

Luajtja e skedarëve në një rrjet shtëpie (DLNA)

Ju mund të luani skedarë video/muzikorë/foto në pajisje të tjera të certifikuar DLNA duke lidhur ato me rrjetin e shtëpisë.

Kjo njësi kryesore mund të përdoret për luajtje dhe renderim.

- Serveri: Ruan dhe ndan përmbajtjen e medias dixhitale
- Luajtësi: Gjen dhe luan përmbajtje të medias dixhitale nga DMS
- Renderuesi: Merr dhe luan skedarë nga serveri, dhe mund të përdoret përmes një pajisjeje tjetër (kontrolluesi)
- Kontrolluesi: Përdor pajisjen renderuese




Përgatitni për përdorimin e funksionit DLNA.

- Lidhni sistemin me një rrjet (faqe 25).
- Përgatitni pajisje të tjera të certifikuar nga DLNA. Për hollësi, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes.


Për të luajtur skedarët e ruajtur në një server DLNA përmes sistemit (Luajtësi DLNA)

Zgjidhni ikonën DLNA të serverit [Video], [Music] (Muzikë), ose [Photo] (Foto) në menyën kryesore, më pas zgjidhni skedarin që dëshironi të luani.



Për të luajtur skedarë në distancë duke përdorur sistemin (Renderuesin) përmes një kontrolluesi DLNA

Ju mund ta përdorni sistemin me një një kontrollues të certifikuar DLNA (celular, etj), luani skedarët e ruajtur në një server DLNA.



Për detajat e përdorimit, referojuni udhëzimeve të përdorimit të kontrolluesit DLNA.

Shënim

Mos e përdorni këtë sistem me telekomandën e dhënë dhe një kontrollues DLNA në të njëjtën kohë.

Këshillë

Sistemi është i përputhshëm me funksionin „Play To“ të Windows Media® Player 12 që vjen si standard me Windows 7.

Luajtja e të njëjtës muzikë në dhoma të ndryshme (PARTY STREAMING)

Ju mund të luani të njëjtën muzikë në të njëjtën kohë në të gjithë komponentët Sony që janë të përputhshëm me funksionin PARTY STREAMING dhe të lidhur me rrjetin tuaj të shtëpisë.


Përmbajtja në [Music] (Muzikë) dhe funksionet „FM“, „BT“ dhe „AUDIO“ mund të përdoren me funksionin PARTY STREAMING.

Ekzistojnë dy lloje pajisjesh të përputhshme me PARTY STREAMING.

- Organizuesi i PARTY: Luan dhe dërgon muzikë.
- I ftuari në PARTY: Luan muzikën që merret nga organizatori i PARTY.

Kjo njësi kryesore mund të përdoret si organizatori i PARTY ose i ftuar në PARTY.






Organizatori i PARTY
(Ky sistem)



Përgatiteni për PARTY STREAMING.

- Lidhni sistemin me një rrjet (faqe 25).
- Lidhni pajisje që janë të përputhshme me funksionin PARTY STREAMING.



Për të përdorur sistemin si organizatori i PARTY

Zgjidhni një pjesë në  [Music] (Muzikë), një stacion radiofonik në  [Radio],  [AUDIO] or  [Bluetooth AUDIO] në  [Input] (Hyrje), shtypni OPTIONS. Më pas zgjidhni [Start PARTY] (Fillo PARTY) për të filluar. Për të mbyllur, shtypni OPTIONS, më pas zgjidhni [Close PARTY] (Mbyll PARTY).

Shënim

Nëse luhet përmbajtje që nuk është e përputhshme me funksionin PARTY STREAMING, sistemi e mbyll PARTY automatikisht.

Për të përdorur sistemin si i ftuar në PARTY

Zgjidhni  [PARTY] në  [Music] (Muzikë), më pas zgjidhni ikonën e pajisjes së organizatorit të PARTY. Për të dalë nga PARTY, shtypni OPTIONS, më pas zgjidhni [Leave PARTY] (Largohu nga PARTY). Për të mbyllur PARTY, shtypni OPTIONS, më pas zgjidhni [Close PARTY] (Mbyll PARTY).

Shënim




Shitja dhe radha e produkteve që janë të përputhshme me funksionin PARTY STREAMING ndryshojnë në varësi të zonës.




Kërkimi për informacion video/muzikor

Ju mund të merrni informacion përmbajtjeje duke përdorur teknologjinë Gracenote dhe të kërkoni informacion përkatës.

- 1 Lidhni sistemin me një rrjet (faqe 25).**
- 2 Futni një disk me përmbajtje për të cilën dëshironi kërkoni.**

Ju mund të kryeni kërkime video nga një BD-ROM ose DVD-ROM, dhe një kërkim muzikor nga CD-DA (CD muzikore).

3 Shtypni  për të zgjedhur  [Video] ose  [Music] (Muzikë).

4 Shtypni  për të zgjedhur  [Video Search] (Kërkimi video) ose  [Music Search] (Kërkimi muzikor).

Shfaqet informacioni i përmbajtjes (si p.sh. titulli, kasti, pjesa ose artisti), [Playback History] (Historiku i riprodhimit) dhe [Search History] (Historiku i kërkimit).

- [Playback History] (Historiku i riprodhimit)
Shfaq një listë të titujve BD-ROM/ DVD-ROM/CD-DA (CD muzikore) të luajtur më parë. Zgjidhni një titull për të marrë informacion mbi përmbajtjen.
- [Search History] (Historiku i kërkimit)
Shfaq një listë të kërkimeve të mëparshme të kryera përmes funksionit [Video Search] (Kërkim video) ose [Music Search] (Kërkim muzikor).

Për të kërkuar informacion shtesë të lidhur me të

Zgjidhni një artikull nga listat, më pas zgjidhni shërbimin për kërkimet.

Përdorimi i TV SideView

TV SideView është një aplikacion falas për pajisjet në distancë (telefonat smartphone, etj.). Duke përdorur TV SideView me këtë sistem, mund të shijoni me lehtësi sistemin duke përdorur pajisjen në distancë.

Ju mund të nisni një shërbim apo aplikacion direkt nga pajisja në distancë dhe të shikoni informacionin e diskut gjatë riprodhimit të diskut. TV SideView mund të përdoret gjithashtu si telekomandë dhe tastierë për softuerin.

Përpara se ta përdorni pajisjen TV SideView për herë të parë me këtë sistem, sigurohuni që ta regjistroni pajisjen TV SideView.

Ndiqni udhëzimet e shfaqura në ekranin e pajisjes TV SideView për regjistrimin.

Shënim

Regjistrimi do të jetë i mundur vetëm kur të shfaqet menyja kryesore në ekranin e televizorit.

Opsionet e disponueshme

Përdorime të riprodhimit dhe cilësime të ndryshme bëhen të disponueshme duke shtypur OPTIONS. Artikujt e disponueshëm ndryshojnë në varësi të situatës.

Opsionet e zakonshme

[Sound Mode] (Modaliteti i tingullit)

Ndryshon cilësimin e modalitetit të zërit (faqe 31).

[Football] (Futboll)

Zgjedh modalitetin e futbollit (faqe 32).

[Repeat Setting] (Përsërit cilësimin)

Vendos përsëritjen e riprodhimit.

[3D Menu] (Menyja 3D)

[Simulated 3D] (3D e stimuluar): Përshtat efektin e simuluar 3D.

[3D Depth Adjustment] (Përshtatja e thellësisë 3D): Përshtat thellësinë e imazheve 3D.

[2D Playback] (Riprodhimi 2D): Vendos riprodhimin e imazhit 2D.

[Play/Stop] (Luaj/Ndal)

Nis ose ndalon riprodhimin.

[Play from start] (Fillo nga fillimi)

Luan artikullin nga fillimi.

[Start PARTY] (Fillo PARTY)

Nis një party me burimin e përzgjedhur. Ky artikull mund të mos shfaqet në varësi të burimit.




[Leave PARTY] (Dil nga PARTY)

Del nga party në të cilën merr pjesë sistemi. Funkzioni PARTY STREAMING vazhdon mes pajisjeve të tjera pjesëmarrëse.

[Close PARTY] (Mbyll PARTY)

Për organizatorin e PARTY: Mbyll një party. Për të ftuarin në PARTY: Mbyll një party në të cilën merr pjesë sistemi. Funkzioni PARTY STREAMING përfundon për të gjitha pajisjet e tjera pjesëmarrëse.

[Change Category] (Ndrysho kategorinë)

Kalon nga kategoria  [Video],  [Music] (Muzikë) dhe  [Photo] (Foto) në „BD/DVD“ (vetëm për disqe) ose funksioni „USB“. Ky artikull disponohet vetëm kur lista e shfaqjes është e disponueshme për kategorinë.

Vetëm [Video]

[A/V SYNC]

Rregullon sinkronizimin mes figurës dhe zërit (faqe 44).

[3D Output Setting] (Cilësimi i daljes 3D)

Vendos nëse video 3D del apo jo automatikisht.

Shënim

Video 3D nga foleja HDMI (IN 1) ose HDMI (IN 2) del pavarësisht nga ky cilësim.

[Video Settings] (Cilësimet video)

- [Picture Quality Mode] (Modaliteti i cilësisë së figurës): Zgjedh cilësimet e figurës. [Auto] (Automatik), [Custom1] (Personalizuar1) dhe [Custom2] (Personalizuar2) janë të disponueshme vetëm për lidhjet HDMI.
- [Texture Remaster] (Ripërshtatja e strukturës): Rregullon mprehtësinë dhe detajet e skajëve.
- [Super Resolution] (Super rezolucion): Përmirëson rezolucionin.
- [Smoothing] (Zbutja): Redukton vijat në ekran duke zbutur gradacionet në zonat e sheshta.
- [Contrast Remaster] (Ripërshtatja e kontrastit): Rregullon automatikisht nivelet e të zezës dhe të bardhës në mënyrë që ekranin të mos jetë tepër i errët dhe imazhi rregullohet.
- [Clear Black] (Pastro të zezën): Rregullon elementët e errët të imazhit në ekran. Nuk shuhet të gjitha hijet; lejon tone të zeza të riproduhuara bukur.

[Pause] (Pauzë)

Vendos në pauzë riprodhimin.

[Main menu] (Menyja kryesore)

Shfaq menynë kryesore të BD-së ose DVD-së.

**[Menu/Popup Menu] (Menyja/
Menyja popup)**

Shfaq menynë kërcyese të BD-ROM ose DVD-së.

[Title Search] (Kërkimi i titujve)

Kërkon një titull në BD-ROM/DVD VIDEO dhe nis riprodhimin nga fillimi.

[Chapter Search] (Kërkimi i kapitujve)

Kërkon një kapitull dhe nis riprodhimin nga fillimi.

[Audio]

Zgjedh formatin/pjesën audio.

[Subtitle] (Titrat)

Zgjedh gjuhën e titrave kur në janë të regjistruara titra shumëgjuhëshe në BD-ROM-e/DVD VIDEO.

[Angle] (Këndi)

Kalon mes këndeve të shikimit kur në BD-ROM/DVD VIDEO janë regjistruar disa kënde.

[IP Content NR Pro] (NR Pro i përmbajtjes së IP)

Përshtat cilësinë e videos për përmbajtjen nga interneti.

[Video Search] (Kërkimi video)

Shfaq informacionin në BD-ROM/DVD-ROM bazuar në teknologjinë Gracenote.

Vetëm  [Music] (Muzikë)**[Add Slideshow BGM] (Shto shfaqje rrëshqitëse me muzikë sfondi)**

Regjistron skedarë muzikorë në memorien USB si shfaqje rrëshqitëse me muzikë sfondi (BGM).

[Music Search] (Kërkimi muzikor)

Shfaq informacionin në CD audio (CD-DA) bazuar në teknologjinë Gracenote.

Vetëm  [Photo] (Foto)**[Slideshow] (Shfaqje rrëshqitëse)**

Nis një shfaqje rrëshqitëse.

[Slideshow Speed]**(Shpejtësia e shfaqjes rrëshqitëse)**

Ndryshon shpejtësinë e shfaqjes rrëshqitëse.

[Slideshow Effect]**(Efekti i shfaqjes rrëshqitëse)**

Vendos efektin kur luhet një shfaqje rrëshqitëse.

[Slideshow BGM]**(Shfaqje rrëshqitëse BGM)**

- [Off] (Fikur): Fik funksionin.
- [My Music from USB] (Muzika ime nga USB): Vendos skedarët muzikorë të regjistruar në [Add Slideshow BGM] (Shto shfaqje rrëshqitëse me muzikë sfondi).
- [Play from Music CD] (Luaj nga CD muzikore): Vendos pjesët në CD-DA (CD muzikore).

[Change Display] (Ndrysho pamjen)

Kalon ndërmjet [Grid View] (Pamje tabelë) dhe [List View] (Pamje listë).

[Rotate Left] (Rrotullo majtas)

Rrotullon foton në drejtim të kundër të akrepave të orës me 90 gradë.

[Rotate Right] (Rrotullo djathtas)

Rrotullon foton në drejtim të akrepave të orës me 90 gradë.

[View Image] (Shiko imazhin)

Shfaq foton e zgjedhur.

Rregullimi i vonesës mes figurës dhe zërit

(A/V SYNC)

Kur zëri nuk përputhet me figurën në ekranin e televizorit, mund të rregulloni vonesën mes figurës dhe zërit për çdo funksion veçmas.

Mënyra e cilësimit ndryshon në varësi të funksionit.

Kur zgjidhet një funksion tjetër përveç „BT” ose „TV”

1 Shtypni **OPTIONS**.

Menyja e opsioneve shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni **↕/↕** për të zgjedhur [A/V SYNC], më pas shtypni **[+]**.

3 Shtypni **↔/↔** për të përshtatur vonesën dhe më pas shtypni **[+]**.

Ju mund të rregulloni nga 0 ms në 300 ms me rritje prej 25 ms.

Kur zgjidhet funksioni „TV”

1 Shtypni **OPTIONS**.

Në ekranin e panelit të sipërm shfaqet „AV.SYNC”.

2 Shtypni **[+]** ose **➔**.

3 Shtypni **↕/↕** për të përshtatur vonesën dhe më pas shtypni **[+]**.

Ju mund të rregulloni nga 0 ms në 300 ms me rritje prej 25 ms.

4 Shtypni **OPTIONS**.

Menyja e opsioneve në ekranin e panelit të sipërm fiket.

Përshtatja e zërit

Zgjedhja e formatit audio, pjesëve në disa gjuhë ose kanalit

Kur sistemi luan një BD/DVD VIDEO të regjistruar në disa formate audio (PCM, Dolby Digital, MPEG audio ose DTS), ose në pjesë me shumë gjuhë, ju mund të ndryshoni formatin ose gjuhën e audios. Me një CD, ju mund të zgjidhni zërin nga kanali i majtë ose i djathtë dhe mund të dëgjoni zërin e kanalit të zgjedhur përmes altoparlantit të majtë dhe të djathtë njëkohësisht.

Shtypni **AUDIO** në mënyrë të përsëritur gjatë riprodhimit për të zgjedhur sinjalin e dëshiruar audio.

Informacioni i audios shfaqet në ekranin e televizorit.

■ **BD/DVD VIDEO**

Opsioni i gjuhës varion në varësi të BD/DVD VIDEO.

Kur shfaqen 4 shifrat, ato përfaqësojnë kodin e gjuhës. Shihni „Lista e kodeve të gjuhëve“ (faqe 84). Kur e njëjta gjuhë shfaqet dy ose më shumë herë, BD/DVD VIDEO regjistrohet në disa formate audio.

■ **DVD-VR**

Shfaqen llojet e kolonave zanore të regjistruara në një disk.

Shembull:

- [♪ Stereo]
- [♪ Stereo (Audio1)]
- [♪ Stereo (Audio2)]
- [♪ Main] (Kryesore)
- [♪ Sub] (Nën)
- [♪ Main/Sub] (Kryesore/Nën)

Shënim

[♪ Stereo (Audio1)] dhe [♪ Stereo (Audio2)] nuk shfaqen nëse në disk regjistrohet vetëm një transmetim audio.

■ CD

- [♪ Stereo]: Tingulli standard stereo.
- [♪ 1/L]: Zëri i kanalit të majtë (marrje mono).
- [♪ 2/R]: Zëri i kanalit të djathtë (marrje mono).
- [♪ L+R]: Nga secili altoparlant del zëri i kanalit të majtë dhe të djathtë.

Shijimi i tingullit me transmetim multipleks

(DUAL MONO)

Ju mund të shijoni tingull me transmetim multipleks kur sistemi merr ose luan një sinjal Dolby Digital me transmetim multipleks.

Shënim

Për të marrë një sinjal Dolby Digital, duhet të lidhni një televizor ose pajisje tjetër me folenë TV (DIGITAL IN OPTICAL) me një kordon dixhital optik (faqet 22, 23).

Nëse foleja HDMI IN e televizorit tuaj është e përputhshme me funksionin Audio Return Channel (faqet 22, 65), ju mund të merrni një sinjal Dolby Digital përmes një kabloje HDMI.

Shtypni AUDIO vazhdimisht derisa të shfaqet sinjali i dëshiruar në ekranin e panelit të sipërm.

- „MAIN“: Do të dalë zëri i gjuhës kryesore.
- „SUB“: Do të dalë zëri i nën-gjuhës.
- „MN/SUB“: Do të dalë si zëri i gjuhës kryesore ashtu edhe i nën-gjuhëve.

Sintonizuesi

Dëgjimi i radios

1 Shtypni FUNCTION vazhdimisht derisa të shfaqet „FM“ në ekranin e panelit të sipërm.

2 Zgjidhni stacionin e radios.


Sintonizimi automatik

Mbani shtypur TUNING +/- derisa të nisë skanimi automatik.

[Auto Tuning] (Sintonizimi automatik) shfaqet në ekranin e televizorit. Skanimi ndalon kur sistemi sintonizohet në një stacion: Për të anuluar sintonizimin automatik, shtypni çdo buton.

Sintonizimi manual

Shtypni TUNING +/- vazhdimisht.




3 Shtypni  +/- vazhdimisht për të rregulluar volumnin.

Nëse një program FM është i zhurmshëm

Nëse një program FM është i zhurmshëm, mund të zgjidhni marrjen mono. Nuk do të ketë efekt stereo, por do të përmirësohet marrja.

1 Shtypni OPTIONS.

Menyja e opsioneve shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni   për të zgjedhur [FM Mode] (Modaliteti FM), më pas shtypni .

3 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur [Monaural] (Mono), më pas shtypni $\boxed{+}$.

- [Stereo]: Marrja stereo.
- [Monaural] (Mono): Marrja mono.

Këshillë

Ju mund të vendosni [FM Mode] (Modaliteti FM) veçmas për çdo stacion të paravendosur.

Për të fikur radion

Shtypni ⏻ .

Paravendosja e stacioneve të radios

Ju mund të paravendosni deri në 20 stacione. Përpara sintonizimit, sigurohuni që të ulni volumnin në minimum.

- 1 Shtypni FUNCTION vazhdimisht derisa të shfaqet „FM“ në ekranin e panelit të sipërm.
- 2 Mbani shtypur TUNING +/- derisa të nisë skanimi automatik.
Skanimi ndalon kur sistemi sintonizohet në një stacion:
- 3 Shtypni OPTIONS.
Menyja e opsioneve shfaqet në ekranin e televizorit.
- 4 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur [Preset Memory] (Paravendos memorien), më pas shtypni $\boxed{+}$.
- 5 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur numrin e paravendosjes që dëshironi, më pas shtypni $\boxed{+}$.

6 Përsëritni hapat 2 deri 5 për të ruajtur stacionet e tjera.

Për të ndryshuar një numër të paravendosur

Zgjidhni numrin e paravendosur të dëshiruar duke shtypur PRESET +/-, më pas kryeni procedurën nga hapi 3.

Zgjedhja e një stacioni të paravendosur

1 Shtypni FUNCTION vazhdimisht derisa të shfaqet „FM“ në ekranin e panelit të sipërm.

Radioja sintonizohet te stacioni i fundit i marrë.

2 Shtypni PRESET +/- në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur stacionin e paravendosur.

Numri i paravendosur dhe frekuenca shfaqen në ekranin e televizorit dhe ekranin e panelit të sipërm. Sa herë që shtypni këtë buton, sistemi sintonizohet në një stacion të paravendosur.

Këshillë

- Gjithashtu mund të zgjidhni stacionin e paravendosur direkt duke shtypur butonat e numrave.
- Sa herë që shtypni DISPLAY, afishimi në ekranin e panelit të sipërm ndryshon me cikle si më poshtë:
Frekuenca → Numri i paravendosur → Statusi i dekodimit*
- * Shfaqet kur [Sound Effect] (Efekti i zërit) caktohet në [Dolby Pro Logic], [DTS Neo:6 Cinema], or [DTS Neo:6 Music] (faqe 62).

Marrja e Radio Data System (RDS)

(Vetëm modelet evropiane)

Radio Data System (RDS) është një shërbim transmetimi që lejon stacionet e radios të dërgojnë informacion shtesë përgjatë sinjalit normal të programit. Ky sistem ofron veçori të dobishme, si p.sh. shfaqjen e emrit të stacionit.

Emri i stacionit shfaqet në ekranin e televizorit.

Thjesht zgjidhni një stacion nga banda FM.

Shënim

- RDS mund të mos funksionojë mirë nëse stacioni ku jeni sintonizuar nuk e transmeton sinjalin RDS mirë, ose nëse fuqia e sinjalit është e dobët.
- Jo të gjitha stacionet FM ofrojnë shërbim RDS, dhe as nuk ofrojnë të njëjtat lloje shërbimesh. Nëse nuk e njihni mirë sistemin RDS, kontaktoni stacionet të radiove lokale për detaje mbi shërbimet RDS në zonën tuaj.

Funksionet e tjera

Përdorimi i funksionit Control for HDMI (Kontroll për HDMI) për „BRAVIA“ Sync

Ky funksion është i disponueshëm në televizorët me funksionin „BRAVIA“ Sync. Duke lidhur pajisjet Sony që janë të përputhshme me funksionin Control for HDMI përmes një kabloje HDMI, përdorimi thjeshtohet.

Shënim

Për të përdorur funksionin Sinkronizimi „BRAVIA“, sigurohuni të ndizni sistemin dhe të gjitha pajisjet e lidhura pasi të kryeni lidhjen HDMI.

Control for HDMI - Cilësimi i lehtë

Ju mund të vendosni funksionin [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) automatikisht duke mundësuar cilësimin korrespondues në televizor. Për detaje mbi funksionin Control for HDMI, shihni „[HDMI Settings] (Cilësimet HDMI)“ (faqe 65)

Fikja e sistemit

Ju mund të fikni sistemin në sinkronizim me televizorin.

Shënim

Sistemi nuk fiket automatikisht gjatë luajtjes së muzikës ose kur është zgjedhur funksioni „FM“.

Luajtja me një prekje

Kur shtypni ► në telekomandë, sistemi dhe televizori ndizen dhe hyrja e televizorit kalon te hyrja HDMI në të cilën është lidhur sistemi.

Kontrolli i sistemit audio

Ju mund të shijoni zërin nga televizori ose pajisjet e tjera me një veprim të thjeshtë.

Ju mund të përdorni funksionin e kontrollit të sistemit audio si më poshtë:

- Kur sistemi ndizet, zëri i televizorit ose pajisjeve të tjera mund të nxirret nga altoparlantët e sistemit.
- Kur zëri nga televizori ose pajisjet e tjera nxirret përmes altoparlantëve të sistemit, ju mund të bëni që zëri të dalë nga altoparlantët e televizorit duke shtypur **SPEAKERS TV ↔ AUDIO**
- Kur zëri nga televizori ose pajisjet e tjera nxirret përmes altoparlantëve të sistemit, mund të rregulloni volumin dhe të fikni zërin e sistemit duke përdorur televizorin.

Audio Return Channel

Mund të shijoni zërin e televizorit përmes sistemit duke përdorur vetëm një kablo HDMI. Për detajet e cilësimit, shihni „[Audio Return Channel] (Kanali i kthimit audio)“ (faqe 65).

Ndjekja e gjuhës

Kur ndryshoni gjuhën e afishimit në ekranin e televizorit, ndryshon edhe gjuha e afishimit në ekranin e sistemit pas fikjes dhe ndezjes së sistemit.

Kontrolli i kursit

Kur kryeni luajtjen me një prekje në pajisjen e lidhur, sistemi ndizet dhe vendos funksionin e sistemit në „HDMI1“ ose „HDMI2“ (në varësi të folesë hyrëse HDMI në përdorim), dhe hyrja e televizorit tuaj vendoset automatikisht në hyrjen HDMI me të cilën është lidhur sistemi.

Kalibrimi automatik i cilësimeve të duhura për altoparlantët

[Auto Calibration] (Kalibrimi automatik)

D.C.A.C. CX (Digital Cinema Auto Calibration DX), në shqip: kalibrimi dixhital i kinemasë dixhitale, ju sjell përjetimin e tingullit duke përshtatur automatikisht cilësimin e distancës së altoparlantit, vendndodhjen dhe akustikën.

Shënim

- Sistemi nxjerr një sinjal të lartë testimi kur nis [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik). Volumin nuk mund ta ulni. Kini parasysh fëmijët dhe fqinjët.
- Përpara se të kryeni [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik), sigurohuni që të gjithë altoparlantët të jenë të lidhur me njësinë kryesore dhe me amplifikuesin rrethues.

1 Shtypni HOME.

Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni për të zgjedhur [Setup] (Konfigurimi).

3 Shtypni për të zgjedhur [Audio Settings] (Cilësimet audio), më pas shtypni .

4 Shtypni për të përzgjedhur [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik), më pas shtypni .

Ekрани [Select speaker layout.] (Zgjidhni vendosjen e altoparlantëve.) shfaqet.

5 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur cilësimin sipas pozicionimit të altoparlantëve, më pas shtypni $\boxed{+}$.

- **[Standard]:** Altoparlantët rrethues janë instaluar në pozicionin e pasmë.
- **[All Front]** (Të gjithë përpara): Të gjithë altoparlantët janë instaluar në pozicionin e përparmë.

Shfaqet ekrani i konfirmimit për [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik).

6 Lidhni mikrofonin e kalibrimit me folenë A.CAL MIC në panelin e pasmë.

Vendoseni mikrofonin e kalibrimit në nivelin e veshit duke përdorur trekëmbësh etj. (nuk jepet). Mikrofonin e kalibrimit duhet të drejtohet nga ekrani i televizorit. Pjesa e përparme e secilit altoparlant duhet të jetë përballë mikrofonit të kalibrimit dhe nuk duhet të ketë pengesa midis altoparlantëve dhe mikrofonit të kalibrimit.

7 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur [OK].

Për ta anuluar, zgjidhni [Cancel] (Anulo).

8 Shtypni $\boxed{+}$.

Fillon [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik).

Sistemi i rregullon cilësimet e altoparlantëve automatikisht. Mos bëni zhurmë gjatë matjes.

Shënim

- Përpara [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik), sigurohuni që amplifikuesi rrethues të jetë ndezur dhe ta keni instaluar amplifikuesin në pozicionin e duhur për të garantuar lidhjen me valë.
- Ndërkohë që [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik) është në progres, mos e përdorni sistemin.

9 Konfirmoni rezultatin e [Auto Calibration] (Kalibrimit automatik).

Distanca dhe niveli për secilin altoparlant shfaqen në ekranin e televizorit.

Shënim

Nëse matja dështon, ndiqni mesazhin më pas provoni sërish [Auto Calibration] (Kalibrimin automatik).

10 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur [OK] ose [Cancel] (Anulo), më pas shtypni $\boxed{+}$.

■ Matja është në rregull.

Shkëputni mikrofonin e kalibrimit, më pas zgjidhni [OK]. Rezultati u implementua.

■ Matja nuk është në rregull.

Ndiqni mesazhin, më pas zgjidhni [OK] për të riprovuar.

Cilësimi i altoparlantëve


[Speaker Settings] (Cilësimet e altoparlantëve)

Për të përfutur tingullin optimal rrethues, vendosni distancën e altoparlantëve nga pozicioni i dëgjimit. Më pas përdorni sinjalin testues për të rregulluar balancën e altoparlantëve.

1 Shtypni HOME.

Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni \leftrightarrow për të zgjedhur

 [Setup] (Konfigurimi).

3 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur [Audio Settings] (Cilësimet audio), më pas shtypni \oplus .

4 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur [Speaker Settings] (Cilësimet e altoparlantit), më pas shtypni \oplus .

Shfaqet ekrani [Select speaker layout.] (Zgjidhni vendosjen e altoparlantëve).

5 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur cilësimin sipas pozicionimit të altoparlantëve, më pas shtypni \oplus .

- [Standard]: Altoparlantët rrethues janë instaluar në pozicionin e pasmë.
- [All Front] (Të gjithë përpara): Të gjithë altoparlantët janë instaluar në pozicionin e përparmë.

Shënim

Të gjitha cilësimet rivendosen në cilësimet e paracaktuara sa herë që ndryshoni cilësimin e vendosjes së altoparlantëve.

6 Shtypni \uparrow/\downarrow të zgjedhur artikullin, më pas shtypni \oplus .

7 Shtypni \uparrow/\downarrow për të rregulluar parametrin.

8 Shtypni \leftrightarrow dhe \oplus për të konfirmuar cilësimet.

Kontrolloni cilësimet e mëposhtme.

■ [Distance] (Distanca)

Kur lëvizni altoparlantët, sigurohuni që të vendosni parametrat e distancës nga pozicioni i dëgjimit deri te altoparlantët. Ju mund të vendosni parametrat nga 0.0 në 7.0 metra.

[Front Left/Right] (I përparmë Majtas/Djathtas) 3.0 m: Vendos distancën e altoparlantit të përparmë.

[Centre] (Qendër) 3.0 m: Vendos distancën e altoparlantit qendror.

[Surround Left/Right] (Rrethues Majtas/Djathtas) 3.0 m: Vendos distancën e altoparlantit rrethues.

[Subwoofer] (Nën-vuferi) 3.0 m: Vendos distancën e nën-vuferit.

■ [Level] (Niveli)

Ju mund të rregulloni nivelin e zërit të altoparlantëve. Ju mund të vendosni parametrat nga -6.0 dB në +6.0 dB. Sigurohuni të vendosni [Test Tone] (Sinjali i testimit) në [On] (Ndezur) për rregullim të lehtë.

[Front Left/Right] (I përparmë Majtas/Djathtas) 0.0 dB: Vendos nivelin e altoparlantit të përparmë.

[Centre] (Qendër) 0.0 dB: Vendos nivelin e altoparlantit qendror.

[Surround Left/Right] (Rrethues Majtas/Djathtas) 0.0 dB: Vendos nivelin e altoparlantit rrethues.

[Subwoofer] (Nën-vuferi) 0.0 dB: Vendos nivelin e nën-vuferit.

■ [Relocation] (Zhvendosje)

Ju mund të korrighoni virtualisht pozicionin e altoparlantit për të përmirësuar efektin rrethues.

[On] (Ndezur): Mund të dëgjoni nga një pozicion altoparlanti të zhvendosur virtualisht të përcaktuar nga [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik).

[Off] (Fikur): Ju mund të dëgjoni tingull nga pozicioni aktual i altoparlantit.

Shënim

- Ky cilësim reflektohet vetëm pas kryerjes së [Auto Calibration] (Kalibrimit automatik).
- Nuk mund ta zgjidhni këtë funksion kur struktura e altoparlantëve është caktuar në [All Front] (Të gjithë përpara).

■ [Test Tone] (Sinjali i testimit)

Altoparlantët lëshojnë një sinjal testues për të rregulluar [Level] (Nivelin).

[Off] (Fikur): Altoparlantët nuk lëshojnë sinjalin testues.

[On] (Ndezur): Kur rregullohet niveli, nga secili altoparlant radhazi del sinjali testues. Kur zgjidhni një nga artikujt e [Speaker Settings] (Cilësimet e altoparlantit), nga secili altoparlant radhazi del sinjali testues. Rregulloni nivelin e zërit si më poshtë.

- 1 Caktoni [Test Tone] (Sinjali testues) to [On] (Ndezur).
- 2 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur [Level] (Niveli), më pas shtypni $\boxed{+}$.
- 3 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur llojin e altoparlantit, më pas shtypni $\boxed{+}$.
- 4 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur altoparlantin e majtë ose të djathtë, më pas shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të rregulluar nivelin.
- 5 Shtypni $\boxed{+}$.
- 6 Përsëritni hapat 3 deri 5.

7 Shtypni RETURN.

Sistemi kthehet në ekranin e mëparshëm.

8 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur [Test Tone] (Tingulli i testimit), më pas shtypni $\boxed{+}$.**9 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur [Off] (Fikur), më pas shtypni $\boxed{+}$.****Shënim**

Sinjalet e testimit nuk dalin nga foleja HDMI (OUT).

Këshillë

Për të rregulluar volumin e altoparlantëve njëkohësisht, shtypni \triangleleft +/-.

Përdorimi i kohëmatësit të fjetjes

Ju mund të vendosni sistemin të fiket në një kohë të caktuar, në mënyrë që të flini gjumë duke dëgjuar muzikë. Koha mund të paravendoset në intervale prej 10 minutash.

Shtypni SLEEP.

Sa herë që shtypni SLEEP, ekranin e minutave (koha e mbetur) në ekranin e panelit të sipërm ndryshon me nga 10 minuta.

Kur vendosni kohëmatësin e fjetjes, koha e mbetur shfaqet çdo 5 minuta.

Kur koha e mbetur është më pak se 2 minuta, „SLEEP“ pulson në ekranin e panelit të sipërm.

Për të kontrolluar kohën e mbetur

Shtypni SLEEP një herë.

Për të ndryshuar kohën e mbetur

Shtypni SLEEP vazhdimisht.

Çaktivizimi i butonave në njësinë kryesore

(Bllokimi për fëmijët)

Ju mund të çaktivizoni butonat në njësi kryesore (përveç I/⏻) për të parandaluar keqpërdorimin, si për shembull ngacmimet që bëjnë fëmijët.

Prekni dhe mbani të shtypur ■ në njësinë kryesore për më shumë se 5 sekonda.

„LOCKED“ shfaqet në ekranin e panelit të sipërm.

Funksioni i bllokimit për fëmijët aktivizohet dhe butonat në njësinë kryesore bllokohen. (Ju mund të përdorni sistemin duke përdorur telekomandën.)

Për të anuluar, prekni dhe mbani të shtypur ■ për më shumë se 5 sekonda derisa të shfaqet „UNLOCK“ në ekranin e panelit të sipërm.

Shënim

Nëse përdorni butonat në njësinë kryesore ndërkohë që funksioni i bllokimit për fëmijët është ndezur, „LOCKED“ pulson në ekranin e panelit të sipërm.

Përdorimi i ndriçimit të altoparlantëve

(vetëm BDV-N9100WL/
BDV-N7100WL)

SPEAKER ILLUMINATION

Pjesa e poshtme e altoparlantëve të përparmë dhe altoparlantëve rrethues ndriçohet kur ndizet njësia kryesore.

Për të çaktivizuar ndriçimin e altoparlantëve, shtypni SPEAKER ILLUMINATION.

Kontrollimi i televizorit ose pajisjeve të tjera me telekomandën e dhënë














Shënim

Kur zëvendësoni bateritë në telekomandë, cilësimi i telekomandës mund të rivendoset në cilësimin e paracaktuar (SONY).

Kontrolli i pajisjes suaj me telekomandën e dhënë

- 1 Shtypni TV ose STB që përputhet me pajisjen që dëshironi të kontrolloni.
- 2 Shtypni butonat e përshtatshëm të renditur në tabelën e mëposhtme.
 - : Butoni mund të përdoret me cilësimin e parazgjedhur të telekomandës.
 - : Butoni mund të përdoret kur ndryshoni kodin e paravendosjes së telekomandës.

Butoni	Modaliteti i telekomandës	
	TV	STB
AV I/⏻	●	●
Butonat e numrave	●	●
☰	●	●
ENTER (-/-)	●	○
Butonat me ngjyra	●	●
TOP MENU (☰)	●	●
↔/↕/↔/↕, □	●	●
RETURN	●	●
OPTIONS	●	○
HOME (MENU)	●	●
SEN	●	

Butoni	Modaliteti i telekomandës	
	TV	STB
SOUND MODE ()	●	○
AUDIO	●	○
SUBTITLE	●	●
DISPLAY ( )	●	●
	●	○
	●	○
	●	○
	●	○
	●	●
	●	●
PROG +/- ( / )	●	●
SLEEP ( )	●	●

Shënim

- Në modalitetin TV ose STB, nëse shtypni një nga butonat e mësipërm, ndizet butoni TV ose STB. (Megjithatë, në varësi të kodit të vendosur, disa butona mund të mos funksionojnë, dhe butoni TV ose STB mund të mos ndizet.)
- Në varësi të televizorit ose pajisjes, mund të mos jeni në gjendje të përdorni disa nga butonat.



Ndryshimi i kodit të paravendosjes së telekomandës (Modaliteti i paravendosjes)



Ju mund të kontrolloni pajisjet që nuk janë Sony duke ndryshuar kodin e paravendosjes së telekomandës.



1 Shtypni HOME.



Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni për të zgjedhur [Setup] (Konfigurimi).

3 Shtypni  për të zgjedhur [Remote Controller Setting Guide] (Udhëzuesi i cilësimeve të telekomandës), më pas shtypni .

4 Shtypni  për të zgjedhur [Preset Mode] (Modaliteti i paravendosjes), më pas shtypni .

5 Shtypni  për të zgjedhur llojin e pajisjes që dëshironi të përdorni me telekomandën e dhënë, më pas shtypni .

6 Shtypni  për të zgjedhur prodhuesin e pajisjes, më pas shtypni .

7 Shtypni POP UP/MENU ndërkohë që shtypni TV (për një televizor) ose STB (për një dekoder kabllor, marrës dixhital satelitor, video-regjistruar dixhital, etj.).


8 Kur butoni TV ose STB fillon të pulsojë, vendosni kodin në ekranin e televizorit duke përdorur butonat e numrave, më pas shtypni ENTER.

Nëse vendosni me sukses kodin, butoni TV ose STB do të pulsojë dy herë ngadalë. Nëse cilësimi është i pasuksesshëm, butoni TV ose STB do të pulsojë pesë herë shpejt.

Shënim

- Ju mund të dilni nga Modaliteti i paravendosjes duke shtypur butonin TV ose STB (butonin që pulson).
- Nëse nuk e përdorni telekomandën për më shumë se 10 sekonda gjatë modalitetit të paravendosjes, telekomanda del nga modaliteti i paravendosjes.

Rivendosja e telekomandës

- 1 Ndërsa mbani shtypur AV I/⏻, mbani të shtypur  – dhe më pas shtypni PROG –.**

Butonat BD, TV dhe STB ndizen.

- 2 Lëshoni të gjithë butonat.**

Butonat BD, TV dhe STB fiken dhe fshihet kodi i paravendosjes.

Telekomanda kthehet në cilësimet e parazgjedhura.

Kursimi i energjisë në modalitetin e pritjes

Kontrolloni që të keni kryer cilësimet e mëposhtme:

- [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) në [HDMI Settings] (Cilësimet HDMI) është caktuar në [Off] (Fikur) (faqe 65).
- [Quick Start Mode] (Modaliteti i ndezjes së shpejtë) është caktuar në [Off] (Fikur) (faqe 65).
- [Remote Start] (Ndezja në distancë) në [Network Settings] (Cilësimet e rrjetit) është caktuar në [Off] (Fikur) (faqe 67).


Shfletimi i faqeve të internetit




- 1 Përgatiteni për shfletim në internet.**

Lidhni sistemin me një rrjet (faqe 25).

- 2 Shtypni HOME.**

Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

- 3 Shtypni  për të zgjedhur [Network] (Konfigurimi).**

- 4 Shtypni / për të zgjedhur [Internet Browser] (Shfletuesi i internetit), më pas shtypni .**

Shfaqet ekranin [Internet Browser] (Shfletuesi i internetit).

Shënim

Disa uebsajte mund të mos shfaqen saktë, ose mund të mos funksionojnë.

Për të vendosur një URL

Zgjidhni [URL entry] (Hyrje URL) nga menyja e opsioneve.

Vendosni URL duke përdorur tastierën e softuerit, më pas zgjidhni [Enter] (Hyrje).

Për të vendosur faqen e parazgjedhur të nisjes

Ndërsa afshohet faqja që dëshironi të vendosni, zgjidhni [Set as start page] (Vendos si faqe nisjeje) nga menyja e opsioneve.

Për t'u kthyer në faqen e mëparshme


Zgjidhni [Previous page] (Faqja e mëparshme) nga menyuja e opsioneve. Kur faqja e mëparshme nuk shfaqet edhe nëse zgjidhni [Previous page] (Faqja e mëparshme), zgjidhni [Window List] (Lista e dritareve) nga menyuja e opsioneve dhe zgjidhni faqen të e cila dëshironi të ktheheni nga lista.

Për të mbyllur shfletuesin e internetit

Shtypni HOME.

Ekranin e shfletuesit të internetit

Ju mund të kontrolloni informacionin e uebsajtit duke shtypur DISPLAY. Informacioni i shfaqur ndryshon në varësi të llojit të uebsajtit dhe statusit të faqes.



- 1 Titulli i faqes
- 2 Adresa e faqes
- 3 Kursori
Lëvizni duke shtypur $\leftarrow/\uparrow/\downarrow/\rightarrow$.
Vendosni kursorin në lidhjen që dëshironi të shikoni, më pas shtypni \square . Shfaqet uebsajti i lidhur.
- 4 Ikona SSL
Shfaqet kur URL e lidhur është e mbrojtur.
- 5 Treguesi i fuqisë së sinjalit
Shfaqet kur sistemi lidhet me një rrjet me valë.
- 6 Shiriti i progresit/Ikona e ngarkimit
Shfaqet kur faqja është duke u lexuar, ose gjatë shkarkimit/transferimit të skedarëve.
- 7 Fusha e futjes së tekstit
Shtypni \square dhe më pas zgjidhni [Input] (Teksti i hyrjes) nga menyuja e opsioneve për të hapur tastierën e softuerit.
- 8 Shiriti i lëvizjes
Shtypni $\leftarrow/\uparrow/\downarrow/\rightarrow$ për të lëvizur ekranin e faqes majtas, lart, poshtë ose djathtas.

Opsionet e disponueshme

Përdorime dhe cilësime të ndryshme bëhen të disponueshme duke shtypur OPTIONS. Artikujt e disponueshëm ndryshojnë në varësi të situatës.

[Browser Setup] (Konfigurimi i shfletuesit)

Shfaq cilësimet e shfletuesit të internetit.

- [Zoom] (Zmadhimi): Ul ose rrit përmasën e përmbajtjes së shfaqur.
- [JavaScript Setup] (Konfigurimi i JavaScript): Vendos nëse aktivizohet ose çaktivizohet JavaScript.
- [Cookie Setup] (Konfigurimi i kukive): Vendos nëse pranohen cookie nga shfletuesi.
- [SSL Alarm Display] (Shfaqja e alarmit SSL): Vendos nëse aktivizohet ose çaktivizohet SSL.

[Window List] (Lista e dritareve)

Shfaq një listë të të gjitha uebsajteve të hapura aktualisht.

Ju lejon të ktheheni te një uebsajt i shfaqur më parë duke zgjedhur dritaren.

[Bookmark List] (Lista e faqeshënuesve)

Shfaq listën e faqeshënuesve.

[URL entry] (Hyrja URL)

Ju lejon të vendosni një URL kur shfaqet tastiera e softuerit.

[Previous page] (Faqja e mëparshme)

Zhvendoset te një faqe e shfaqur më parë.

[Next page] (Faqja tjetër)

Zhvendoset te faqja e shfaqur më pas.

[Cancel loading] (Anulo ngarkimin)

Ndalon ngarkimin e një faqeje.

[Reload] (Ringarko)

Ringarkon të njëjtën faqe.

[Add to Bookmark] (Shto te faqeshënuesit)

Shton uebsajtin e hapur aktualisht në listën e faqeshënuesve.

[Set as start page] (Vendos si faqe nisjeje)

Vendos uebsajtin e shfaqur aktualisht si faqen e parazgjedhur të nisjes.

[Open in new window] (Hap në dritare të re)

Hap një lidhje në dritare të re.

[Character encoding]

(Enkodimi i karaktereve)

Vendos sistemin e kodimit të karaktereve.

[Display certificate] (Shfaq certifikatën)

Shfaq certifikatën e serverit të dërguar nga faqet që mbështesin SSL.

[Input] (Hyrja)

Shfaq tastierën e softuerit për të vendosur karakteret gjatë shfletimit të një uebsajti.

[Break] (Ndërprit)

Zhvendos kursorin në linjën tjetër në fushën e futjes së tekstit.

[Delete] (Fshi)

Fshin një karakter në të majtë të kursorit gjatë futjes së tekstit.

Cilësime të tjera për sistemin me valë

Aktivizimi i transmetimit me valë midis njësisë të caktuara

[Secure Link] (Lidhje e sigurt)

Mund të përcaktoni lidhjen me valë për të lidhur njësinë qendrore me amplifikuesin shumëkanalësh me anë të funksionit Secure Link.

Ky funksion mund të ndihmojë në parandalimin e interferencave nëse përdorni disa produkte me valë ose nëse përdorin produkte me valë fqinjët tuaj.

1 Shtypni HOME.

Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni për të zgjedhur [Setup] (Konfigurimi).

3 Shtypni për të zgjedhur [System Settings] (Cilësimet e sistemit) dhe më pas shtypni .

4 Shtypni për të zgjedhur [Wireless Sound Connection] (Lidhja me valë e zërit) dhe shtypni .

Shfaqet ekranin [Wireless Sound Connection] (Lidhja me valë e zërit).

5 Shtypni për të zgjedhur [Secure Link] (Lidhje e sigurt) dhe shtypni .

6 Shtypni për të zgjedhur [On] (Aktive) dhe më pas shtypni .

7 Shtypni SECURE LINK në pjesën e pasme të amplifikuesit rrethues. Vijoni me hapin tjetër pas pak çastesh.

8 Shtypni për të zgjedhur [Start] (Nis) dhe shtypni .

Për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm zgjidhni [Cancel] (Anulo).

9 Pas shfaqjes së mesazhit [Secure Link setting is complete.] (Konfigurimi i Lidhjes së sigurt përfundoi.) shtypni .

Amplifikuesi shumëkanalësh është lidhur me njësinë qendrore dhe treguesi LINK/STANDBY bëhet portokalli.

Nëse shfaqet mesazhi [Cannot set Secure Link.] (Nuk mund të caktohet Lidhja e sigurt.) ndiqni mesazhet në ekran.

Për të anuluar funksionin Secure Link

Për njësinë kryesore

Zgjidhni [Off] (Fikur) në hapin 6 më lart.

Për amplifikuesin shumëkanalësh

Mbani të shtypur SECURE LINK në pjesën e pasme të amplifikuesit rrethues derisa treguesi LINK/STANDBY të bëhet i gjelbër ose të pulsojë në të gjelbër.

Nëse transmetimi me valë është i paqëndrueshëm

[RF Channel] (Kanali RF)

Nëse përdorni disa sisteme me valë, si p.sh. LAN (rrjet zone lokale) me valë ose Bluetooth, sinjalet e valëve mund të jenë të paqëndrueshme. Në raste të tilla transmetimi mund të përmirësohet duke ndryshuar cilësimin e mëposhtëm [RF Channel] (Kanali RF).

1 Shtypni HOME.

Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni për të zgjedhur [Setup] (Konfigurimi).

3 Shtypni për të zgjedhur [System Settings] (Cilësimet e sistemit) dhe më pas shtypni .

4 Shtypni për të zgjedhur [Wireless Sound Connection] (Lidhja me valë e zërit) dhe shtypni .

Shfaqet ekranin [Wireless Sound Connection] (Lidhja me valë e zërit).

5 Shtypni për të zgjedhur [RF Channel] (Kanali RF) dhe shtypni .

6 Shtypni për të zgjedhur cilësimin që dëshironi dhe më pas shtypni .

- [Auto] (Automatike): Normalisht zgjidhni këtë. Sistemi zgjedh automatikisht kanalin më të mirë për transmetim.
- [1], [2], [3]: Sistemi transmeton zë duke rregulluar kanalin për transmetim. Zgjidhni kanalin me transmetimin më të mirë.

Shënim

Transmetimi mund të përmirësohet duke ndryshuar kanalin e transmetimit (frekuencën) e sistemit(ëve) të tjera me valë. Për hollësi, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të sistemit(ëve) të tjera me valë.

Cilësimet dhe përshtatjet

Përdorimi i ekranit të konfigurimit

Ju mund të kryeni rregullime të ndryshme të artikujve siç janë figura dhe zëri. Cilësimet e parazgjedhura nënvizohen.

Shënim




Cilësimet e riprodhimit të ruajtura në disk kanë prioritet përpara cilësimeve të ekranit të konfigurimit. Prandaj, disa funksione mund të mos kryhen.










1 Shtypni HOME.

Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni për të zgjedhur [Setup] (Konfigurimi).

3 Shtypni për të zgjedhur ikonën e kategorisë që do të ndryshoni, më pas shtypni .

Ikona	Shpjegimi
	[Remote Control Setting Guide] (Udhëzuesi i cilësimeve të telekomandës) (faqe 59) Kryen cilësimet e telekomandës për përdorimin e televizorit ose pajisjeve të tjera.
	[Network Update] (Cilësimet e rrjetit) (faqe 59) Përditëson softuerin e sistemit.
	[Screen Settings] (Cilësimet e ekranit) (faqe 60) Kryen cilësimet e ekranit sipas llojit të televizorit.

Ikona	Shpjegimi
	[Audio Settings] (Cilësimet audio) (faqe 62) Kryen cilësimet e audios sipas llojit të foleve që lidhen.
	[BD/DVD Viewing Settings] (Cilësimet e shikimit BD/DVD) (faqe 63) Kryen cilësimet të detajuara për riprodhimin BD/DVD.
	[Parental Control Settings] (Cilësimet e kontrollit prindëror) (faqe 64) Kryen cilësimet të detajuara për funksionin e Kontrollit Prindëror.
	[Music Settings] (Cilësimet e muzikës) (faqe 64) Kryen cilësimet të detajuara për riprodhimin Super Audio CD.
	[System Settings] (Cilësimet e sistemit) (faqe 64) Kryen cilësimet e lidhura me sistemin.
	[External Input Settings] (Cilësimet e hyrjes së jashtme) (faqe 66) Vendos cilësimin e kapërcimit të hyrjes për secilën hyrje të jashtme.
	[Network Settings] (Cilësimet e rrjetit) (faqe 66) Kryen cilësimet të detajuara për internetin dhe rrjetin.
	[Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit) (faqe 68) Ekzekuton [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit) për të kryer cilësimet bazë të rrjetit.
	[Resetting] (Rivendosja) (faqe 68) Rivendos sistemin në cilësimet e fabrikës.

? [Remote Control Setting Guide] (Udhëzuesi i cilësimeve të telekomandës)

■ [Preset Mode] (Modaliteti i paravendosjes)

Ju mund të ndryshoni kodin e paravendosjes së telekomandës për kontrollin e pajisjeve që nuk janë Sony. Për detaje shihni „Ndryshimi i kodit të paravendosjes së telekomandës (Modaliteti i paravendosjes)*“ (faqe 53).

↻ [Network Update] (Cilësimet e rrjetit)

Duke përditësuar softuerin me versionin më të fundit, mund të përfitonit nga funksionet më të reja.

Për informacion mbi funksionet e përditësimit, referojuni uebsajteve të mëposhtme:

Për klientët në Evropë dhe Rusi:
<http://support.sony-europe.com/>

Për klientët në vende/rajone të tjera:
<http://www.sony-asia.com/section/support>

Gjatë një përditësimi softueri, „UPDATE“ shfaqet në ekranin e panelit të sipërm. Pasi kryhet përditësimi, njësia kryesore fiket automatikisht.

Gjatë kohës që kryhet përditësimi mos e fikni apo ndizni njësinë kryesore, ose mos e vini në punë njësinë kryesore apo televizorin. Prisni që përditësimi i softuerit të përfundojë.

[Screen Settings] (Cilësimet e ekranit)

■ [3D Output Setting] (Cilësimet e daljes 3D)

[Auto]: Normalisht zgjidhni këtë.

[Off] (Fikur): Zgjidhni këtë për të shfaqur të gjithë përmbajtjen në 2D.

Shënim

Video 3D nga foleja HDMI (IN 1) ose HDMI (IN 2) del pavarësisht nga ky cilësim.

■ [TV Screen Size Setting for 3D] (Cilësimet e përmasës së ekranit të televizorit për 3D)

Vendos përmasën e ekranit të televizorit tuaj të përputhshëm 3D.

Shënim

Ky cilësim nuk funksionon për video 3D nga foleja HDMI (IN 1) ose HDMI (IN 2).

■ [TV Type] (Lloji i televizorit)

[16:9]: Zgjidhni këtë kur lidhni me një televizor me ekran të gjerë ose një televizor me një funksion për modalitet të gjerë.

[4:3]: Zgjidhni këtë kur lidhni me një televizor 4:3 pa funksion për modalitet të gjerë.

■ [Screen Format] (Formati i ekranit)

[Full] (I plotë): Zgjidhni këtë kur lidhni me një televizor me funksion për modalitet të gjerë. Shfaq një pamje 4:3 në raport pamjeje 16:9 edhe në televizorë me ekran të gjerë.

[Normal]: Ndryshon përmasën e pamjes që të përputhë përmasën e ekranit me raportin original të pamjes.

■ [DVD Aspect Ratio] (Raporti i pamjes DVD)

[Letter Box] (Kuti me kashe): Shfaq një pamje të gjerë me shirita të zinj lart dhe poshtë.



[Pan & Scan] (Panoramike dhe e prerë): Shfaq një pamje me lartësi të plotë, me anë të prera.



■ [Cinema Conversion Mode] (Modaliteti i konvertimit të kinemasë)

[Auto]: Normalisht zgjidhni këtë. Njëسيا kryesore dikton automatikisht nëse materiali është video ose film, dhe kalon në metodën e përshtatshme të konvertimit. [Video]: Metoda e konvertimit e përshtatshme për materialin video do të zgjidhet gjithmonë pavarësisht nga materiali.

■ [Output Video Resolution] (Rezolucioni i daljes video)

[Auto]: Nxjerr sinjale video sipas rezolucionit të televizorit ose pajisjeve të lidhura.

[Original Resolution] (Rezolucioni origjinal): Nxjerr sinjale video sipas rezolucionit të regjistruar në disk. (Kur rezolucioni është më i vogël se rezolucioni SD, shkalla e tij rritet deri te rezolucioni SD.) [480i/576i]*, [480p/576p]*, [720p], [1080i], [1080p]: Nxjerr sinjale video sipas cilësimit të zgjedhur të rezolucionit.

* Nëse sistemi i ngjyrave në disk është NTSC, rezolucioni i sinjaleve video mund të konvertohet vetëm në [480i] dhe [480p].

■ [BD-ROM 24p Output] (Dalja 24p BD-ROM)

[Auto]: Nxjerr sinjale video 24p vetëm kur lidhet me një televizor të përputhshëm 1080/24p përmes një lidhjeje HDMI dhe [Output Video Resolution] ((Rezolucioni i daljes video)) vendoset në [Auto] ose [1080p].
 [On] (Ndezur): Zgjidhni këtë kur televizori është i përputhshëm me sinjalet video 1080/24p.

[Off] (Fikur): Zgjidhni këtë kur televizori nuk është i përputhshëm me sinjalet video 1080/24p.

■ [DVD-ROM 24p Output] (Dalja 24p DVD-ROM)

[Auto]: Nxjerr sinjale video 24p vetëm kur lidhet me një televizor të përputhshëm 1080/24p përmes një lidhjeje HDMI dhe [Output Video Resolution] (Rezolucioni video në dalje) vendoset në [Auto] ose [1080p].

[Off] (Fikur): Zgjidhni këtë kur televizori nuk është i përputhshëm me sinjalet video 1080/24p.

■ [4K Output] (Dalje 4K)

[Auto1]: Nxjerr sinjale video 2K (1920 × 1080) gjatë riprodhimit të videos dhe sinjale video 4K gjatë leximit të fotografive kur lidhet me një pajisje të përputhshme për 4K nga Sony.
 Nxjerr sinjale video 4K gjatë riprodhimit të përmbajtjeve video 24p në BD/DVD ROM-e ose gjatë leximit të fotografive kur lidhet me një pajisje të përputhshme për 4K jo nga Sony.

Ky cilësim nuk funksionon për riprodhimin e figurës të videove 3D.
 [Auto2]: Nxjerr automatikisht sinjale videoje 4K/24p kur lidhni një pajisje të përputhshme 4K/24p dhe kryeni cilësimet e duhura në [BD-ROM 24p Output] ((Dalje 24p BD-ROM)) ose [DVD-ROM 24p Output] (Dalje 24p

DVD-ROM), dhe nxjerr gjithashtu imazhe fotografike 4K/24p kur lexoni skedarë fotografikë 2D.

[Off] (Fikur): Fik funksionin.

■ Shënimi

Nëse pajisja juaj Sony nuk zbulohet kur zgjidhet [Auto1], cilësimi do të ketë të njëjtin efekt si cilësimi [Auto2].

■ [YCbCr/RGB (HDMI)]

[Auto]: Dallon automatikisht llojin e pajisjes së jashtme, dhe kalon në cilësimin e ngjyrës përputhëse.

[YCbCr (4:2:2)]: Nxjerr sinjale video YCbCr 4:2:2.

[YCbCr (4:4:4)]: Nxjerr sinjale video YCbCr 4:4:4.

[RGB]: Zgjidhni këtë kur lidhni me një pajisje me një fole DVI të përputhshme me HDCP.

■ [HDMI Deep Colour Output] (Dalje me ngjyra të thella HDMI)

[Auto]: Normalisht zgjidhni këtë.

[16bit], [12bit], [10bit]: Nxjerr sinjale video 16bit/ 12bit/10bit kur televizori i lidhur është i përputhshëm me Deep Colour.

[Off] (Fikur): Zgjidhni këtë kur figura është e paqëndrueshme ose ngjyrat duke jonatyrare.

■ [SBM] (Harta super bit)

[On] (Ndezur): Zbut gradacionin e sinjaleve të videos që dalin nga foleja HDMI (OUT).

[Off] (Fikur): Zgjidhni këtë kur dalin sinjale video të distortuara ose ngjyra jonatyrare.

■ [Pause Mode] (Modaliteti i pauzës) (vetëm BD/DVD VIDEO/DVD-R/DVD-RW)

[Auto]: Figura, duke përfshirë subjektet që lëvizin në mënyrë dinamike, del pa dridhje. Normalisht zgjidhni këtë pozicion.

[Frame] (Korniza): Figura, duke përfshirë subjektet që nuk lëvizin në mënyrë dinamike, del në rezolucion të lartë.

[Audio Settings] (Cilësimet audio)

■ [BD Audio MIX Setting] (Cilësimi BD audio MIX)

[On] (Ndezur): Nxjerr audion e marrë duke përzier audion interaktive dhe audion dytësore në audion parësore.

[Off] (Fikur): Nxjerr vetëm audion parësore.

■ [Audio DRC]

Mund të ngjeshësh variacionin dinamik të kolonës zanore.

[Auto]: Kryen riprodhimin në variacionin dinamik të specifikuar nga disku (vetëm BD-ROM).

[On] (Ndezur): Sistemi riprodhon kolonën zanore me llojin e variacionit dinamik që inxhinieri regjistruar ka synuar.

[Off] (Fikur): Nuk ka ngjeshje të variacionit dinamik.

■ [Attenuate - AUDIO] (Zbut - AUDIO)

Mund të ndodhë distorsion kur dëgjon një pajisje të lidhur me foletë AUDIO (AUDIO IN/L/R). Distorsionin mund ta parandaloni duke zbutur nivelin e hyrjes në njësinë kryesore.

[On] (Ndezur): Zbut nivelin e hyrjes. Niveli i daljes do të ulet në këtë cilësim.

[Off] (Fikur): Niveli normal i hyrjes.

■ [Audio Output] (Dalja audio)

Mund të zgjidhni metodën e daljes ku del sinjali audio.

[Speaker] (Altoperlanti): Nxjerr zë me shumë kanale vetëm nga altoperlantët e sistemit.

[Speaker + HDMI] (Altoperlanti + HDMI): Nxjerr zë me shumë kanale vetëm nga altoperlantët e sistemit dhe sinjale 2-kanalëshe lineare PCM nga foleja HDMI (OUT).

[HDMI]: Nxjerr zë vetëm nga foleja HDMI (OUT). Formati i zërit varet nga pajisja e lidhur.

Shënim

- Kur [Control for HDMI] (Kontroll për HDMI) është vendosur në [On] (Ndezur) (faqe 65), [Audio Output] (Dalja audio) është vendosur në [Speaker + HDMI] (Altoperlant + HDMI) automatikisht dhe ky cilësim nuk mund të ndryshohet.
- (Vetëm modelet në Evropë) Sinjale audio nuk dalin nga foleja HDMI (OUT) kur [Audio Output] (Dalja audio) vendoset në [Speaker + HDMI] (Altoperlant + HDMI) dhe [HDMI1 Audio Input Mode] (Modaliteti i hyrjes audio HDMI1) (faqe 65) vendoset në [TV].
- Kur [Audio Output] (Dalja audio) vendoset në [HDMI] (Dalja audio HDMI), formati i sinjalit që del për funksionin „TV“ është PCM linear me 2 kanale.

■ [Sound Effect] (Efekti zanor)

Ju mund të ndizni ose fikni efektet zanore të sistemit (cilësimi SOUND MODE (faqe 31)).

Për një burim me 2 kanale, mund të zgjidhni [Dolby Pro Logic], [DTS Neo:6 Cinema], ose [DTS Neo:6 Music] për të simuluar tingullin rrethues.

[Sound Mode On] (Modaliteti i zërit ndezur): Mundëson efektin rrethues të modalitetit të zërit (faqe 31) dhe modalitetin Futboll (faqe 32).

[Dolby Pro Logic]: Sistemi simulon tingull rrethues nga burime me 2-kanale dhe nxjerr tingull nga të gjithë altoparlantët (Kanali 5.1) (dekodim Dolby Pro Logic). [DTS Neo:6 Cinema]/[DTS Neo:6 Music]: Sistemi simulon tingull rrethues nga burime me 2 kanale dhe prodhon tingull shumëkanalësh (modalitet dekodimi DTS Neo:6 Cinema/DTS Neo:6 Music) [2k Stereo]: Ky sistem nxjerr zërin vetëm nga altoparlantët përballë majtas/djathtas dhe nën-vuferi. Formatet rrethuese me disa kanale shkrihen në 2 kanale. [Off] (Fikur): Efekti zanor çaktivizohet. Ju mund ta dëgjoni tingullin ndërsa regjistrohet.

■ [Speaker Settings] (Cilësimet e altoparlantit)

Për të marrë tingullin optimal rrethues, vendosi altoparlantët. Për detaje shihni „Cilësimi i altoparlantëve“ (faqe 50).

■ [Auto Calibration] (Kalibrimi automatik)

Ju mund të kalibroni automatikisht cilësimet e duhura. Për detaje shihni „Kalibrimi automatik i cilësimeve të duhura për altoparlantët“ (faqe 48).

■ [Bluetooth AUDIO - AAC]

Ju mund të aktivizoni dhe çaktivizoni audion AAC.

[On] (Ndezur): Audio AAC nëse pajisja *Bluetooth* mbështet AAC.

[Off] (Fikur): Audio SBC.

Shënim

Ju mund të shijoni tinguj me cilësi të lartë nëse aktivizohet AAC. Në rast se nuk mund arrin të dëgjosh tinguj AAC nga pajisja, zgjidhni [Off] (Fikur).

[BD/DVD Viewing Settings] (Cilësimet e shikimit BD/DVD)

■ [BD/DVD Menu Language] (Menyja e gjuhës BD/DVD)

Ju mund të zgjidhni gjuhën e parazgjedhur të menysë për BD-ROM ose DVD VIDEO. Kur zgjidhni [Select Language Code] (Zgjidh kodin e gjuhës), shfaqet ekrani për vendosjen e kodit të gjuhës. Vendosni kodin për gjuhën tuaj duke iu referuar „Lista e kodeve të gjuhëve“ (faqe 84).

■ [Audio Language] (Gjuha audio)

Mund të zgjidhni gjuhën e parazgjedhur të pjesës për BD-ROM ose DVD VIDEO. Kur zgjidhni [Original] (Originale), zgjidhet gjuha së cilës i jepet përparësi në disk.

Kur zgjidhni [Select Language Code] (Zgjidh kodin e gjuhës), shfaqet ekrani për vendosjen e kodit të gjuhës. Vendosni kodin për gjuhën tuaj duke iu referuar „Lista e kodeve të gjuhëve“ (faqe 84).

■ [Subtitle Language] (Gjuha e titrave)

Mund të zgjidhni gjuhën e parazgjedhur të titrave për BD-ROM ose DVD VIDEO. Kur zgjidhni [Select Language Code], (Zgjidh kodin e gjuhës) shfaqet ekrani për vendosjen e kodit të gjuhës. Vendosni kodin për gjuhën tuaj duke iu referuar „Lista e kodeve të gjuhëve“ (faqe 84).

■ [BD Hybrid Disc Playback Layer] (Shtresa e luajtjes së diskut hibrid BD)

[BD]: Luan shtresën BD.

[DVD/CD]: Luan shtresën DVD ose CD.

■ [BD Internet Connection]

(Lidhja e internetit BD)

[Allow] (Lejo): Normalisht zgjidhni këtë.
[Do not allow] (Mos lejo): Ndalon lidhjen me internetin.

[Parental Control Settings] (Cilësimet e kontrollit prindëror)

■ [Password] (Fjalëkalimi)

Vendosni ose ndryshoni fjalëkalimin për funksionin e Kontrollit Prindëror. Një fjalëkalim ju lejon të vendosni një kufizim në riprodhimin e videos në BD-ROM, DVD VIDEO ose internet. Nëse është e nevojshme, ju mund të diferenconi nivelet e kufizimit për BD-ROM dhe DVD VIDEO.

■ [Parental Control Area Code]

(Kodi i zonës së kontrollit prindëror)

Riprodhimi i disa BD-ROM ose DVD VIDEO mund të kufizohet sipas zonës gjeografike. Skenat mund të bllokohen ose mund të zëvendësohen me skena të tjera. Ndiqni udhëzimet në ekran dhe vendosni fjalëkalimin me katër shifra.

■ [BD Parental Control] (Kontrolli prindëror BD)/[DVD Parental Control] (Kontrolli prindëror DVD)/[Internet Video Parental Control] (Kontrolli prindëror i videove nga interneti)

Duke vendosur kontrollin prindëror, skenat mund të bllokohen ose mund të zëvendësohen me skena të tjera. Ndiqni udhëzimet në ekran dhe vendosni fjalëkalimin me katër shifra.

■ [Internet Video Unrated] (Video nga interneti i paklasifikuar)

[Allow] (Lejo): Lejon riprodhimin e videove nga interneti të pakategorizuara.
[Block] (Blloko): Bllokon riprodhimin e videove nga interneti të pakategorizuara.

[Music Settings] (Cilësimet e muzikës)

■ [Super Audio CD Playback Layer] (Shtresa e riprodhimit të Super Audio CD)

[Super Audio CD]: Luan shtresën Super Audio CD.
[CD]: Luan shtresën CD.

■ [Super Audio CD Playback Channels] (Kanalet e riprodhimit të Super Audio CD)

[DSD 2ch]: Luan zonën me 2 kanale.
[DSD Multi]: Luan zonën me shumë kanale.

[System Settings] (Cilësimet e sistemit)

■ [OSD Language] (Gjuha e shfaqjes në ekran)

Ju mund të zgjidhni gjuhën që dëshironi për paraqitjen në ekranin e sistemit.

■ [Wireless Sound Connection] (Lidhja me valë e zërit)

Mund të bëni konfigurime të tjera për sistemin me valë. Për detaje shihni „Cilësime të tjera për sistemin me valë“ (faqe 57). Mund të kontrolloni gjithashtu gjendjen e transmetimit me valë. Kur aktivizohet transmetimi me valë, shfaqet [OK] në të djathtë të [Status] (Gjendja).

■ [Main Unit illumination] (Ndriçimi i njësishë kryesore)

[On] (Ndezur): Ekranin e panelit të sipërm gjithmonë qëndron në ndezur, treguesi i butonave me prekje të butë është gjithmonë i ndriçuar dhe ndriçimi i treguesit LED është maksimumi.

[Auto]: Ekranin e panelit të sipërm dhe treguesi i butonave me prekje të butë fiket dhe ndriçimi i treguesit LED reduktohet automatikisht nëse nuk e përdorni sistemin për rreth 10 sekonda.

Shënim

Kur zgjidhet [Auto], vetëm butoni ► ndriçohet gjatë riprodhimit.

■ [HDMI Settings] (Cilësimet HDMI)

[Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI)

[On] (Ndezur): Ndez funksionin [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI). Mund të përdorni në mënyrë reciproke pajisjet që janë të lidhura me një kablo HDMI.

[Off] (Fikur): Fikur.

Shënim

(Vetëm modelet evropiane)

Kur vendosni [Quick Start Mode] (Modaliteti i nisjes së shpejtë) në [On] (Ndezur), [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) vendoset automatikisht në [Off] (Fikur).

[Audio Return Channel] (Kanali i kthimit audio)

Ky funksion është i disponueshëm kur lidhni sistemin me një fole televizori HDMI IN që është e përputhshme me funksionin Kanali i kthimit të audios dhe [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) është vendosur në [On] (Ndezur).

[Auto]: Sistemi mund të marrë sinjalet dixhitale audio të televizorit automatikisht përmes një kabloje HDMI.

[Off] (Fikur): Fikur.

[HDMI1 Audio Input Mode] (Modaliteti i hyrjes audio HDMI1)(vetëm modelet evropiane)

Ju mund të zgjidhni hyrjen audio të pajisjes që lidhet me folenë HDMI (IN 1).

[HDMI1]: Tingulli i pajisjes që lidhet me folenë HDMI (IN 1) hyn nga foleja HDMI (IN 1).

[TV]: Tingulli i pajisjes që lidhet me folenë HDMI (IN 1) hyn nga foleja TV (DIGITAL IN OPTICAL).

■ [Quick Start Mode] (Modaliteti i nisjes së shpejtë)

[On] (Ndezur): Shkurton kohën e ndezjes nga modaliteti i pritjes. Ju mund të përdorni sistemin shpejt pasi e ndizni.

[Off] (Fikur): Cilësimi i parazgjedhur.

Shënim

(Vetëm modelet evropiane)

Para se të vendosni [Quick Start Mode] (Modaliteti i nisjes së shpejtë) në [On] (Ndezur), duhet të vendosni [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) dhe [Remote Start] (Nisja në distancë) në [Off] (Fikur).

Kur vendosni [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) ose [Remote Start] (Nisja në distancë) në [On] (Ndezur), [Quick Start Mode] (Modaliteti i nisjes së shpejtë) vendoset automatikisht në [Off] (Fikur).

■ [Power Save Drive] (Përdorimi me kursim energjie)

[On] (Ndezur): Redukton konsumin e energjisë kur niveli i volumit është i ulët.

[Off] (Fikur): Statusi Normal. Sistemi mund të nxjerrë volumnin e zërit.

■ [Auto Standby] (Gatishmëri automatike)

[On] (Ndezur): Ndez funksionin [Auto Standby] (Gatishmëri automatike). Kur nuk e përdorni sistemin për rreth 30 minuta, sistemi hyn automatikisht në modalitetin e pritjes.

[Off] (Fikur): Fikur.

■ [Auto Display] (Shfaqja automatike)

[On] (Ndezur): Shfaq automatikisht informacion në ekran kur ndryshohen titujt e pamjeve, modalitetet e figurës, sinjalet audio, etj.

[Off] (Fikur): Afishon informacion vetëm kur shtypni DISPLAY.

■ [Screen Saver] (Ruajtësi i ekranit)

[On] (Ndezur): Ndez funksionin e ruajtësit të ekranit.

[Off] (Fikur): Fikur.

■ [Software Update Notification] (Njoftimi i përditësimit të softuerit)

[On] (Ndezur): Vendos sistemin për t'ju njoftuar për informacion mbi versionet më të fundit të softuerit (faqe 59).

[Off] (Fikur): Fikur.

■ [Gracenote Settings] (Cilësimet për Gracenote)

[Auto]: Shkarkon automatikisht informacion disku kur ndaloni riprodhimin e diskut. Për të shkarkuar, sistemi duhet të lidhet me rrjetin.

[Manual]: Shkarkon informacionin e diskut kur zgjidhet [Video Search] (Kërkimi për video) ose [Music Search] (Kërkimi muzikor).

■ [System Information] (Informacioni i sistemit)

Mund të shfaqni informacion mbi versionet më të reja të softuerit të sistemit dhe adresën e MAC.

■ [Software License Information] (Informacioni i licencës së softuerit)

Mund të shfaqni informacionin mbi licencën e softuerit.

[External Input Settings] (Cilësimet e hyrjes së jashtme)

Cilësimi i kapërcimit është një veçori e dobishme që ju lejon të kapërceni hyrjet e papërdorura kur zgjidhni një funksion.

■ [HDMI1]/[HDMI2]/[TV]/[Bluetooth AUDIO]/[AUDIO]

[Do not skip] (Mos kapërce): Sistemi nuk kapërcen funksionin e përzgjedhur kur funksioni zgjidhet duke shtypur FUNCTION. [Skip] (Kapërce): Sistemi e kapërcen funksionin e zgjedhur kur zgjidhni funksionin duke shtypur FUNCTION.

[Network Settings] (Cilësimet e rrjetit)

■ [Internet Settings] (Cilësimet e internetit)

Lidhni paraprakisht sistemin me rrjetin. Për detaje shihni „Hapi 3: Përgatitja për lidhjen me rrjetin“ (faqe 25).

[Wired Setup] (Konfigurimi me tela): Zgjidhni këtë kur lidhni me një ruter me brez të gjerë duke përdorur një kablo LAN. [Wireless Setup(built-in)] (Konfigurimi pa tela (i integruar)): Zgjidhni këtë kur përdorni LAN-in me valë të integruar në sistem për lidhje me valë me rrjetin.

Këshillë

Për detaje të mëtejshme, vizitoni faqen e mëposhtme të internetit dhe kontrolloni PESH:

Për klientët në Evropë dhe Rusi:
<http://support.sony-europe.com/>

Për klientët në vende/rajone të tjera:
<http://www.sony-asia.com/section/support>

■ [Network Connection Status]

(Statusi i lidhjes së rrjetit)

Shfaq statusin aktual të lidhjes së rrjetit.

■ [Network Connection Diagnostics]

(Diagnostikimi i lidhjes së rrjetit)

Ju mund të ekzekutoni diagnostikimin e rrjetit për të kontrolluar nëse lidhja me rrjetin është kryer siç duhet.

■ [Connection Server Settings]

(Cilësimet e serverit të lidhjes)

Vendos nëse shfaqet ose jo serveri DLNA i lidhur.

■ [Renderer Set-up] (Konfigurimi i renderuesit)

[Automatic Access Permission] (Leje për akses automatik): Vendos nëse lejohet ose jo aksesi automatik nga një kontrollues DLNA i sapo diktuar.

[Smart Select] (Zgjedhja inteligjente): Lejon që një kontrollues Sony DLNA të gjejë një sistem si pajisje objektive për të funksionuar duke përdorur rrezet infra të kuqe. Këtë funksion mund ta ndizni ose ta fikni.

[Renderer Name] (Emri i renderuesit): Shfaq emrin e sistemit siç listohet në pajisjet e tjera DLNA në rrjet.

■ [Renderer Access Control] (Kontrolli i aksesit të renderuesit)

Vendos nëse pranohen komanda nga kontrolluesit DLNA.

■ [PARTY Auto Start]

(Fillimi automatik i PARTY)

[On] (Ndezur): Nis një PARTY ose bashkohet me një PARTY ekzistuese sipas kërkesës së një pajisjeje të lidhur në rrjet të përputhshme me funksionin PARTY STREAMING.

[Off] (Fikur): Fikur.

■ [Registered Remote Devices]

(Telekomandat e regjistruara)

Shfaq një listë të pajisjeve të regjistruara të telekomandës.

■ [Remote Start] (Nisja në distancë)

[On] (Ndezur): Gjithmonë ndizni sistemin përmes një pajisjeje që lidhet përmes rrjetit kur sistemi është në modalitetin në pritje.

[Off] (Fikur): Sistemi nuk mund të ndizet me një pajisje të lidhur përmes rrjetit.

Shënim

(Vetëm modelet evropiane)

Kur vendosni [Quick Start Mode] (Modaliteti i nisjes së shpejtë) në [On] (Ndezur), [Remote Start] (Nisja në distancë) vendoset automatikisht në [Off] (Fikur).



[Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit)

Ekzekuton [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit) për të kryer cilësimet bazë të rrjetit. Ndiqini udhëzimet në ekran.



[Resetting] (Rivendosja)

■ [Reset to Factory Default Settings] (Rivendos në gjendje fabrike)

Ju mund të rivendosni sistemin në cilësimet e fabrikës duke zgjedhur grupin e cilësimeve. Të gjitha cilësimet brenda grupit do të rivendosen.

■ [Initialise Personal Information] (Fillo informacionin personal)

Mund të fshini informacionin personal të ruajtur në sistem.

Informacioni shtesë

Masat paraprake

Mbi sigurinë

- Nëse brenda në mobilie bie diçka e fortë ose lëng, sistemi duhet të hiqet nga priza dhe duhet të kontrollohet nga një personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.
- Mos e prekni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) me duar të lagura. Duke vepruar kështu mund të shkaktohet goditje elektrike.

Mbi burimet e rrymës

Nëse nuk do ta përdorni sistemin për një kohë të gjatë, sigurohuni që ta shkëputni sistemin nga priza e murit. Për të shkëputur kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik), kapeni te vetë priza; mos tërhiqni asnjëherë kordonin.

Mbi vendosjen

- Vendoseni sistemin në një vend me ajrosje të mjaftueshme për të parandaluar shtimin e nxehtësisë në sistem.
- Megjithëse sistemi nxehet gjatë punës, ky nuk është keqfunksionim. Nëse e përdorni vazhdimisht sistemin me volum të lartë, temperatura e kasës së tij në pjesën lart, anash dhe poshtë rritet ndjeshëm. Për të shmangur djegien, mos e prekni kasën.
- Mos e vendosni sistemin mbi një sipërfaqe të butë (qilim, tapet, etj.) duke qenë se kjo mund të bllokojë vrimat e ajrimit.
- Mos e instaloni sistemin pranë burimeve të nxehtësisë siç janë radiatorët, tubacionet e ajrit, ose në një vend ku bie drita e drejtpërdrejtë e diellit, ku ka pluhur të tepërt, dridhje mekanike ose tronditje.

- Mos e instaloni sistemin në një pozicion të pjerrët. Ai është projektuar që të përdoret vetëm në pozicion horizontal.
- Mbajeni sistemin dhe disqet larg komponentëve me magnete të forta, siç janë furrat me mikrovalë ose altoparlantët e mëdhenj.
- Mos vendosni objekte të rënda mbi sistem.
- Mos vendosni objekte metalike përpara panelit të përparmë. Kjo mund të kufizojë marrjen e valëve të radios.
- Mos e vendosni sistemin në një vend ku janë në përdorim pajisje mjekësore. Kjo mund të shkaktojë keqfunksionim të pajisjes mjekësore.
- Nëse përdorni një stimulator kardiak ose pajisje tjetër mjekësore, konsultohuni me mjekun ose prodhuesin e pajisjes mjekësore përpara se të përdorni funksionin LAN me valë.

Mbi përdorimin

Nëse sistemi sillet direkt nga një vend i ftohtë në një vend të ngrohtë, ose vendoset në një dhomë shumë të lagësht, lagështira mund të kondensohet mbi lentet jashtë njësise kryesore. Nëse ndodh kjo, sistemi mund të mos punojë siç duhet. Në këtë rast, hiqni diskun dhe lëreni sistemin të nderur për rreth gjysmë ore derisa të avullojë lagështira.

Mbi rregullimin e volumnit

Mos e ngrini volumnin ndërkohë që dëgjoni një pjesë me hyrje në nivele shumë të ulëta ose pa sinjale audio. Duke vepruar kështu, altoparlantët mund të dëmtohen kur luhet papritur një pjesë me nivel maksimal të lartë.

Mbi pastrimin

Pastroni mobilien, panelin dhe kontrollet me një pëlhurë të butë të njomur paksa me një solucion larës të butë. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si alkooli ose benzina.

Mbi pastrimin e disqeve, pastruesit e disqeve/lenteve

Mos përdorni disqe pastruese ose pastrues disqesh/lentesh (duke përfshirë llojet e lëngshme ose me spërkatje). Këto mund të shkaktojnë keqfunksionim të aparaturës.

Mbi zëvendësimin e pjesëve

Në rast se ky sistem riparohet, pjesët e riparuar mund të mbahen për ripërdorim ose për riciklim.

Mbi ngjyrën e televizorit tuaj

Nëse altoparlantët shkaktojnë parregullsi ngjyrash në ekranin e televizorit, fikni aparatin e televizorit, më pas ndizeni sërish pas 15 deri 30 minutash. Nëse vazhdojnë parregullsitë e ngjyrave, vendosini altoparlantët më larg televizorit.

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Kujdes: Ky sistem është në gjendje të mbajë për një kohë të pacaktuar në ekranin e televizorit një foto ose një imazh të palëvizshëm video. Nëse këtë foto ose imazh të palëvizshëm video e lini të shfaqet në televizor për një periudhë të tejkjatur kohore, rrezikoni dëmtimin e përhershëm të ekranit të televizorit tuaj. Televizorët me ekran plazmë dhe me projektim preken veçanërisht nga kjo.

Mbi lëvizjen e sistemit

Përpara se të lëvizni sistemin, sigurohuni që brenda nuk ka disk dhe shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) nga priza e murit (rrjeti).

Mbi komunikimin *Bluetooth*

- Pajisjet *Bluetooth* duhet të përdoren brenda afërsisht 10 metra (distanca pa pengesa) nga njëra-tjetra. Rrezja efi­kase e komunikimit mund të shkurtohet në kushtet e mëposhtme.
 - Kur mes pajisjeve me lidhje *Bluetooth* ndodhet një person, objekt metalik, mur apo pengesë tjetër
 - Vendndodhjet ku është instaluar një LAM me valë
 - Rreth furrave me mikrovalë që janë në përdorim
 - Vendndodhjet ku ka valë të tjera elektromagnetike
- Pajisjet *Bluetooth* dhe LAN me valë (IEEE 802.11b/g) përdorin të njëjtin brez frekuence (2.4 GHz). Kur përdorni pajisjen tuaj *Bluetooth* pranë një pajisjeje me kapacitet LAN me valë, mund të ndodhin interferenca elektromagnetike. Kjo mund të sjellë shpejtësi më të ulëta të transferimit të të dhënave, zhurmë apo pamundësi për t'u lidhur. Nëse ndodh kjo, provoni zgjidhjet e mëposhtme:
 - Përdoreni këtë njësi kryesore të paktën 10 metra larg pajisjes LAN me valë.
 - Fikni rrymën e pajisjes LAN me valë kur përdorni pajisjen tuaj *Bluetooth* brenda 10 metrave.
 - Instaloheni këtë njësi kryesore dhe pajisjen *Bluetooth* sa më afër të jetë e mundur njëra-tjetrës.
- Valët radio të transmetuara nga kjo njësi kryesore mund të interferojnë me funksionimin e pajisjeve mjekësore. Duke qenë se kjo interferencë mund të sjellë keqfunksionim, fikni gjithmonë rrymën e kësaj njësie kryesore dhe pajisjes *Bluetooth* në vendet e mëposhtme:
 - Në spitale, trena, aeroplanë, pika karburanti dhe vende ku mund të ketë gaze të djegshme
 - Pranë dyerve automatike ose alarmeve të zjarrit

- Kjo njësi kryesore mbështet funksionet e sigurisë që përputhen me specifikimin *Bluetooth* për të siguruar lidhje të sigurt gjatë komunikimit duke përdorur teknologjinë *Bluetooth*. Megjithatë, kjo siguri mund të jetë e pamjaftueshme në varësi të përmbajtjes së cilësimit dhe faktorëve të tjerë, prandaj gjithmonë kini kujdes kur kryeni komunikimin duke përdorur teknologjinë *Bluetooth*.
- Sony nuk është përgjegjës për asnjë mënyrë dëmtimi apo humbje tjetër si rezultat i rrjedhjes së informacionit gjatë komunikimit duke përdorur teknologjinë *Bluetooth*.
- Komunikimi *Bluetooth* nuk është domosdoshmërisht i garantuar me të gjitha pajisjet *Bluetooth* që kanë të njëjtin profil si kjo njësi kryesore.
- Pajisjet *Bluetooth* të lidhura me këtë njësi kryesore duhet të përputhen me specifikimin *Bluetooth* të përshkruar nga Bluetooth SIG, Inc. dhe duhet të jenë të certifikuara si të përputhshme. Megjithatë, edhe kur një pajisje përputhet me specifikimin *Bluetooth*, mund të ketë raste kur karakteristikat apo specifikimet e pajisjes *Bluetooth* mund ta bëjnë të pamundur lidhjen, ose mund të rezultojnë në metoda të ndryshme kontrolli, paraqitjeje apo funksionimi.
- Mund të shkaktohet zhurmë ose audioja mund të ndërpritet në varësi të pajisjes *Bluetooth* që është lidhur me këtë njësi kryesore, mjedisin e komunikimeve apo kushtet rrethuese.

Nëse keni pyetje ose probleme në lidhje me sistemin tuaj, ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Shënime mbi disqet

Mbi përdorimin e disqeve

- Për të mbajtur të pastër diskun, kapeni diskun nga cepat e tij. Mos e prekni sipërfaqen.
- Mos ngjisni letër ose shirit mbi disk.



- Mos e ekspozoni diskun ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose burimeve të nxehtësisë siç janë tubacionet e ajrit të nxehtë, ose mos e lini në një makinë të parkuar në dritë të drejtpërdrejtë dielli duke qenë se brenda makinës temperaturat mund të rriten në mënyrë të konsiderueshme.
- Pas luajtjes, ruajeni diskun në kutinë e tij.

Mbi pastrimin

- Përpara luajtjes, pastroni diskun me një pëllhurë pastrimi.
- Fshijeni diskun duke filluar nga qendra drejt skajeve.



- Mos përdorni tretës si benzina, holluesit, pastruesit që blihen në dyqan, ose sprejtë antistatikë që përdoren për disqet LP prej vinili.

Ky sistem mund të luajë vetëm një disk standard të rrumbullakët. Përdorimi i disqeve jo standarde ose jo rrethore (p.sh. në formë kartoline, zemre apo ylli) mund të shkaktojë keqfunksionim.

Mos përdorni një disk që ka të bashkëngjitur një aksesor tregtar si etiketë apo unazë.

Zgjidhja e problemeve

Nëse ju ndodh një nga vështirësitë e mëposhtme gjatë përdorimit të sistemit, përdorni këtë udhëzues për zgjidhjen e problemeve për t'ju ndihmuar të zgjidhni problemin përpara se të kërkontë riparime. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony. Në rast problemi me funksionin me valë të zërit, dërgojeni te shitësi i Sony për të kontrolluar të gjithë sistemin (njësinë qendrore dhe amplifikuesin rrethues).

Të përgjithshme

Energjia nuk ndizet.

→ Kontrolloni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të jetë lidhur mirë.

Telekomanda nuk funksionon.

→ Distanca mes telekomandës dhe njësisë kryesore është tepër e madhe.
→ Bateritë në telekomandë kanë rënë.

Kapaku i diskut nuk hapet dhe nuk arrini të hiqni diskun edhe pasi shtypni ▲.

→ Proveni të mëposhtmet:

- ① Prekni dhe mbani shtypur ► dhe ▲ në njësinë kryesore për më shumë se 5 sekonda për të hapur kapakun e diskut.
- ② Hiqni diskun.
- ③ Shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) nga priza e murit (rrjeti), më pas rilidheni pas disa minutash.

Sistemi nuk punon normalisht.

→ Shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) nga priza e murit (rrjeti), më pas rilidheni pas disa minutash.

Mesazhet

[A new software version is available. Please go to the „Setup” section of the menu and select „Network Update” to perform the update.] (Disponohet një version i ri i softuerit. Shkoni te pjesa „Konfigurimi” në meny dhe zgjidhni „Përditësimi i rrjetit” për të kryer përditësimin) shfaqet në ekranin e televizorit.

→ Shih [Network Update] (Përditësimi i rrjetit) (faqe 59) për të përditësuar sistemin në një version më të fundit të softuerit.

„PRTECT”, „PUSH” dhe „POWER” shfaqen në mënyrë të alternuar në ekranin e panelit të sipërm.

→ Shtypni I/⏻ për të fikur sistemin, dhe kontrolloni artikujt e mëposhtëm pasi të zhduket „STBY”.

- Mos bëjnë qark të shkurtër kordonët e + dhe – të altoparlantëve?
- A po përdorni vetëm altoparlantët e dhënë?
- A po bllokoni ndonjë gjë vrimat e ajrimit të sistemit?
- Pasi të kontrolloni artikujt e mëposhtëm dhe të rregulloni problemet, ndizni sistemin. Nëse shkaku i problemit nuk mund të gjendet edhe pas kontrollit të mësipërm, kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.

„LOCKED” shfaqet në ekranin e panelit të sipërm.

→ Vendosni funksionin e bllokimit për fëmijët në „fikur” (faqe 52).

„D. LOCK” shfaqet në ekranin e panelit të sipërm.

→ Kontaktoni shitësin më të afërt Sony ose pikën lokale të autorizuar të shërbimit Sony.

Në ekranin e panelit të sipërm shfaqet „Exxxx” (x është numër).

→ Kontaktoni shitësin më të afërt Sony ose pikën lokale të autorizuar të shërbimit Sony dhe jepini kodin e gabimit.

⚠ shfaqet pa mesazhe në të gjithë ekranin e televizorit.

→ Kontaktoni shitësin më të afërt Sony ose pikën lokale të autorizuar të shërbimit Sony.

„NOT.USE” shfaqet në ekranin e panelit të sipërm kur shtypni SOUND MODE, FOOTBALL ose MUSIC EQ.

→ Cilësimi për SOUND MODE, FOOTBALL dhe MUSIC EQ nuk mund të ndryshohet kur [Sound Effect] (Efekti i zërit) vendoset në modalitet tjetër nga [Sound Mode On] (Modaliteti i zërit ndezur). Vendosni [Sound Effect] (Efekti i zërit) në [Audio Settings] (Cilësimet e audios) te [Sound Mode On] (Modaliteti i zërit ndezur) (faqe 62).

Figura

Nuk ka figurë ose figura nuk del saktë.

→ Kontrolloni mënyrën e daljes në sistemin tuaj (faqe 22).

→ Prekni dhe mbani shtypur ► dhe VOL – në njësinë kryesore për më shumë se 5 sekonda për të rivendosur rezolucionin e daljes video në rezolucionin më të ulët.

→ Për BD-ROM-et, kontrolloni cilësimet e [BD-ROM 24p Output] (Dalja 24p BD-ROM) në [Screen Settings] (Cilësimet e ekranit) (faqe 61).

Nuk ka figurë kur kryeni lidhje me kabllon HDMI.

- Njësia kryesore është lidhur me një pajisje hyrëse që nuk është e përputhshme me HDCP (High-bandwidth Digital Content Protection) ("HDMI" në panelin e sipërm nuk ndizet) (faqe 22).

Pamjet 3D nga foleja HDMI (IN 1) ose HDMI (IN 2) nuk shfaqen në ekranin e televizorit.

- Në varësi të televizorit ose pajisjes video, pamjet 3D mund të mos shfaqen.

Zona e errët e figurës është tepër e errët/ zona e ndritshme është tepër e ndritshme ose jonatyrale.

- Vendosni [Picture Quality Mode] (Modaliteti i cilësisë së figurës) në [Auto] (parazgjedhja) (faqe 42).

Shfaqen miza në figurë.

- Pastroni diskun.
- Nëse dalja e figurës nga sistemi kalon përmes video-regjistratorit për të shkuar te televizori juaj, sinjali i mbrojtur që u aplikohet disa programeve BD/DVD mund të ndikojë në cilësinë e figurës. Nëse vazhdoni të keni probleme edhe kur e lidhni njësinë kryesore direkt me televizorin tuaj, provoni të lidhni njësinë kryesore me fole të tjera hyrëse.

Imazhi nuk shfaqet në të gjithë ekranin e televizorit.

- Kontrolloni cilësimin e [TV Type] (Lloji i televizorit) në [Screen Settings] (Cilësimet e ekranit) (faqe 60).
- Raporti i pamjes në disk është i caktuar paraprakisht.

Ka parregullsi ngjyrash në ekranin e televizorit.

- Nëse altoparlantët përdoren me një televizor ose projektor me tub katodik, instalojini altoparlantët të paktën 0,3 metra nga televizori.

- Nëse vazhdojnë parregullsitë e ngjyrave, fikni një herë aparatin e televizorit, më pas ndizeni sërish pas 15 deri 30 minutash.
- Sigurohuni që pranë altoparlantëve të mos ketë objekte magnetike (çelës magnetik mbi tavolinën e televizorit, pajisje mjekësore, lodër, etj.).

Zëri**Nuk ka zë.**

- Kordonët e altoparlantëve nuk janë lidhur mirë.
- Kontrolloni cilësimet e altoparlantëve (faqe 50).

Nuk del tingulli Super Audio CD i një pajisjeje që lidhet me fole të HDMI (IN 1) ose HDMI (IN 2).

- HDMI (IN 1) dhe HDMI (IN 2) nuk pranon format audio që përmban mbrojtje kundër kopjimit. Lidhni daljen analoge audio të pajisjes me foletë AUDIO (AUDIO IN L/R) të njësisë kryesore.

Nuk ka zë nga televizori përmes folesë HDMI (OUT) kur përdorni funksionin Kanali i kthimit të audios.

- Vendosni [Control for HDMI] (Kontroll për HDMI) në [HDMI Settings] (Cilësimet HDMI) të [System Settings] (Cilësimet e sistemit) në [On] (Ndezur) (faqe 65). Gjithashtu, vendosni [Audio Return Channel] (Kanali i kthimit të audios) në [HDMI Settings] (Cilësimet HDMI) të [System Settings] (Cilësimet e sistemit) në [Auto] (faqe 65).
- Sigurohuni që televizori juaj të jetë i përputhshëm me funksionin Kanali i kthimit të audios.
- Sigurohuni që kablloja HDMI të jetë lidhur me një fole në televizorin tuaj që është e përputhshme me funksionin Kanali i kthimit të audios.

Sistemi nuk e nxjerr mirë zërin e programeve televizive kur lidhet me një dekoder.

- Vendosni [Audio Return Channel] (Kanali i kthimit të audios) në [HDMI Settings] (Cilësimet HDMI) të [System Settings] (Cilësimet e sistemit) në [Off] (Fikur) (faqe 65).
- Kontrolloni lidhjet (faqe 23).

Dëgjohet gumëzhitje ose zhurmë e madhe.

- Lëvizeni pajisjen audio tuaj larg nga televizori.
- Pastroni diskun.

Zëri humb efektin stereo kur luani një CD.

- Zgjidhni tingullin stereo duke shtypur AUDIO (faqe 44).

Zëri prodhohet vetëm nga altoparlanti qendror.

- Në varësi të diskut, zëri mund të prodhohet vetëm nga altoparlanti qendror.



Nga altoparantët rrethues nuk del zë ose një zë shumë i ulët.

- Kontrolloni lidhjet dhe cilësimet e altoparantëve (faqe 20, 50).
- Kontrolloni cilësimin e modalitetit të zërit (faqe 31).
- Në varësi të burimit, efekti i altoparantëve rrethues mund të vihet re më pak.
- Vendosni [Sound Mode] (Modaliteti i zërit) në [Auto] (faqe 31).

Distorzioni ndodh në zërin e pajisjes së lidhur.

- Reduktoni nivelin e hyrjes për pajisjen e lidhur duke vendosur [Attenuate - AUDIO](Zbut audio) (faqe 62).

Dëgjohet një muzikë e lartë e papritur.

- Është aktivizuar demonstrimi i zërit të integruar. Shtypni  - për të reduktuar volumnin ose shtypni  për të ndaluar demonstrimin.

Zëri me valë

Transmetimi me valë nuk është aktiv ose nuk ka zë nga altoparantët shumëkanalësh.

- Kontrolloni gjendjen e treguesit LINK/STANDBY në amplifikuesin shumëkanalësh.
 - Fiket.
 - Kontrolloni që kordoni elektrik (dalja e korrentit) i amplifikuesit rrethues të jetë lidhur në mënyrë të sigurt.
 - Ndizeni amplifikuesin shumëkanalësh duke shtypur I/⏻ mbi amplifikues.
 - Pulson shpejt në të gjelbër.
 - ① Shtypni I/⏻ mbi amplifikuesin shumëkanalësh.
 - ② Futeni siç duhet marrësin me valë te amplifikuesi shumëkanalësh.
 - ③ Shtypni I/⏻ mbi amplifikuesin shumëkanalësh.
 - Pulson në të kuqe.
 - Shtypni I/⏻ për të fikur amplifikuesin shumëkanalësh dhe kontrolloni si më poshtë.
 - ① Janë telat + dhe – të altoparantëve në masë?
 - ② Ka ndonjë gjë që pengon vrimat e ajrimit të amplifikuesit shumëkanalësh?

Pasi të kontrolloni sa më lart dhe të ndreqni problemet e mundshme, ndizni amplifikuesin shumëkanalësh. Nëse shkaku i problemit nuk mund të gjendet edhe pas kontrollimit të të gjithë artikujve të mësipërm, kontaktoni me shitësin më të afërt Sony.

- Pulson me ngadalë në të gjelbër ose portokalli, ose bëhet e kuqe.
 - Sigurohuni që marrësi me valë të futet siç duhet në njësinë qendrore.
 - Bëni sërish konfigurimin e [Secure Link] (Lidhja e sigurt) (faqe 57).
 - Transmetimi i zërit është i dobët. Lëvizeni amplifikuesin shumëkanalësh në mënyrë të atillë që treguesi LINK/STANDBY të bëhet i gjelbër ose portokalli.
 - Lëvizeni sistemin larg pajisjeve të tjera me valë.
 - Shmangni përdorimin e pajisjeve të tjera me valë.
- Bëhet i gjelbër ose portokalli.
 - Kontrolloni lidhjet dhe cilësimet e altoparlantëve.

Nga altoparlantët shumëkanalësh dëgjohet zhurmë ose zëri dëgjohet me ngecje.

- Transmetimi me valë është i paqëndrueshëm. Ndryshoni cilësimin [RF Channel] (Kanali RF) në [Wireless Sound Connection] (Lidhja me valë e zërit) (faqe 58).
- Instalojini njësinë kryesore dhe amplifikuesin rrethues pranë njëri-tjetrit.
- Mos e instaloni njësinë kryesore dhe amplifikuesin me valë në mbajtëse të mbyllur, në mbajtëse metalike ose poshtë tryezave.

Sintonizuesi

Stacionet e radios nuk mund të sintonizohen.

- Kontrolloni që antena (ajrore) të jetë lidhur mirë. Rregulloni antenën (ajrore) ose lidhni një antenë të jashtme (ajrore) nëse është e nevojshme.
- Forca e sinjalit të stacioneve është tepër e dobët (kur sintonizoheni me sintonizimin automatik). Përdorni sintonizimin manual.

Riprodhimi

Disku nuk luan.

- Kodi rajonal në BD/DVD nuk përputhet me sistemin.
- Brenda njësisë kryesore është kondensuar lagështirë dhe mund të shkaktojë dëmtim të lenteve. Hiqni diskun dhe lëreni njësinë kryesore të ndezur për rreth gjysmë ore.
- Sistemi nuk arrin të luajë një disk të regjistruar që nuk është finalizuar siç duhet (faqe 78).

Emrat e skedarëve nuk shfaqen saktë.

- Sistemi mund të shfaqë vetëm formate të karaktereve të përputhshme me ISO 8859-1. Formatet e karaktereve të tjera mund të shfaqen ndryshe.
- Në varësi të softuerit shkruar të përdorur, karakteret hyrëse mund të shfaqen ndryshe.

Një disk nuk fillon të luhet nga fillimi.

- Është zgjedhur rifillimi i luajtjes. Shtypni OPTIONS dhe [Play from start] (Luaj nga fillimi), pastaj shtypni

Riprodhimi nuk nis nga pika e rifillimit ku keni ndaluar luajtjen së fundmi.

- Pika e rifillimit mund të pastrohet nga memoria në varësi të diskut kur
 - hapni kapakun e diskut.
 - shkëputni pajisjen USB.
 - luani përmbajtjen.
 - fikni njësinë kryesore.

Gjuha për kolonën zanore/titrat ose këndet nuk mund të ndryshohet.


- Provoni të përdorni menyën kryesore të BD-së ose DVD-së.
- Pjesët/titrat me shumë gjuhë ose disa kënde nuk janë regjistruar në BD ose DVD që po luhet.

Përbajtja bonus ose të dhënat e tjera që përmban një BD-ROM nuk mund të luhen.

- Proveni të mëposhtmet:
 - ① Hiqni diskun.
 - ② Fikni sistemin.
 - ③ Shkëputni dhe rilidhni pajisjen USB (faqe 34).
 - ④ Ndizni sistemin.
 - ⑤ Vendosni BD-ROM me BONUSVIEW/BD-LIVE.

Pajisja USB

Pajisja USB nuk njihet.


- Proveni të mëposhtmet:
 - ① Fikni sistemin.
 - ② Shkëputni dhe rilidhni pajisjen USB.
 - ③ Ndizni sistemin.
- Sigurohuni që pajisja USB të lidhet mirë me portën  (USB).
- Kontrolloni nëse është dëmtuar pajisja USB ose kablloja.
- Kontrolloni nëse pajisja USB është aktive.
- Nëse pajisja USB është e lidhur përmes një qendre USB, shkëputeni dhe lidhjeni pajisjen USB direkt me njësinë kryesore.

Video nga interneti BRAVIA

Figura/zëri është e dobët/disa programe shfaqen me mungesë detajesh, veçanërisht gjatë skenave me lëvizje të shpejta ose skenave në errësirë.

- Cilësia e figurës/zërit mund të jetë e dobët në varësi të ofruesve të përbajtjes nga interneti.
- Cilësia e figurës/zërit mund të përmirësohet duke ndryshuar shpejtësinë e lidhjes. Sony rekomandon një shpejtësi lidhjeje prej të paktën 2,5 Mbps për video me definicion standard dhe 10 Mbps për video me definicion të lartë.
- Jo të gjitha videot kanë zë.

Figura është e vogël.

- Shtypni  për ta zmadhuar.

„BRAVIA“ Sync ([Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI))

Funksioni [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) nuk funksionon („BRAVIA“ Sync).

- Kontrolloni që [Control for HDMI] (Kontroll për HDMI) është caktuar në [On] (Ndezur) (faqe 65).
- Nëse ndryshoni lidhjen HDMI, fikeni sistemin dhe ndizeni sërish.
- Nëse ka ndërprerje të rrymës, caktojani [Control for HDMI] (Kontroll për HDMI) në [Off] (Fikur), pastaj caktojani [Control for HDMI] (Kontroll për HDMI) në [On] (Ndezur) (faqe 65).
- Kontrolloni si më poshtë dhe referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen.
 - Pajisja e lidhur përputhet me funksionin [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI).
 - Cilësimi i pajisjes së lidhur për funksionin [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) është i saktë.

Lidhja me rrjetin

Sistemi nuk mund të lidhet me rrjetin.

- Kontrolloni lidhjen me rrjetin (faqe 25) dhe cilësimet e rrjetit (faqe 66).

Lidhja LAN me valë

Nuk mund të lidhni kompjuterin tuaj me internetin pasi kryhet [Wi-Fi Protected Setup (WPS)] (Konfigurimi i Wi-Fi të mbrojtur).

- Cilësimet me valë të ruterit mund të ndryshojnë automatikisht nëse përdorni funksionin Wi-Fi Protected Setup përpara se të rregulloni cilësimet e ruterit. Në këtë rast, ndryshoni përkatësisht cilësimet e lidhjes me valë të kompjuterit.

Sistemi nuk mund të lidhet me rrjetin, ose lidhja me rrjetin është e paqëndrueshme.

- Kontrolloni nëse ruteri i LAN-it me valë është i ndezur.
- Kontrolloni lidhjen me rrjetin (faqe 25) dhe cilësimet e rrjetit (faqe 66).
- Në varësi të mjedisit të përdorimit, duke përfshirë materialin e murit, kushtet e marrjes së valëve radio, ose pengesave mes sistemit dhe ruterit me valë LAN, mund të shkurtohet distanca e mundshme e komunikimit. Lëvizini sistemin dhe ruterin me valë LAN më pranë njëri tjetrit.
- Pajisjet që përdorin brezin e frekuencës 2,4 GHz, siç janë mikrovala, *Bluetooth* ose pajisjet dixhitale me valë, mund të ndërpresin komunikimin. Lëvizeni njësinë kryesore larg këtyre pajisjeve, ose fikini këto pajisje.

- Lidhja LAN me valë mund të jetë e paqëndrueshme në varësi të mjedisit të përdorimit, veçanërisht kur përdorni funksionin *Bluetooth* të sistemit. Në këtë rast, përshtatni mjedisin e përdorimit.

Ruteri i dëshiruar me valë nuk tregohet në listën e rrjeteve me valë.

- Shtypni RETURN për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm dhe provoni [Wireless Setup(built-in)] (Konfigurimi me valë (i brendshëm)) sërish. Nëse ruteri me valë që dëshironi vazhdon të mos diktohet, zgjidhni [Add a new address.] (Shto adresë të re.) nga lista e rrjeteve dhe më pas zgjidhni [Manual Registration] (Regjistrimi manual) për të vendosur manualisht një emër rrjeti (SSID).

Pajisja Bluetooth

Çiftimi nuk arrin të kryhet.

- Lëvizeni pajisjen *Bluetooth* brenda më pranë njësisë kryesore.
- Çiftimi mund të mos jetë i mundur nëse rreth njësisë kryesore ka pajisje të tjera *Bluetooth*. Në këtë rast, fikni pajisjet e tjera *Bluetooth*.
- Fshini sistemin nga pajisja *Bluetooth* dhe kryejeni nga fillimi çiftimit (faqe 35).

Lidhja nuk arrin të kryhet.

- Është fshirë informacioni i regjistrimit të çiftimit. Kryeni veprimin e çiftimit sërish (faqe 35).

Nuk ka zë.

- Sigurohuni që ky sistem të mos jetë shumë larg nga pajisja *Bluetooth*, ose ky sistem nuk merr interferenca nga një rrjet Wi-Fi, pajisje të tjera me valë 2,4 GHz ose furra me mikrovalë.

- Kontrolloni që lidhja *Bluetooth* të kryhet siç duhet mes këtij sistemi dhe pajisjes *Bluetooth*.
- Çiftoni sërish këtë sistem dhe pajisjen *Bluetooth*.
- Mbajeni sistemin larg nga objektet apo sipërfaqet metalike.
- Sigurohuni që të jetë zgjedhur funksioni „BT“.
- Rregulloni në fillim volumin e pajisjes *Bluetooth*, nëse niveli i volumit është ende shumë i ulët, rregulloni nivelin e volumit në njësinë kryesore.

Zëri kapërcehet ose ngrihet e ulet, ose lidhje humbet.

- Njësia kryesore dhe pajisja *Bluetooth* janë tepër larg njëra-tjetrës.
- Nëse ka pengesa mes njësisë kryesore dhe pajisjes *Bluetooth*, largojini ose shmangni pengesat.
- Nëse ka pranë pajisje që krijojnë rrezatim elektromagnetik, si p.sh. një LAN me valë, pajisje tjetër *Bluetooth* apo një furrë me mikrovalë, largojini tutje.

Disqet që mund të luhen

Disk Blu-ray	BD-ROM ¹⁾ BD-R/BD-RE ²⁾
DVD³⁾	DVD-ROM DVD-R/DVD-RW DVD+R/DVD+RW
CD³⁾	CD-DA (CD muzikore) CD-ROM CD-R/CD-RW Super Audio CD

¹⁾ Duke qenë se specifikimet e Blu-ray Disc janë të reja dhe në evoluim, disa disqe mund të mos luhen dot në varësi të llojit të diskut dhe versionit. Gjithashtu, dalja audio ndryshon në varësi të burimit, folesë ku është lidhur dalja dhe cilësimeve të zgjedhura audio.

²⁾ BD-RE: Ver.2.1

BD-R: Ver.1.1, 1.2, 1.3 duke përfshirë llojin me pigment organik BD-R (lloji LTH)
BD-R e regjistruara në një kompjuter nuk mund të luhen nëse poshtëshënimet janë të regjistrueshme.

³⁾ Disqet CD ose DVD nuk do të luhen nëse nuk janë finalizuar siç duhet. Për më shumë informacion, referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen e regjistrimit.

Disqet që nuk mund të luhen

- BD me fishek
- BDXL
- DVD-RAM
- DVD-të HD
- Disqet DVD Audio
- PHOTO CD
- Pjesët me të dhëna të CD-Extra-ve
- Super VCD
- Materiali audio brenda DualDisc-eve

Shënimet mbi disqe

Ky produkt është projektuar të riprodhojë disqe që janë konform me standardin e kompakt-diskut (CD).

DualDisc-ët dhe disa disqe muzikore me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit nuk janë konform me standardin e kompakt-diskut (CD). Prandaj, këto disqe mund të mos jenë të përputhshëm me këtë produkt.


Shënim mbi përdorimin e riprodhimit të një BD/DVD-je

Disa funksione përdorimi të riprodhimit të një BD/DVD-je mund të jenë vendosur qëllimisht nga prodhuesit e softuerit. Duke qenë se ky sistem luan një BD/DVD sipas përmbajtjes të projektuar të diskut nga prodhuesit e softuerit, disa veçori të riprodhimit mund të mos jenë të disponueshme.

Shënim mbi BD/DVD me dy shtresa

Figura dhe zëri i riprodhuar mund të ndërpriten për një çast kur kalohet nga një shtresë në tjetrën.

Kodi rajonal (vetëm për BD-ROM/ DVD VIDEO)

Sistemi juaj ka një kod rajonal të printuar në pjesën e pasme të njësisë kryesore dhe do të luajë vetëm BD-ROM/DVD VIDEO (vetëm riprodhim) të etiketuara me të njëjtat kode rajonal ose .

Llojet e skedarëve që mund të luhen

Video

Kodeku video	Përmbajtja	Prapashtesa
Video MPEG-1 ^{*1}	PS	.mpg, .mpeg
Video MPEG-2 ^{*2}	PS ^{*3}	.mpg, .mpeg
	TS ^{*4}	.m2ts, .mts
Xvid	AVI	.avi
	MKV	.mkv
MPEG4/AVC ^{*5}	MKV ^{*1}	.mkv
	MP4 ^{*1}	.mp4, .m4v
	TS ^{*1}	.m2ts, .mts
	Quick Time ^{*6}	.mov
	3gpp/ 3gpp2 ^{*6}	.3gp, .3g2, .3gpp, .3gp2
VC1 ^{*1}	TS	.m2ts, .mts
WMV9 ^{*1}	ASF	.wmv, .asf
Motion JPEG ^{*6}	Quick Time	.mov
	AVI	.avi

Formati video	Përmbajtja	Prapashtesa
AVCHD ^{*1*7}	Dosje format AVCHD ^{*8}	

Muzikë

Kodeku i audios	Prapashtesa
MP3 (MPEG-1 Audio Layer III)	.mp3, .mka ^{*6}
AAC ^{*1}	.m4a, .aac ^{*6} , .mka ^{*6}
WMA9 Standard ^{*1}	.wma
LPCM	.wav, .mka ^{*6}
FLAC ^{*6}	.flac, .fla
AC3 ^{*6}	.ac3, .mka

Foto

Formati foto	Prapashtesa
JPEG	.jpeg, .jpg, .jpe
PNG	.png ^{*9}
GIF	.gif ^{*9}
MPO	.mpo ^{*6*10}

- *1 Sistemi mund të mos e luajë këtë format skedari në një server DLNA.
- *2 Sistemi mund të luajë vetëm video me definicion standard në një server DLNA.
- *3 Sistemi nuk luan skedarë formati DTS në një server DLNA.
- *4 Sistemi luan vetëm skedarë formati Dolby Digital në një server DLNA.
- *5 Sistemi mund të mbështesë AVC deri në nivelin 4.1.
- *6 Sistemi nuk e luan këtë format skedari në një server DLNA.
- *7 Sistemi mund të luajë format AVCHD Ver.2.0 format (AVCHD 3D/Progressive).
- *8 Sistemi luan skedarë të formatit AVCHD që janë regjistruar me një kamera dixhitale video, etj.
Disku i formatit AVCHD nuk do të luhet nëse nuk është finalizuar siç duhet.
- *9 Sistemi nuk luan skedarë të animuar PNG ose GIF.
- *10 Për skedarë MPO që nuk janë 3D, shfaqet imazhi kyç ose imazhi i parë.

Shënim

- Disa skedarë mund të mos luhen në varësi të formatit të skedarit, kodimit të skedarit ose kushteve të serverit DLNA.
- Disa skedarë të redaktuar në kompjuter mund të mos luhen.
- Disa skedarë mund të mos jenë në gjendje të performojnë funksionin përshpejtim përpara ose përshpejtim prapa.
- Sistemi nuk luan skedarë të koduar siç janë DRM dhe Lossless.
- Sistemi mund të njohë skedarët ose dosjet e mëposhtme në BD, DVD, CD dhe pajisje USB:
 - deri në 999 skedarë/dosje në një shtresë të vetme
 - deri në 500 skedarë/dosje në një shtresë të vetme

- Sistemi mund të njohë skedarët ose dosjet e mëposhtme të ruajtura në serverin DLNA:
 - deri te dosjet në shtresën e 19-të
 - deri në 999 skedarë/dosje në një shtresë të vetme
- Sistemi mund të mbështesë shpejtësi të kuadrove:
 - deri në 60 fps vetëm për AVCHD.
 - deri në 30 fps për kodekët e tjerë video.
- Sistemi mund të mbështesë shpejtësi bit video deri në 40 Mbps.
- Sistemi mund të mbështesë rezolucion video deri në 1920 x 1080.
- Disa pajisje USB mund të mos funksionojnë me këtë sistem.
- Sistemi mund të njohë pajisjet Mass Storage Class (MSC) (siç janë memoriet në flash ose HDD), pajisjet për kapjen e imazheve (SICD), dhe tastierat me 101 butona.
- Sistemi mund të mos luajë mirë skedarë video me shpejtësi bit të lartë nga DATA CD.
Rekomandohet që të luhen skedarë video me shpejtësi bit të lartë duke përdorur DATA DVD ose DATA BD.

Formatet e mbështetura audio

Formatet e mbështetura audio nga ky sistem janë si më poshtë.

Formati	Funksioni		
	„BD/DVD”	„HDMI1” „HDMI2”	„TV” (DIGITAL IN)
LPCM 2ch	○	○	○
LPCM 5.1ch	○	○	–
LPCM 7.1ch	○	–	–
Dolby Digital	○	○	○
Dolby TrueHD, Dolby Digital Plus	○	–	–
DTS	○	○	○

Formati	Funksioni		
	„BD/DVD“	„HDMI1“ „HDMI2“	„TV“ (DIGITAL IN)
DTS-ES Discrete 6.1, DTS-ES Matrix 6.1	○*	○*	○*
DTS96/24	○	○*	○*
DTS-HD High Resolution Audio	○	-	-
DTS-HD Master Audio	○	-	-

○: Formati i mbështetur.

-: Formati i pambështetur.

* Dekoduar si DTS.

Shënim

- Fole të HDMI (IN 1) dhe HDMI (IN 2) nuk nxjerrin tingull në rast formati audio që përmban mbrojtje kundër kopjimit si p.sh. Super Audio CD ose DVD-Audio.
- Për formatin LPCM 2ch, frekuenca e mbështetur shembull e sinjalit dixhital është deri në 96 kHz kur përdoret funksioni „HDMI1“ or „HDMI2“ dhe 48 kHz kur përdoret funksioni „TV“.
- Për formatin LPCM 5.1ch, frekuenca e mbështetur shembull e sinjalit dixhital është deri në 48 kHz kur përdoret funksioni „HDMI1“ ose „HDMI2“.

Specifikimet

Seksioni i amplifikatorit

DALJA E FUQISË (nominale)

I përparmë majtas / I përparmë djathtas:
125 W + 125 W (në 6 om, 1 kHz,
1% THD)

DALJA E FUQISË (e referuar)

I përparmë majtas / I përparmë djathtas:
200 W (për kanal në 6 om, 1 kHz)

Qendër:

200 W (në 6 om, 1 kHz)

Nën-vuferi:

200 W (në 6 om, 80 Hz)

Hyrjet (Analoge)

AUDIO (AUDIO IN)

Ndeshmëria: 1,8 V/600 mV

Hyrjet (Dixhitale)

TV (Kanali i kthimit të audios/OPTICAL)

Formatet e mbështetura: LPCM 2CH
(deri në 48 kHz), Dolby Digital, DTS

HDMI (IN 1)/HDMI (IN 2)

Formatet e mbështetura: LPCM 5.1CH
(deri në 48 kHz), LPCM 2CH (deri në
96 kHz), Dolby Digital, DTS

Seksioni HDMI

Bashkuesi


Lloji A (19 kunjja)

Sistemi BD/DVD/Super Audio CD/CD

Sistemi i formatit të sinjalit/

NTSC/PAL

Seksioni USB

Porta  (USB):

Lloji A (për lidhjen e memories USB,
lexuesve të kartave të memories,
aparateve dixhitale, dhe video-kamerave
dixhitale)

Seksioni LAN

Terminali LAN (100)

Terminali 100BASE-TX

Seksioni i LAN-it me valë

Pajtueshmëria me standardet

IEEE 802.11 b/g/n

Frekuenca dhe kanali

Brezi 2,4 GHz: kanalet 1-13

Seksioni Bluetooth

Sistemi i komunikimit

Bluetooth Versioni i specifikimit 3.0

Dalje

Bluetooth Kategoria e fuqisë së
specifikimit 2

Rezja maksimale e komunikimit

Vija e shikimit rreth 10 m¹⁾

Brezi i frekuencës

Brezi 2,4 GHz

Metoda e modulimit

FHSS (Freq Hopping Spread Spectrum -
Spektri i sprovedit të kapërcimit të
frekuencës)

Profillet e përputhshme *Bluetooth*²⁾

A2DP 1.2 (Profili i përparuar i shpërndarjes audio)

AVRCP 1.3 (Profili i telekomandimit audio video)

Kodekët e mbështetur³⁾

SBC⁴⁾, AAC

Gama e transmetimit (A2DP)

20 Hz – 20.000 Hz (Frekuencat shembull
44,1 kHz, 48 kHz)

¹⁾ Rrezja aktuale varion në varësi të faktorëve si pengesat mes pajisjeve, fushat magnetike rreth një furre me mikrovalë, elektriciteti statik, telefonat me valë, ndjeshmëria e marrjes, performanca e antenës, sistemi operativ, aplikacioni i softuerit, etj.

²⁾ Profillet standard *Bluetooth* tregojnë qëllimin e komunikimit *Bluetooth* mes pajisjeve.

³⁾ Kodeku: Ngjeshja e sinjalit audio dhe formati i konvertimit

⁴⁾ Kodeku i nën-brezit

Seksioni i sintonizuesit FM

Sistemi

Sintetizuesi dixhital PLL i kyçur me kuarc

Gama e sintonizimit

87,5 MHz – 108,0 MHz (hapa nga
50 kHz)

Antenë (ajrore)

Antena FM me tel (ajrore)

Terminalet e antenës (ajrore)

75 om, të pabalancuara

Altoparlantët

**I përparmë (SS-TSB127) për
BDV-N9100WL**

**I përparmë (SS-TSB126) për
BDV-N9100W/BDV-N8100W**

**Rrethues (SS-TSB131) për
BDV-N9100W**

**Rrethues (SS-TSB130) për
BDV-N9100WL**

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

102 mm × 700 mm × 60 mm

(pjesa e montuar në mur)

270 mm × 1.200 mm × 270 mm

(i gjithë altoparlanti)

Masa (afërsisht)

1,7 kg (pjesa e montuar në mur)

4,0 kg (i gjithë altoparlanti)

**I përparmë (SS-TSB125) për
BDV-N7100W**

**I përparmë (SS-TSB124) për
BDV-N7100WL**

**Rrethues (SS-TSB129) për
BDV-N8100W/BDV-N7100W**

**Rrethues (SS-TSB128) për
BDV-N7100WL**

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

100 mm × 435 mm × 54 mm

(pa mbajtëse)

140 mm × 455 mm × 140 mm

(me mbajtëse)

Masa (afërsisht)

1,1 kg (pa mbajtëse)

1,2 kg (me mbajtëse)

**Qendror (SS-CTB124) për
BDV-N9100W/BDV-N8100W/
BDV-N7100W**

**Qendror (SS-CTB123) për
BDV-N9100WL/BDV-N7100WL**

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

365 mm × 75 mm × 75 mm

Masa (afërsisht)

1,3 kg

**Nën-vuferi (SS-WSB125) për
BDV-N9100W/BDV-N8100W/
BDV-N7100W**

**Nën-vuferi (SS-WSB124) për
BDV-N9100WL/BDV-N7100WL**

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

280 mm × 440 mm × 280 mm

Masa (afërsisht)

8,0 kg

Të përgjithshme

Njësia kryesore

Furnizimi me energji

220 V – 240 V AC, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë

Ndezur: 100 W

Në pritje: 0,3 W (Për detajet e cilësimit, shihni faqe 54.)

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

480 mm × 79 mm × 212 mm duke

përfshirë pjesët projektuese

480 mm × 79 mm × 226 mm (me

marrësin me valë të futur)

Masa (afërsisht)

3,1 kg

Amplifikatori rrethues (TA-SA300WR)

për BDV-N9100W/BDV-N8100W/

BDV-N7100W

Amplifikuesi rrethues (TA-SA400WR)

për BDV-N9100WL/BDV-N7100WL

Seksioni i amplifikatorit

DALJA E FUQISË (e referuar)

Surround L/Surround R:

100 W (për kanal në 3 om, 1 kHz)

Rezistenca nominale:

3 Ω – 16 Ω

Furnizimi me energji

220 V – 240 V AC, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë

Ndezur: 50 W

Konsumi i energjisë në pritje

0,5 W (pritje automatike)

0,2 W (fikur)

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

206 mm × 60 mm × 236 mm me marrësin

me valë të futur

Masa (afërsisht)

1,3 kg

Marrësi me valë (EZW-RT50)

Sistemi i komunikimit

Specifikimi i zërit me valë versioni 1.0

Brezi i frekuencës

5,725 GHz – 5,875 GHz

Metoda e modulimit

DSSS

Furnizimi me energji

DC 3,3 V, 300 mA

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

30 mm × 9 mm × 60 mm

Masa (afërsisht)

10 g

Dizajni dhe specifikimet janë subjekt

ndryshimi pa dhënë njoftim.

- Konsumi i energjisë në pritje: 0,3W (Njësia kryesore), 0,2W (Amplifikatori rrethues).
- Mbi 85% e efikasitetit të energjisë së bllokut të amplifikuesit arrihet me amplifikuesin e plotë dixhital, S-Master.

Lista e kodeve të gjuhëve

Shqiptimet e gjuhëve sipas ISO 639: standardi i vitit 1988 (E/F).

Kodi	Gjuha	Kodi	Gjuha	Kodi	Gjuha	Kodi	Gjuha
1027	Afar	1183	Irish	1347	Maori	1507	Samoan
1028	Abkhazian	1186	Scots Gaelic	1349	Macedonian	1508	Shona
1032	Afrikaans	1194	Galician	1350	Malayalam	1509	Somali
1039	Amharic	1196	Guarani	1352	Mongolian	1511	Albanian
1044	Arabic	1203	Gujarati	1353	Moldavian	1512	Serbian
1045	Assamese	1209	Hausa	1356	Marathi	1513	Siswati
1051	Aymara	1217	Hindi	1357	Malay	1514	Sesotho
1052	Azerbaijani	1226	Croatian	1358	Maltese	1515	Sundanese
1053	Bashkir	1229	Hungarian	1363	Burmese	1516	Swedish
1057	Byelorussian	1233	Armenian	1365	Nauru	1517	Swahili
1059	Bulgarian	1235	Interlingua	1369	Nepali	1521	Tamil
1060	Bihari	1239	Interlingue	1376	Dutch	1525	Telugu
1061	Bislama	1245	Inupiak	1379	Norwegian	1527	Tajik
1066	Bengali;	1248	Indonesian	1393	Occitan	1528	Thai
	Bangla	1253	Icelandic	1403	(Afan)Oromo	1529	Tigrinya
1067	Tibetan	1254	Italian	1408	Oriya	1531	Turkmen
1070	Breton	1257	Hebrew	1417	Punjabi	1532	Tagalog
1079	Catalan	1261	Japanese	1428	Polish	1534	Setswana
1093	Corsican	1269	Yiddish	1435	Pashto;	1535	Tonga
1097	Czech	1283	Javanese		Pushto	1538	Turkish
1103	Welsh	1287	Georgian	1436	Portuguese	1539	Tsonga
1105	Danish	1297	Kazakh	1463	Quechua	1540	Tatar
1109	German	1298	Greenlandic	1481	Rhaeto-	1543	Twi
1130	Bhutani	1299	Cambodian		Romance	1557	Ukrainian
1142	Greek	1300	Kannada	1482	Kirundi	1564	Urdu
1144	English	1301	Korean	1483	Romanian	1572	Uzbek
1145	Esperanto	1305	Kashmiri	1489	Russian	1581	Vietnamese
1149	Spanish	1307	Kurdish	1491	Kinyarwanda	1587	Volapük
1150	Estonian	1311	Kirghiz	1495	Sanskrit	1613	Wolof
1151	Basque	1313	Latin	1498	Sindhi	1632	Xhosa
1157	Persian	1326	Lingala	1501	Sangho	1665	Yoruba
1165	Finnish	1327	Laothian	1502	Serbo-Croatian	1684	Chinese
1166	Fiji	1332	Lithuanian	1503	Singhalese	1697	Zulu
1171	Faroese	1334	Latvian;	1505	Slovak		
1174	French		Lettish	1506	Slovenian		
1181	Frisian	1345	Malagasy			1703	Nuk specifikohet

Lista e kodeve zonale/kontrolli prindëror

Kodi	Zona	Kodi	Zona	Kodi	Zona	Kodi	Zona
2044	Argjentina	2376	Holanda	2333	Luksemburgu	2149	Spanja
2047	Australia	2219	Hong-Kong	2363	Malajzia	2499	Suedia
2046	Austria	2248	India	2184	Mbretëria	2528	Tajlanda
2057	Belgjika	2238	Indonezia		e Bashkuar	2543	Tajvani
2070	Brazili	2239	Irlanda	2362	Meksika	2390	Zelanda e Re
2115	Danimarka	2254	Italia	2379	Norvegjia	2086	Zvicra
2424	Filipinet	2276	Japonia	2427	Pakistani		
2165	Finlanda	2090	Kili	2428	Polonia		
2174	Franca	2092	Kina	2436	Portugalia		
2109	Gjermania	2093	Kolumbia	2489	Rusia		
2200	Greqia	2304	Koreja	2501	Singapori		

Indeksi

Identifikuesit numerikë

3D 33
3D Output Setting 60

A

A/V SYNC 44
Amplifikuesi shumëkanalësh 16
Attenuate - AUDIO 62
Audio DRC 62
Audio Language 63
Audio Output 62
Audio Return Channel 65
Audio Settings 62
Auto Display 65
Auto Standby 65

B

BD Audio MIX Setting 62
BD Hybrid Disc Playback Layer 63
BD Internet Connection 63
BD Parental Control 64
BD/DVD Menu Language 63
BD/DVD Viewing Settings 63
BD-LIVE 33
BD-ROM 24p Output 60
Bluetooth 35
Bllokimi për fëmijët 52
BONUSVIEW 33
BRAVIA Sync 47

C

CD 78
Cilësimet e muzikës 64
Cinema Conversion Mode 60
Connection Server Settings 66
Control for HDMI 47, 65

D

D.C.A.C. DX (Digital Cinema Auto Calibration DX) 48
Dalje 24p DVD-ROM 61
Disqet që mund të luhen 78
DLNA 39, 67
Dolby Digital 44
DTS 44
DVD 78
DVD Aspect Ratio 60
DVD Parental Control 64

E

Easy Network Settings 68
Ekрани i panelit të sipërm 15
External Input Settings 66

F

FM Mode 45

G

Gracenote Settings 66

H

HDMI
YCbCr/RGB (HDMI) 61
HDMI Deep Colour Output 61

I

Informacioni i luajtjes 34
Initialise Personal Information 68
Internet Settings 66
Internet Video Parental Control 64
Internet Video Unrated 64

K

- Kalibrimi automatik 48, 63
- Kanalet e riprodhimit
 - të Super Audio CD 64
- Kodi rajonal 79
- Konfigurimi i thjeshtë 29

L

- Lidhja me valë e zërit 64
- Lista e kodeve të gjuhëve 84

M

- Main Unit illumination 64
- Modaliteti i paravendosjes 59
- 64

N

- Network Connection Diagnostics 66
- Network Settings 66
- Network Update 59
- NFC 37

O

- OSD Language 64

P

- Paneli i pasmë 16
- Paneli i përparmë 13
- Paneli i sipërm 13
- Parental Control Area Code 64
- Parental Control Settings 64
- PARTY Auto Start 67
- Password 64
- Pause Mode 61
- Përditësimi 59
- Përmbajtja nga interneti 38
- Power Save Drive 65

Q

- Quick Start Mode 65

R

- RDS 47
- Registered Remote Devices 67
- Remote Start 67
- Renderer Access Control 67
- Renderer Set-up 67
- Reset to Factory Default Settings 68
- Resetting 68

S

- SBM 61
- Screen Format 60
- Screen Saver 65
- Screen Settings 60
- SLEEP 51
- Slideshow 43
- Software License Information 66
- Sound Effect 62
- Speaker Settings 50, 63
 - Distance 50
 - Level 50
- Subtitle Language 63
- System Information 66

Sh

- Shtresa e riprodhimit
 - të Super Audio CD 64

T

Telekomanda 17

Test Tone 51

Tingull me transmetim multipleks 45

TV Screen Size Setting for 3D 60

TV Type 60

U

Udhëzuesi i cilësimeve të telekomandës 59

USB 34

W

WEP 26

WPA2-PSK (AES) 26

WPA2-PSK (TKIP) 26

WPA-PSK (AES) 26

WPA-PSK (TKIP) 26

Softueri i këtij sistemi mund të përditësohet në të ardhmen. Për të gjetur më shumë detaje mbi përditësimet e disponueshme, ju lutemi vizitoni URL-në e mëposhtme.

Për klientët në Evropë dhe Rusi:
<http://support.sony-europe.com/>

Për klientët në vende/rajone të tjera:
<http://www.sony-asia.com/section/support>

HDMI

DLNA
CERTIFIED™

gracenote.



SUPER AUDIO CD

Blu-ray
3D™

Blu-ray Disc™

Java
POWERED

<http://www.sony.net/>



* 4 4 5 6 3 3 5 1 1 * (1)